

VËRTETËSIA

BOTIM I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA TË SHQIPËRISË

VERË 2021

WWW.ALISLAM.AL

NR. 12

Pse shohim ëndrra të vërteta?

Pse njerëzve disa ëndrra nuk u dalin?





Mesih i Premtuar

~ IMAM MEHDI

I Dërguari i Allahut ^{s.a.w.a} kishte paralajmëruar se Mesihu i Premtuar do të zbrësë pranë një minareje të bardhë, në lindje të Damaskut. Kjo profeci u përmbush me ardhjen e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit ^{a.s.} në Kadijan të Indisë, një qytezë që ndodhet pikërisht në lindje të Damaskut.



Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.}, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi lindi në vitin 1835 në një familje fisnike në Kadijan të Indisë. Që në moshë të re, ai shfaqti interes të veçantë për fenë dhe ushqe dashurinë për Profetin Muhammed ^{s.a.w.a}. Ai dallohej për fisnikërinë, dashamirësinë dhe vendosmërinë e tij. Me kalimin e kohës, njohuria dhe botëkuptimi i tij për besimin dhe zbatimin e tij në shoqëri u thelluan. Duke qenë një musliman i devotshëm, ai besonte fuqimisht se të gjitha fetë janë të vërteta për sa i përket origjinës së tyre, megjithatë përgjatë rrjedhës kohore ato u janë shmangur mësimëve burimorë. Ai mbrojti dinjitetin e besimit dhe vërtetoi se ai është bashkëkohor dhe se u përgjigjet sfidave të kohës.

Përpjekjet e tij në përkrahje të besimit u shpërblyen prej Allahut, i cili e dalloj atë si shërbëtor të përkryer të Islamit, të Kuranit dhe të Profetit Muhammed ^{s.a.w.a}, duke i dhuruar bekimin e shpalljes nën shërbim të Profetit ^{s.a.w.a}.

Misioni i tij ishte të shquante të vërtetat që përmban çdo fe, si dhe të rigjallëronte mësimet e Islamit. Përmes këtij misioni, ai hodhi themelet për t'i bashkuar njerëzit dhe për të vendosur paqe e harmoni të përhershme.

Më 1889, sipas urdhrat hyjnor, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.} themeloi Xhematin Musliman Ahmedia. Kjo bashkësi që tashmë është shumëfishuar në numër e në shtrirje, është angazhuar fuqimisht për të përçar mesazhin e Islamit deri në skajet e botës.

Gjatë periudhës në të cilën jetoi ai, Islami ishte nën shënjestër

të sulmeve armiqësore nga të gjitha anët dhe muslimanët në përgjithësi ishin në rënie të skajshme shpirtërore, me një besim të dyshimtë dhe krejtësisht sipërfaqësor. Ai ndërmoi një fushatë të jashtëzakonshme për t'i treguar botës fytyrën e bukur dhe të vërtetë të fesë islame. Ndër përpjekjet e tij të çmuara e madhore, mund të përmendim: mbi tetëdhjetë libra, të cilët janë përkthyer në më shumë se 60 gjuhë të botës si “Filozofia e mësimëve të Islamit”, “Brahin-e-Ahmedia” etj., qindra ligjërata me njohuri të thella të mistikës e debate të shumta fetare, të cilat argumentojnë më së miri se feja islame është një fe e gjallë, nëpërmjet së cilës njeriu mund të lidhë kontakt me Krijuesin dhe arrin të komunikojë me Të.

Shumica e veprave të tij janë shkruar në gjuhën urdu, disa në gjuhën arabe e disa të tjera edhe në gjuhën perse. Ai gjithashtu provoi se mësimet e Kuranit Famëlartë dhe ligji i fesë islame kanë fuqinë të ngrënë e të përsosin nivelin moral, intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Ai deklaroi se Zoti i Madhërishtëm e ka caktuar atë si Mesih dhe Imam Mehdi, siç ishte përmendur në profecitë e Biblës, të Kuranit Famëlartë dhe të haditheve të Hazret Profetit Muhammed ^{s.a.w.a}.

Nga 1889 deri 1908 kur ai ndërroi jetë, mijëra njerëz iu bindën atij dhe lidhën besëlidhje me të. Ky bekim vazhdon të përhapet përmes Kalifëve (zëvendësve) të tij.

Aktualisht, Hazret Mirza Masrur Ahmedi (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) është udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia dhe Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar ^{a.s.} Ky Xhemat sot është përhapur në më shumë se 205 vende të botës dhe përbëhet nga miliona anëtarë.

Ëndrra dhe shpallja hyjnore



Ai me urdhrin e Tij i zbret engjëjt me Shpirtin e Shenjtë mbi kë të dojë nga robërit e Tij: Paralajmëroni që nuk ka adhureshëm tjetër përveç Meje, andaj, prej Meje kini drujtje!

ISLAMI, KURANI FAMILARTË, 16:3.



I Dërguari i Allahut ^{S.A.V.S.} tha: “Nëse ndonjëri prej jush shikon një ëndërr që i pëlqen atij, ajo është prej Allahut, dhe i duhet të falënderojë Allahun për këtë dhe le t’ua rrëfejë të tjerëve. Por, nëse sheh (ndonjë ëndërr të keqe) që nuk i pëlqen atij, ajo është nga shejtani dhe njeriu duhet të kërkojë mbrojtje tek Allahu nga e keqja e saj dhe nuk duhet t’ia përmendë atë askujt. (Nëse vepron kështu) ai do të ruhet nga e keqja e saj”.

ISLAMI, PROFETI MUHAMMED ^{S.A.V.S.} SAHIHU I BUHARIUT, KITAB “ET-TA’BIR”, BAB: “ER-RRU’JA MINALLAH”, HADITHI NR. 6985.



Mos mendoni se shpallja e Zotit nuk vjen më dhe se ka mbetur vetëm në të kaluarën dhe se Shpirti i Shenjtë nuk zbret dhe se ka zbritur vetëm në kohërat e mëparshme. Singerisht ju them të vërtetën, çdo derë mbyllet, por dera nga e cila zbret Shpirti i Shenjtë kurrë nuk mbyllet. Hapni dyert e zemrave tuaja, që ai të hyjë në to.

ISLAMI, MESIHU I PREMTUAR ^{A.S.}, ARKA E NUHUT, F. 54.



Pastaj Zoti tha: “Dëgjoni tani fjalët e mia! Nëse ka një profet midis jush, unë, Zoti i bëhem i njohur atij në vegim, flas me të në ëndërr”.

JUDAIZMI, DHJATA E VJETËR, NUMRAT 12:6



Kam edhe shumë të tjera për t’ju thënë por tani s’mund t’i kuptoni. E kur të vijë ai - Shpirti i së Vërtetës - Ai do t’ju udhëzojë ta njihni tërë të Vërtetën. Ai s’do të flasë prej vetvetes, por do të flasë çka të dëgjojë dhe do t’ju zbulojë të ardhmen.

KRISHTËRIMI, DHJATA E RE, JAKOBI 3:5-9.



Një natë me hënë të plotë, mbretëresha Mahamaja e cila flinte në pallat, pa një ëndërr. Ajo e ndjeu veten sikur e kishin marrë nga katër deva (shpirtra) në liqenin Anotatta në Himalajë. Pasi e lanë në liqen, shpirtrat e veshën me pëlhura qiellore, e vajosën me parfume dhe e mbuluan me lule hyjnore. Pak më vonë, iu shfaq një elefant i bardhë, i cili mbante një zambak uji të bardhë në trung, dhe shkoi rreth saj tri herë. Pastaj, ai i hyri në mitër nga ana e djathtë. Në fund elefanti u zhdruk dhe mbretëresha u zgjua. Ajo kuptoi se i ishte dhënë një mesazh i rëndësishëm, pasi elefanti është simbol i madhështisë në Nepal.

BUDIZMI, LEGJEDNA BUDISTE

VËRTETËSIA

10 Llojet e komunikimit me Allahun e Madhërishëm

Një shpjegim i thellë i Kuranit
Famëlartë, i cili sqaron mënyrat
e komunikimit me Zotin e
Madhërishëm

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

18 Dera e shpalljes është e hapur edhe tani

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

20 Pse shohim ëndrra të vërteta? Pse njerëzve disa ëndrra nuk u dalin?

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

26 Shkolla të ndryshme të mendimit islam

Një nga kapitujt e librit
fenomenal “Revelation, Rationality,
Knowledge & Truth” (Zbulesa,
arsyeja, dija dhe e vërteta)

HAZRET MIRZA TAHIR AHMED R.A.
KALIFI I KATËRT I MESIHUT TË PREMTUAR

44 Një thirrje e fuqishme dhe historike në OKB, për të drejtat e palestinezëve

Në nëntor 1947, kur krijimi i
Izraelit po diskutohej në Asamblenë
e Kombeve të Bashkuara, Sir
Muhammad Zafrulla Khan-i mbajti
një fjalim historik, duke u tërhequr
vëmendjen te të drejtat e palestinezëve,
të cilat po nëpërkëmbëshin.

SIR MUHAMMAD ZAFRULLA KHAN

66 Epërsia e lartë e Kuranit të Shenjtë

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

68 Ç’është media sociale? A mendoni se dini mjaftueshëm për rrjetet sociale?

Një analizë e mirëfilltë që zbërthen
qëllimin e vërtetë të mediave sociale
dhe jep sugjerime për t’i përdorur
ato për qëllime të dobishme

FARHAT MAHMOOD, SHBA
SARMAD NAVEED, KANADA

78 Emrat e Allahut

Vërtetësia ju sjell kuptime të thella që përmbajnë atributet e Allahut.

86 11 Ushqime që rrisin imunitetin

Ka disa ushqime që rrisin sistemin tonë imunitar. Gjatë kësaj pandemie të Covid-19, është e rëndësishme të hani ushqime që rrisin imunitetin.

MALIK SAMAR IMTIAZ

92 Komunikimi me Zotin është thelbi i Islamit

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED A.S.
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

96 Lajme nga Shqipëria, Kosova dhe Gjermania

Një përmbledhje aktivitetesh gjatë kohës së pandemisë nga Xhemati Musliman Ahmedia dhe organizata e tij humanitare "Humanity First"



20



68



26



Eseja e titulluar “*Filozofia e mësimeve të Islamit*” është shkruar në gjuhën urdu nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed^{a.s.}, Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu, si përgjigje ndaj ftesës së Z. Svami Sad’hu Shogan Çander, i cili organizoi Mbledhjen e Madhe të Feve, në Town Hall të qytetit Lahor në datat 26 – 29 dhjetor të vitit 1896. Dijetarët muslimanë, të krishterë, arjë dhe të feve të tjera ishin ftuar për të përfaqësuar fenë e tyre përkatëse. Atyre u ishte caktuar të ligjëronin rreth pesë pyetjeve të kërkuara në bazë të Librit që ata besonin si Hyjnor:

1. Gjendjet trupore, morale dhe shpirtërore të njeriut
2. Cila është gjendja e njeriut pas kësaj jete, pra në botën vijuese?
3. Cili është qëllimi i vërtetë i qenies së njeriut në këtë botë dhe si mund të përmbushet ai qëllim?
4. Si ndikojnë veprat te njeriu në këtë botë dhe në botën vijuese?
5. Cilat janë mjetet për të arritur dijen dhe njohjen Hyjnore?

Lexoni online:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/librat/>

ose blini këtu:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/kontaktoni/>

VËRTETËSIA

KRYEREDAKTOR

Samad Ahmed Ghorri

BORDI EDITORIAL

Jinahuddin Saif, Bujar Ramaj, Shahid Butt, Rexhep Hasani, Besmir Yvejsi

REDAKTORE GJUHËSORE

Ina Komino

FAQOSJA

Shahid Butt

MENAXHER

Idriz Ramadani

Email: idriz.xhamajl@gmail.com

PËR ABONIM KONTAKTONI:

SHQIPËRI

Sali Beja

Email: salibeja@gmail.com

KOSOVË

Shkëlqim Bytyçi

Email: shkëlqimbytyci@gmail.com

SHTYPUR NË SHTYPSHKRONJËN

RanaPoster.de Druckerei

Robert-Perthel-Str. 15

50739 Köln-Bilderstöckchen, Deutschland

Email: masood313@aol.com

ADRESA POSTARE

NË SHQIPËRI:

Xhemati Musliman Ahmedia i

Shqipërisë, pranë Vodafonit,

Rr. "Pavarësia" Km. 1, Mëzez,

Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri

Email: amj.albania@gmail.com

NË KOSOVË:

Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës

Rr. "Elbasani", nr. 9,

Lagjia e Spitalit,

Kutia Postare 43,

Prishtinë 10000, Kosovë

Email: amj.kosovo@gmail.com

NË GJERMANI:

Albanian Desk

Barendorfer Bruch 15,

58640, Iserlohn, Deutschland

Email: albanian.desk@gmail.com

KONTAKT REDAKSI:

M +355 67 216 8054,

+355 694644888

+383 44 817 813

T +355 42 391 080

EMAIL

vertetesia@gmail.com

WEBSITE

www.alislam.al

Kurani Famëlartë

وَمَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا أَوْ مِنْ وَرَاءِ

حِجَابٍ أَوْ يُرْسِلَ رَسُولًا فَيُوحِيَ بَأْذَنِهِ مَا يَشَاءُ

إِنَّهُ عَلَىٰ حَكِيمٍ

Nuk është e mundur për një njeri që t'i flasë Allahut, përveçse me anë të shpalljes (vahjit) ose mbrapa një perdeje, ose atij t'i dërgohet (prej Zotit) një i dërguar (mesazhier), i cili t'i shpallë atij me urdhrin e Tij për çfarë të dojë Ai. Sigurisht, Ai është shumë i Lartë, shumë i Urtë.

Kurani Famëlartë 42:52




Hadithi

عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا - أَنَّ الْخَارِثَ بْنَ هِشَامٍ - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ - سَأَلَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ يَا رَسُولَ اللَّهِ كَيْفَ يَأْتِيكَ الْوَحْيُ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَخْبَانَا يَا بُنَيَّ مِثْلَ صَلَاحَةِ الْجَرَسِ - وَهُوَ أَشَدُّ عَلَى - فَيَنْصَمُ عَنِّي وَقَدْ وَعَيْتُ عَنْهُ مَا قَالَ، وَأَخْبَانَا يَتَمَثَّلُ لِي الْمَلَكُ رَجُلًا فَيَكَلِّمُنِي فَأَعْيِي مَا يَقُولُ". قَالَتْ عَائِشَةُ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا وَلَقَدْ رَأَيْتُهُ يُنْزَلُ عَلَيْهِ الْوَحْيُ فِي الْيَوْمِ الشَّدِيدِ الْبَرْدِ، فَيَنْصَمُ عَنْهُ وَإِنْ حَبِيبُهُ لَيَنْتَفِصِدُ عَرَقًا.

Nëna e besimtarëve Hazret Aishja ^{r.a.} përcjell se Harith ibn Hishami ^{r.a.} e pyeti të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.}: “O i Dërguari i Allahut! Si ju vjen shpallja hyjnore (Vahji)?” I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} iu përgjigj: “Disa herë ajo më vjen si tingëllima e një kambane dhe kjo formë është më e mundimshme. Pastaj kjo gjendje më kalon, pasi të kem kuptuar atë që më është shpallur. Nganjëherë engjëlli më vjen në formën e një njeriu e bisedon me mua dhe unë kap çdo gjë që ai më thotë.” Hazret Aishja ^{r.a.} shton: “Vërtet, unë e kam parë atë kur i zbriti shpallja në një ditë shumë të ftohtë dhe vura re se i pikonte djersë nga balli”.

Sahih el-Bukhari, kitab: "Bed'ul Vehji", bab: "kejfe kana Bed'ul Vehji ila Rasulil-lahi sal-lallhu alejhi veselem", hadithi nr. 2




Llojet e komunikimit me Allahun e Madhërishëm

Një shpjegim i thellë nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed,
Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu ^{a.s.} i cili sqaron mënyrat
e komunikimit me Zotin e Madhërishëm.

وَمَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا أَوْ مِنْ وَرَاءِ حِجَابٍ
أَوْ يُرْسِلَ رَسُولًا فَيُوحِيَ بِإِذْنِهِ مَا يَشَاءُ إِنَّهُ عَلَىٰ حَكِيمٍ





Nuk është e mundur për një njeri që Allahu t'i flasë atij, përveçse me anë të shpalljes (vahjit) ose mbrapa një perdeje, ose atij t'i dërgohet (prej Alalhut) një i dërguar (pra, ëngjëll), i cili t'i shpallë atij me urdhrin e Tij për çfarë të dojë Ai. Sigurisht, Ai është shumë i Lartë, shumë i Urtë.¹

Komunikimi me Zotin bëhet në tri mënyra

“Përpara se ta shpjegojmë këtë ajet, ne edhe praktikisht shohim vetëm tri rrugë të komunikimit me Zotin e Madhërishëm dhe nuk ka ndonjë të katërt dhe ato janë:


1. *ëndrra*
2. *keshfi* [vizioni]
3. *vahji* [shpallja] ...


Fjalët “**mbrapa një perdeje**” nënkuptojnë ëndrrën dhe tregojnë se këtë përjetim e mbizotëron gjuha e figurshme, e cila i ngjan perdes. E tillë është ëndrra.

Fjalët “**i dërgohet ndonjë i dërguar**” nënkuptojnë keshfin [vizionin]. Po në vizion gjendet edhe shëmbëllimi i të dërguarit [ëngjëllit]. Edhe vizioni në të vërtetë është një zinxhir shëmbëlimesh.”²

“Komunikimi me Zotin ka tri lloje: *Vahji*, ëndrra dhe vizioni. *Vahji* është ai që zbret pa ndonjë medium në zemrën e pastër të Profetit. Ky komunikim është më i qarti dhe më dritëploti. Mund të japim shembullin e Hafiz sahibit që është ulur këtu mes nesh, i cili nuk shikon dot me sy, por ai nuk gabon aspak në dëgjimin e bisedës sonë dhe ai nuk ka asnjë dyshim që zëri që dëgjon nuk është i tjetërkujt, ndonëse nuk na sheh me sytë e tij fizikë.

Lloji i dytë i komunikimit me Zotin është ëndrra dhe ajo vjen me ngjyra dhe kompleksitet. Ëndrra ka nënkuptime e figurshmëri, njësoj si ëndrrat e të Dërguarit të Allahut^{s.a.v.s.}: byzylykët në dy duart e tij të bekuara, duart më të gjata të njëres prej bashkëshorteve të tij, figura e lopës etj.. Ëndrra, si një nga mënyrat e komunikimit me Zotin, kërkon interpretim.





Lloji i tretë i komunikimit me Zotin është *keshfi* dhe ai bëhet në formë shëmbëllimesh, qoftë në pamjen e Xhibrailit a.s. ose të ndonjë engjëlli tjetër ose të diçkaje tjetër. ... Andaj, përveç këtyre tri metodave të komunikimit me Zotin, nuk përmendet ndonjë metodë tjetër në ajetin: “Nuk është e mundur për një njeri që t’i flasë Allahut, përveçse me anë të shpalljes (vahjit) ose mbrapa një perdeje, ose atij t’i dërgohet një i dërguar (mesazhier)”.³

Vahji dhe ilham janë sinonime


“Fjalët *vahji* dhe *ilham*, komentuesit shpesh i quajnë sinonime. Kështu kuptohet edhe nga shumë hadithe. Shumica e dijetarëve janë të një mendimi se *ilhami* dhe *vahji* janë sinonime dhe kështu i ka përdorur edhe Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.}, prandaj nuk na lejohet të shkojmë kundër kësaj. ...


Në shkencën e sheriatit ka plot fjalë që kanë kuptime të njohura, të cilat nëse do t’i kufizonim me kuptime gjuhësore, do të gabonim. Mjafton të shikoni fjalën “*vahji*”. Në cilin fjalor gjendet kuptimi i kësaj fjale, në bazë të të cilit Librat e Zotit cilësohen si shpallje e dërguar prej Zotit?! Dhe cili fjalor përshkruan përjetimin e zbritjes së *vahjit*, përmes të cilit Zoti komunikon me të Dërguarit e Tij dhe atyre u dërgon porosinë e Tij?!”⁴

Dallimi mes vahjit, keshfit dhe ëndrrës

“Kur lajmi vjen në formën e një mesazhi zanor, ai quhet vahji. Kur vjen në formën e një pamjeje, quhet *keshf*. ... Dhe nganjëherë ndodhë diçka e caktuar, të cilën trupi e ndien, si të thuash, Allahu i Madhërishtëm zbulon gjërat përmes pesë shqisave të njeriut”.⁵

“Çfarë është *keshfi*? Është shkalla më e lartë dhe më e përsosur e ëndrrës. Ëndrra është gjendja fillestare, në të cilën shqisat fizike nuk luajnë rol, trupi është i çaktivizuar dhe veprimtaria e jashtme e shqisave e fjetur. Ndërsa në *keshf* shqisat nuk mbeten të çaktivizuara. Njeriu që në zgjim sheh atë që më përpara mund ta shihte vetëm në gjumë.





Keshfi është ajo gjendje kur njeriun e pushton një dremitje e tillë, në të cilën ai është i vetëdijshëm për gjithçka, shqisat i punojnë dhe “fryn një erë” e tillë, e cila i mundëson disa shqisa të reja, për të parë pamjet e botës së padukshme. Këto shqisa i dhurohen në forma të ndryshme, herë i jepet shqisa të parit, herë e të nuhaturit dhe herë ajo e të dëgjuarit etj. Siç kishte thënë edhe babai i Hazret Jusufit ^{a.s.}:

إِنِّي لَأَجِدُ رِيحَ يُوسُفَ ۖ لَوْلَا أَن تَفْقَهُونَ

“Unë me të vërtetë ndiej erën e Jusufit, edhe pse ju do të më quani të çmendur.”⁶


Pra, ishin pikërisht shqisa të reja që Zoti në atë moment i kishte dhënë Jakubit ^{a.s.} dhe ai arriti të mësonte se Jusufi ishte i gjallë dhe se së shpejti do të takohej me të. Këtë erë nuk e nuhatën dot të tjerët që ishin të pranishëm aty, sepse atyre nuk u ishte dhënë ajo shqisë që i ishte dhënë Jakubit ^{a.s.}. Ashtu siç nga kallami bëhet sheqeri, nga sheqeri sherbeti dhe me sherbet bëhen ëmbëlsira të ndryshme dhe delikate, në të njëjtën mënyrë, ëndrra duke u zhvilluar më tej, arrin në gjendjen e *keshfit* dhe quhet i tillë kur bëhet tejte i qartë.”⁷


Synoni dashurinë e Zotit dhe jo keshfin dhe ilhamin

Nuk duhet të nxitoheni që patjetër t’ju hapen dyert e *keshfeve* dhe të *ilhameve*. Nëse nuk vijnë *keshf* a *ilham* edhe gjatë gjithë jetës, nuk duhet të keni frikë. Nëse ndieni se ju keni dashurinë që mund të ketë dikush që do dikë marrëzisht dhe singërisht, atëherë, siç ky përballon etje dhe uri për hir të personit që do, duke mos u merakosur as për bukë, as për ujë dhe as për veten e vet, në të njëjtën mënyrë, edhe ju të përumbeni në dashurinë ndaj Zotit, aq saqë të mos mbetet qenia juaj [interesi vetjak] në mes. Pastaj, duke pasur një lidhje të tillë, njeriu edhe sikur të vdesë, është fatlum. Ne kemi punë me dashurinë personale të Zotit, nuk na interesojnë *keshfet* apo *ilhamet*.⁸

Mendimi që lind në zemër, nuk është komunikim i mirëfilltë me Zotin

Duhet ditur që me shpallje nuk do të thotë frymëzim që i vjen në zemër njeriut






apo fjalë që të vjen në mendje gjatë të menduarit rreth një çështjeje të caktuar. Frymëzimi i poetit tek shkruan ndonjë strofë e mendon për strofën tjetër, teksa ajo i vjen në zemër nuk është shpallje, por rrjedhojë e mendimit që vjen sipas ligjit të natyrës që ka caktuar Zoti.

Çdokush që mendon për gjëra të mira ose për gjëra të këqija, i hyn në zemër diçka në varësi të kërkimit të tij. Nëse një njeri i drejtë që punon për një kauzë të drejtë dhe një tjetër i lig, keqbërës, që punon për të përhapur gënjeshtren, shkruajnë për të mbështetur secili kauzat e tyre, që të dy do të arrijnë të shkruajnë diçka. Madje, nuk duhet të çuditemi nëse i ligu përmes mjeshtërisë së vet arrin ta mbështesë gënjeshtren në vargjet e tij edhe më fort sesa i drejti. Kështu që, nëse i themi shpallje asaj që lind në zemër, do të na duhet të quajmë marrës të shpalljes prej Zotit edhe një keqbërës që lufton me penën e tij kundër së vërtetës.

Ka plot në botë që shkruajnë romane me një stil që të magjeps dhe me një temë që të zbret rrjedhshëm në zemër, por që mund të jenë thjesht trillime dhe tërësisht të pavërteta. A mund t'i quajmë edhe ato si shpallje?! Madje, nëse shpallja është vetëm diçka që lind në zemër, nganjëherë edhe një vjedhës do të cilësohej si marrës i shpalljes, sepse sajton plane nga më dredharaket për të vjedhur e për të vrarë njerëz të pafajshëm. Të gjitha këto prapësi, vallë, a mund t'i quanim shpallje?! Kurrresi jo. Diçka të tillë e quajnë shpallje vetëm ata që deri më tani nuk e kanë njohur aspak Zotin e Vërtetë, i cili me komunikimin e Tij të veçantë qetëson zemrat dhe u jep të paditurve dijet Hyjnore.

Çfarë është shpallja? Është komunikim dhe bisedë e gjallë dhe e fuqishme e Zotit të Shenjtë dhe të Plotfuqishëm me një rob të Tij të zgjedhur ose me atë, të cilin Ai dëshiron ta zgjedhë. Kur kjo bisedë dhe ky komunikim zhvillohet me një vijimësi të qartë, ku të mos ketë asnjë përzjerje të errët të mendimeve të këqija dhe as fjalë të pamjaftueshme e të pakuptimta, por të jetë një bisedë e kënaqshme, plot urtësi dhe plot madhështi, atëherë ky është komunikim i Zotit, me të cilin Zoti dëshiron t'i sigurojë qetësi robit të Tij dhe të manifestohet përpara tij.⁹



Komunikimi me Zotin, a është kundër logjikës?

Logjika e njeriut nëse nuk ngrihet mbi një realitet të provuar, atëherë ky realitet nuk hidhet poshtë vetëm për arsye se logjika nuk e ka rrokur dot atë. Në botë ka plot dukuri qoftë në qeniet e gjalla, qoftë në qeniet jo të gjalla; te kafshët apo te njerëzit, të cilat përvoja nejrëzore i vërteton, por këto dukuri i kapërcejnë kufijtë e logjikës. Logjika e thatë nuk i rrok dot dhe nuk zbulon dot realitetin e tyre.

Në të njëjtën mënyrë është edhe *vahji* që zbret prej Zotit të Madhërishëm dhe që u përçon zemrave të pastra ato dije, të cilat nuk mund të arrihen me forcat njerëzore. Fundja, edhe logjika nuk është gjë tjetër veçse vlerësimi dhe raporti që krijohet me realitetet e provuara, atëherë unë them se *vahji* qiellor është një realitet i provuar, i cili përmban një forcë mrekullibërëse dhe dije të së padukshmes dhe unë marr përgjegjësi për ta provuar këtë gjë.¹⁰

SHËNIME

1. *Kurani Famëllartë* 42:52.
2. *Komentim i Kuranit*, vëll. 7, f. 260; *Gazeta Al-Hakam*, 10 tetor 1906, f. 10.
3. *Komentim i Kuranit*, vëll. 7, f. 260-261; *Gazeta Al-Hakam*, 24 mars 1901, f. 6.
4. *Komentim i Kuranit*, vëll. 7, f. 262; *Berabin-e-Abmedia*, fusnota e fusnotës, f. 220-221.
5. *Komentim i Kuranit*, vëll. 7, f. 263; *Gazeta Al-Bader*, 1 maj 1903.
6. *Kurani Famëllartë* 12:95.
7. *Komentim i Kuranit*, vëll. 7, f. 263-264; *Gazeta Al-Bader*, 13 mars 1905, f. 2.
8. *Komentim i Kuranit*, vëll. 7, f. 268; *Gazeta Al-Hakam*, 17 mars 1903, f. 3.
9. *"Filozofia e mësimëve të Islamit"*, Tiranë, 2019, f. 202-203.
10. *Komentim i Kuranit*, vëll. 7, f. 265; *"Aina Kamalat-e-Islam"* fusnota, f. 238-239.

Zoti është trari i të gjitha përpjekjeve tona

Nëse bëheni të Zotit, dini se Zoti është juaji. Ju do të jeni në gjumë, kurse Zoti i Madhërishëm për ju do të rrijë zgjuar. Ju do të jeni të shkujdesur nga armiku, kurse Zoti do ta vëzhgojë atë dhe do ta shpartallojë planin e tij. Ju ende nuk e dini se çfarë forcash ka Zoti juaj, sepse po ta dinit, nuk do t'ju vinte asnjë ditë e tillë që të brengoseshit kaq shumë për botën. Një njeri që zotëron një thesar, vallë, a mund të qajë dhe a mund të pikëllohet e të shkatërrohet kur humb vetëm një qindarkë. Po të ishit në dijeni të thesarit që Zoti juaj ju vjen në ndihmë për çdo nevojë, pse do të bëheshit kaq të vdekur për botën?! Zoti është një thesar i bukur, çmoheni Atë, sepse Ai është Ndihmësi në çdo hap tuajin. Pa Atë ju jeni asgjë dhe as planet dhe mjetet tuaja nuk mund të bëjnë ndonjë gjë.




Foto nga Eberhard Grossgastelger | Pexels



Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi



Dera e shpalljes është e hapur edhe tani

Mos mendoni se shpallja e Zotit nuk vjen më dhe se i takon vetëm së kaluarës¹ dhe se Shpirti i Shenjtë nuk zbret dhe se ka zbritur vetëm në kohërat e mëparshme. Singlerisht ju them të vërtetën, çdo derë mbyllet, por dera nga e cila zbret Shpirti i Shenjtë kurrë nuk mbyllet. Hapni dyert e zemrave tuaja, që ai të hyjë në to. Ju largoheni vetë nga Ai Diell, në momentin kur mbyllni dritaren nga e cila mund të hyjë rrezja e Tij. O i pamend! Çohu dhe hape këtë dritare! Atëherë, Dielli vetvetiu do të hyjë brenda teje. Derisa Zoti nuk jua mbyllirë rrugët e bekimeve tokësore në këtë kohë, përkundrazi jua shtoi edhe më shumë, a mendoni që Ai ju paska mbyllur rrugët e bekimeve qiellore, të cilat ju duheshin shumë në këtë kohë? Kurrsesi jo. Madje, ju është hapur me shumë qartësi.

Dhe tani që Zoti juaj hapi derën e të gjitha bekimeve të mëparshme, mu sipas Fjalës së Tij që Ai ju ka mësuar në suren El-Fatiha, ju vetë pse nuk pranoni t'i merrni ato? Jini të etur për këtë burim, që t'ju arrijë uji vetvetiu. Qani si foshnjë, që të dalë qumështi vetvetiu prej gjirit për ju. Bëhuni të denjë për t'u mëshiruar që të mëshiroheni. Shfaqni dhimbjen, që të gjeni karar. Lëshoni klithmat vazhdimisht, që një Dorë t'ju kapë për dore. Sa e vështirë është kjo rrugë, që është rruga e Zotit! Por ajo u bëhet e lehtë atyre që hidhen për "të vdekur" në këtë gropë të thellë, sepse ata e kanë vendosur me zemër se pranojnë zjarren e digjen për të Dashurin e tyre. Por, si përfundim, zjarri ku ata hidhen qenka një parajsë! ... Ata që për hir të Zotit hidhen në këtë zjarr, do të shpëtojnë.

Kurse ai që për shpirtin am-marah² të tij ndjek rrugën e zjarrit, zjarri do ta gllabërojë atë. Të bekuar janë ata, të cilët luftojnë shpirtin e keq të tyre për hir të Zotit, dhe fatligë janë ata që luftojnë Zotin për hir të shpirtit të tyre të keq dhe nuk afrohen me Të. Ai që anashkalon urdhrin e Zotit për hir të shpirtit të tij, kurrsesi nuk do të pranohet në qiell. Prandaj, përpiquuni të mos dëshmojë kundër jush qoftë një fjalë a një pikë e Kuranit Famëllartë, që të mos ndëshkoheni pikërisht për atë pikë. Sepse, edhe një ligësi e vogël është e ndëshkueshme. Pak kohë keni dhe jetës nuk i dihet. Nxitoni, sepse po afrohet nata. Kontrolloni mirë atë që keni për të paraqitur, në mos ju mbetet ndonjë gjë e mangët; në mos keni marrë diçka të dëmshme, ose në mos gjithçka e juaja është e pistë dhe e kotë, apo e padenjë për t'u paraqitur në oborrin Mbretëror.

("Mësimi ynë", f. 27-29, Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2020)

[1] Sheriati u mbyll me ardhjen e Kuranit Famëllartë, por jo shpallja, sepse ajo është shpirti i fesë së vërtetë. Feja që nuk ka shpallje të vazhdueshme, është e vdekur dhe Zoti nuk është me të. (Autori)

[2] Shpirti a nefsi që nxit fort për të keqen. (Përkthyesi)



Pse shohim ëndrra të vërteta?

Pse njerëzve disa ëndrra nuk u dalin?

Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s.

Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu ^{a.s.}

Sa lloje ëndrrash ka?

“Janë tri lloje ëndrrash:

- 1) ëndrrat që i tregon njeriut vetja e tij,
- 2) ëndrrat nga djalli dhe
- 3) ëndrrat nga Zoti i Gjithëmëshirshëm.

Ëndrrat që i tregon njeriut vetja e tij janë pasqyrim i mendimeve të tij, si një mace që ëndërron mbeturinat e mishit. Ëndrrat nga djalli shkaktojnë frikë dhe panik. Ëndrrat Hyjnore janë mesazhe nga Zoti i Madhërishëm.

Dëshmia e ëndrrave prej Zotit është vetë përjetimi. Këto gjëra kanë lidhje me çështjet Hyjnore që janë shumë larg nga çështjet e dynjasë. Nëse kufizohemi për t'i arsyetuar vetëm me anë të logjikës, as ne nuk mund t'i shpjegojmë tjetrit dhe as tjetri nuk mund të na kuptojë ne. Ato përbëjnë shenja të ekzistencës së Zotit, që Ai i dërgon në zemër nga e padukshmja. Njeriut i vjen besimi

vetvetiu, kur ai përjeton një ëndërr të tillë, më pas kur edhe dëshmon se ajo që i ishte treguar atij, u plotësua. Matësi i çështjeve të kësaj bote nuk mund ta njohë dot këtë fenomen. Këto janë çështje shpirtërore, të cilat mund t'i kuptoni siç duhet vetëm kur do t'i njihni po me anë të tyre. Ëndrra vetë e sjell provën e vërtetësisë së saj, kur përmbushet.”¹

Aftësitë e mendjes dhe aftësitë e zemrës

“Duhet të dimë se Zoti i Madhërishëm e ka ndërtuar trurin e njeriut në një formë të veçantë në mënyrë që ta njohë Krijuesin e tij, të arrijë deri në shkallën e bindjes në besimin ndaj Tij dhe ndaj cilësive të Tij.

Pra, nga njëra anë i dhuroi njeriut aftësitë e logjikës, me të cilat ai studion krijesat e Zotit të Madhërishëm, thellohet në urtësinë që ka lënë Zoti në çdo grimcë, qoftë i lartësuar Emri i



Tij, në organizimin e përkryer dhe në sistemimin e përsosur të universit, dhe arrin të kuptojë me kthjelltësi të plotë se i gjithë ky univers me gjithë token dhe qiejt nuk mund të jenë pa ndonjë Krijues, përkundrazi, duhet të jetë patjetër Ai që krijoi ato.

Dhe nga ana tjetër, Zoti i dhuroi nejrut edhe ndjesitë dhe aftësitë shpirtërore, në mënyrë që mangësinë dhe mundësinë për të gabuar që ai has gjatë njohjes së Zotit përmes aftësive të logjikës, t'ia plotësojnë aftësitë shpirtërore.

Sepse dihet që vetëm me anë të aftësive të logjikës njeriu nuk mund ta njohë në mënyrë të përsosur Zotin e Madhërishëm, pasi ato maksimumi i mundësojnë të studiojë një nga një token dhe trupat e tjerë qiellorë, të zbulojë përsosmërinë e tyre dhe të nxjerrë përfundimin se e gjithë kjo botë me kaq shumë realitete dhe me kaq plot urtësi, duhet të ketë një Krijues.

Ato nuk i mundësojnë njeriut të arrijë në njohjen e përsosur që i thotë se Ai Krijues edhe gjendet.

Por ne e dimë që vetëm të ndjesh nevojën e një Krijuesi nuk mund të jetë njohje e përsosur, sepse kjo e dyta vjen vetëm kur njeriu arrin në shkallën e bindjes që Ai Krijues edhe gjendet. Pohimi që krijesat duhet të kenë një Krijues kurrësi nuk mund të jetë i barabartë me pohimin që Ai Krijues edhe ekziston.

Pra, për të plotësuar rrugëtimin e tyre dhe për të përmbushur etjen e tyre të natyrshme në njohjen e përsosur të Krijuesit, ishte domosdoshmëri që kërkimtarët e së vërtetës, përveç aftësive të logjikës, të kishin edhe aftësitë shpirtërore. Këto aftësi shpirtërore duke u përdorur plotësisht dhe pa ndonjë pengesë gjatë rrugës, u mundësojnë kërkuesve të së vërtetës të arrijnë ta shohin Fytyrën e të Dashurit

aq pastërtisht, që vetëm me aftësitë e logjikës nuk t'i arrinim dot.

Prandaj, Ai Zot që është shumë Bujar dhe shumë Mëshirëbërës, siç e ka lënë në natyrën e njeriut etjen dhe urinë e njohjes së përsosur të Zotit, në të njëjtën mënyrë i dhuroi natyrës njerëzore dy lloje aftësish, që ta çojë atë drej njohjes së përsosur:

1. aftësitë e logjikës që burojnë nga mendja dhe
2. aftësitë shpirtërore që burojnë nga zemra.

Pastërtia e aftësive shpirtërore varet nga pastërtia e zemrës dhe dukuritë që aftësitë e logjikës nuk i perceptojnë dot, aftësitë shpirtërore arrijnë t'i perceptojnë. Gjithashtu, aftësitë shpirtërore kanë vetëm forcën e pasqyrit, pra arrijnë të pastrohen aq sa bekimet e Bekuesit pasqyrohen në to. Për këtë arsye, ato e kanë si kusht të domosdoshëm të jenë të gatshme për ta arritur bekimin dhe të mos kenë pengesa ose perde në mes, në mënyrë që të marrin bekimin e njohjes së përsosur prej Zotit të Lartësuar dhe në mënyrë që njohja e tyre të mos mjaftohet në pranimin se ky univers e ka një Krijues, por të arrijnë edhe të komunikojnë në mënyrë të përsosur me Krijuesin, të shohin drejtpërdrejt shenjat dhe Fytyrën e Tij dhe me sytë e bindjes të dëshmojnë se Ai Krijues edhe

ekziston.

Por ngaqë shumica e njerëzve nuk janë pa perde, përkundrazi janë të zhytur në dashurinë për botën, në lakmi, mburrje, inate, vetëpëlqime, dukje, adhurim të nefsit dhe vese të tjera; me vetëdije gabojnë dhe harrojnë detyrimet që kanë ndaj Allahut dhe ndaj robërve të Tij; me vetëdije anashkalojnë kushtet e qëndrueshmërisë, nuk u përmbahen imtësive të dashurisë dhe besnikërisë ndaj Zotit dhe kanë tendencë të shkëpusin lidhje me Zotin e Madhërishëm, për shkak të gjithë këtyre perdeve, pengesave, dëshirave dhe epsheve të nefsit. Ata nuk janë të denjë të gëzojnë në një sasi me vlerë bekimin e komunikimit me Zotin, komunikim i cili të ketë edhe dritë të pranimit prej Zotit.

Pse shohim ëndrra të vërteta?

Po, Zoti i Gjithëmëshirshëm që nuk deshi që aftësitë e njeriut të shkojnë kot, ka lënë si gjurmë të shumica e njerëzve praktikën e Tij duke bërë që nganjëherë ata të përjetojnë ëndrra të vërteta, madje edhe *ilhame* të vërteta, në mënyrë që të zbulojnë se kanë një rrugë përpara për t'u drejtuar. Megjithatë, në ëndrrat dhe në ilhamet e tyre nuk ka efekte të pranimit, të dashurisë dhe të bekimit prej Zotit dhe as njerëzit e tillë nuk janë të pastër nga papastërtitë e brendshme.

Njerëzve të tillë, ëndrrat u vijnë për

t'u dhënë argumente për të besuar në Profetët e Pastër të Zotit. Sepse, po të ishin tërësisht të privuar nga perceptimi i ëndrrave të vërteta dhe i ilhameve të vërteta, dhe të mos kishin një dije të shkallës së bindjes në lidhje me to, atëherë përpara Zotit të Madhërishëm ata do të kishin justifikimin se, duke qenë tërësisht në padijeni për këtë sferë, nuk ishin në gjendje të kuptonin realitetin e profetësisë. Ata do të kishin të drejtë t'i drejtoheshin Zotit duke thënë – Ishim tërësisht të painformuar nga realiteti i profetësisë dhe se nuk gjenim asnjë shembull të kësaj sfere në natyrën tonë njerëzore, andaj nuk mund ta kuptonim dot këtë realitet të fshehtë.

Prandaj, është në praktikën e Allahut, që kur Ai e krijoi botën, t'u dërgojë ëndrra të vërteta, madje dhe ilhame të vërteta njerëzve në përgjithësi, pa marrë parasysh në janë të pastër a të papastër, të sinqertë a të ligj, të drejtë në besimin e tyre a ndjekës të një feje të gënjeshtërt. Kjo ndodh në mënyrë që hamendja dhe përfytyrimi i tyre që vjen nga të lexuarit të historisë dhe nga të dëgjuarit, të arrijë drejt shkallës së bindjes dhe të kenë një shembull në dorë për përparimin shpirtëror.

Realisht, Zoti i Urtë për ta realizuar këtë qëllim, njeriut i ka dhënë një mendje të tillë dhe aftësi të tilla shpirtërore, nëpërmjet të cilave të mund të shohë ëndrra të vërteta dhe të mund

të marrë ilhame të vërteta. Por, këto ëndrra dhe ilhame të vërteta nuk janë argument i ndonjë madhështie apo pastërtie njerëzore, por thjesht shembuj për të vijuar rrugëtimin e përparimit shpirtëror.”²

Çfarë dallimi ka mes njerëzve të zakonshëm që shohin ëndrra dhe të Dërguarve të Zotit?

“Shumë prej naivëve besojnë se janë në të njëjtën pozitë të lartë shpirtërore me të Dërguarit e Zotit, duke qenë se edhe ata shohin ëndrra të vërteta apo marrin ilhame të vërteta. Por, aftësia për të parë ëndrra dhe për të marrë ilhame në një sasi kaq të paktë, u është dhuruar edhe njerëzve të thjeshtë, në mënyrë që edhe ata të kenë një imazh të vogël të atyre dukurive që në të vërtetë janë përtej botës materiale. Dhe kështu, duke pasur atë imazh, ata të mos e humbasin pranimin e së Vërtetës dhe gjithashtu ky fenomen të mbetet si argument që ata ta kuptojnë të vërtetën.

Përndryshe, nëse njerëzit do të ishin krejt të paditur për sa i përket përjetimit të ëndrrave të vërteta dhe të marrjes së shpalljeve, ata nuk do të arrinin gjë, veçse ta mohonin të Vërtetën, dhe kështu, deri diku do të kishin edhe të drejtë. Mendoni pak, pavarësisht nga prania e kësaj aftësie te njerëzit, filozofët e botës së sotme i mohojnë shpalljet Hyjnore dhe ëndrrat e vërteta. Atëherë

ku do të përfundonin njerëzit e thjeshtë, nëse nuk do të ekzistonte ky shembull i ëndrrave dhe i shpalljeve të njeriut?

Gjithashtu, mendimi: “edhe ne shohim nganjëherë ëndrra të vërteta dhe marrim ndonjë shpallje” nuk e cenon aspak madhësitinë e Profetëve, sepse ëndrrat dhe shpalljet që u bëhen njerëzve të thjeshtë nuk janë të qarta nga mjegulla e dyshimeve dhe gjithashtu edhe në sasi janë të pakta. Ashtu siç një i varfër me një lekë në xhep, nuk mund të matet me një mbret të pasur duke i thënë – edhe unë kam para, në të njëjtën mënyrë, krahasimi i njerëzve të thjeshtë me Profetët është i kotë dhe krejt absurd.”³

SHËNIME

1. “*Melfuzat*” vëll. 4, f. 368-369.
2. Mirza Ghulam Ahmed^{a.s.}, “*Hakikatul-Vahji*” (*Realiteti i Shpalljes*), “*Rubani Khazain*” vëll. 22, 2009, UK, f. 7 – 11)
3. “Damima Berahin-e-Ahmedia”, “*Rubani Khazain*” vëll. 21, 2009, UK, f. 214 – 215, fusnota.



MENDIMI JUAJ ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR NE

Na shkruani komentet, mendimet dhe sugjerimet tuaja në WhatsApp, Viber ose Telegram në numrin

+355 69 4644 888

ose në email

vërtetësia@gmail.com

VËRTETËSIA

Zoti ynë bën mrekulli të panumërta, por i shohin vetëm ata që bëhen të Atij me vërtetësi dhe besnikëri. Ai nuk u shfaq mrekullitë e Tij të tjerëve që nuk besojnë me bindje në fuqitë e Tij dhe që nuk janë të vërtetë e besnikë ndaj Tij.

Sa fatkeq është ai njeri që ende nuk di se ai ka një Zot, i cili ka fuqi mbi çdo gjë! Parajsa jonë është Zoti ynë. Kënaqësitë tona më të larta gjenden në Zotin tonë, sepse ne e pamë Atë dhe çdolloj bukurie gjetëm në Të. Kjo pasuri është me vlerë ta marrësh nëse e gjen duke dhënë edhe jetën. Dhe ky rubin është me vlerë ta blesh edhe sikur të kushtojë sa e gjithë qenia jote. O të humbur, vraponi drejt këtij burimi se do t'jua shuajë etjen. Ky është burimi i jetës që do t'ju shpëtojë. Ç'të bëj unë? Si mund ta gdhend në zemrat e njerëzve këtë lajm të gëzuar? Me çfarë daulleje t'i njoftoj njerëzit se Ky është Zoti i tyre? Dhe me çfarë ilaçi t'ua kuroj veshët që ata të fillojnë të dëgjojnë?

Parajsa jonë është Zoti ynë.



SHKOLLA TË NDRYSHME TË MENDIMIT ISLAM

- Hazret Mirza Tahir Ahmed ^{r.a.}

Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar



Në vijim ju sjellim një nga kapitujt e librit fenomenal të Hazret Mirza Tahir Ahmedit, Kalifit të Katërt të Xhematit Musliman Ahmedia, të titulluar "Revelation, Rationality, Knowledge & Truth" (Zbulesa, arsyeya, dija dhe e vërteta), të botuar për herë të parë në vitin 1998.

Botëkuptimi islam mund të paraqitet nga dy këndvështrime të ndryshme: së pari, duke analizuar punën e mendimtarëve të ndryshëm muslimanë, dhe së dyti, duke u përpjekur të paraqesim drejtpërdrejt qëndrimin e Kuranit në dritën e Sunetit, i cili përfshin si thëniet ashtu edhe praktikën e Profetit të Shenjtë ^{s.a.v.s.}. Autenticiteti i të kuptuarit të Islamit me metodën e parë po bëhet gjithnjë e më i dyshimtë me kalimin e kohës. Kjo për arsye se mendimtarët muslimanë janë të prirur të bëhen gjithnjë e më tepër më dogmatikë në përfundimet e tyre, të cilat jo domosdoshmërisht mund të jenë të arsyeshme e të justifikuara. Ajo çka ata quajnë islam, bazohet në studimet që vetë ata bëjnë mbi parimet e Islamit. Kurse ata që nxjerrin konkluzionet e tyre nga Kurani dhe Suneti, njëherësh duke iu përmbajtur rreptësisht edhe parimit

të racionalitetit, mund t'i veçojmë në një kategori më vete. Një studim të tillë analitik të çështjeve kryesore do ta gjeni në një kapitull tjetër të këtij libri. Tani për tani, le t'i kthejmë vëmendjen metodës së parë, dhe të diskutojmë mbi proceset e mendimit të studiuesve, të mendimtarëve dhe të filozofëve të hershëm muslimanë, të epokës që ndikoi në formimin e shumë shkollave të ndryshme të mendimit islam. Dy ndikime dalluese zotëruan skenën gjatë periudhës së hershme të historisë islame:

1) Ndikimi më i fuqishëm dhe mbizotërues ishte ai i Kuranit dhe i Sunetit, i cili kishte revolucionarizuar konceptin e dijes dhe kishte zgjeruar horizontin e studimit dhe të hulumtimit në përmasa të pafundme.

2) Interes në rritje për filozofinë dhe shkencat greke, si dhe studimi i filozofisë klasike të Indisë, të Persisë dhe të Kinës, pati gjithashtu një rol në zhvillimin e mendimit musliman. Kjo hapi rrugën që filozofë të ndryshëm të huaj të vinin në qendër të vëmendjes së muslimanëve, në mënyrë të pavarur ose duke pasur lidhje me mësimet islame.

Për shkak të këtij interesi për filozofi të ndryshme të huaja dhe prej dëshirës për t'i ndërlidhur ato me shpalljet Kuranore, u formuan shkolla të reja të mendimit. Këto shkolla janë quajtur islame për arsyen e thjeshtë se ato zunë fill me

mendimin, edukimin dhe besimet islame. Kështu që, filozofitë e huaja për Islamin filluan të ndërthureshin me studimet e bazuara vetëm mbi Kuranin. Pavarësisht nga fakti se këta studiues të mëdhenj për shkak të qëndrimeve të tyre të lira, u quajtën jomuslimanë nga disa dijetarë mendjengushtë, nuk ka pikë dyshimi se në thelb ata ishin muslimanë. Shoqërimi i tyre me degët laike të dijes rrallëherë mund t'i ketë penguar ata në besimin e tyre. Në këtë drejtim, çdokush ka të drejtë të vendosë vetë, pas një studimi të denjë të Kuranit të Shenjtë dhe të Sunetit, se nëse një këndvështrim filozofik i paraqitur nga mendimtarë të tillë duhet të pranohet si islam apo jo. Sidoqoftë, përfundimet që ata nxjerrin gjithmonë mbeten të hapura për diskutim. Disa mund t'i gjejnë ato në përputhje me mësimet islame dhe disa jo. Megjithatë, kjo nuk i jep të drejtë askujt të dyshojë në synimet e tyre. Është e drejta e çdo kërmimtari të së vërtetës që të ketë përfundimet e veta pasi të përpiqet me sinqeritet për të kuptuar Kuranin dhe Sunetin deri në thellësi. Po kështu, është gjithashtu e drejta e të tjerëve të mos pajtohen me të. Por asnjëri nuk ka autoritetin ta ndalojë tjetrin nga e drejta e tij themelore për të besuar në çfarëdo qoftë dhe për të besuar për veten e tij se është në rrugën e vërtetë.

Tani do të prezantojmë shkurtimisht

disa nga shkollat e larmishme të mendimit islam, të cilat u ngritën për shkak të përfundimeve të ndryshme që ata nxorën nga studimi i të njëjtave burime. Sidoqoftë, duhet të kemi parasysh se çdo shkollë që pretendon se bazohet në Kuranin e Shenjtë dhe në Sunetin, të vlerësohet me kujdes duke iu referuar drejtpërdrejt provave që ajo jep në mbështetje të saj. Nga ideologjitë dhe këndvështrimet e ndryshme që lindën në epokën e sundimit musliman, jo të gjitha mund të përshkruheshin si islamike në karakter. Disa prej tyre ishin pjesërisht kontradiktore apo edhe diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën. Megjithatë, kjo nuk u heq atyre të drejtën për t'u vetëquajtur si islamike nga përkrahësit e tyre.

Shkolla Esh'arite

Shkolla e mendimit esh'arite i detyrohet Imam Abul Hassan 'Ali Bin Isma'il El-Esh'ariut (260-330 hixhri) për stilin e saj të veçantë në mesin e shkollave të tjera kryesore të mendimit. Gjatë kësaj periudhe disa studiues muslimanë po përkrahnin me shpejtësi racionalizmin, kështu që u ndje nevoja për të reaguar kundër kësaj prirjeje. Në krye të kësaj lëvizjeje reaksionare ishte i famshmi Imam Isma'il El-Esh'ari. Për ironi të fatit mësuesi i vetë El-Esh'ariut, El-Xhubbai (vdiq në 303 hixhri), ishte një nga studiuesit kryesorë racionalistë të kohës. Imam El-Esh'ariu jo vetëm

që shprehu mospajtimin e tij me racionalistët, por gjithashtu tregoi fuqishëm papërshtatshmërinë e çdo sistemi që mbështetet tërësisht në racionalitet për të kërkuar të vërtetën.

Për esh'aritët, racionaliteti nuk çon as në përvetësimin e dijeve të bindshme dhe as në të vërtetën absolute, përkundrazi ata mendonin se ajo çon në dyshime dhe kontradikta të mëdha. Shkolla esh'arite theksoi se i vetmi mjet për të arritur dijen e vërtetë dhe absolute është njohja dhe pranimi i shpalljes, sepse burimi i përjetshëm i së vërtetës është Vetë Zoti. Prandaj mënyra e vetme për ta arritur atë është përmes shpalljes Hyjnore.

Në reagimin e tyre kundër racionalitetit, disa esha'ri shkuan në ekstreme të tilla, aq sa refuzuan çdo shpjegim të ajeteve Kuranore të mbështetur në logjikën njerëzore. Mohuan plotësisht çdo interpretim figurativ të Kuranit të Shenjtë. Vetë Imam Esh'ariu ishte një logjicien i aftë. Është interesante sesi argumentet që ai solli kundër përdorimit të racionalitetit bazoheshin në racionalitet. Kjo spikatet në një nga debatet e tij të famshme publike që bëri kundër vetë mësuesit të tij, Alame El-Xhubbai.

– Cili është qëndrimi juaj rreth shpëtimit të tre vëllezërve, ndër të cilët njëri është besimtar, tjetri jo besimtar dhe i treti fëmijë?, pyeti Esh'ariu El-Xhubbain.

– Besimtari do të shkojë në xhenet, jo besimtari në xhehenem, kurse fëmija nuk do të shkojë as në xhenet e as në xhehenem, sepse asnjë nga veprat e tij nuk është e denjë për shpërblim a ndëshkim, iu përgjigj El-Xhubbai.

Esh'ariu komentoi duke thënë, – Fëmija mund të argumentojë me Zotin: “Nëse do të më kishe dhënë ca kohë, o Zot, do të kisha bërë disa vepra të mira. E përse duhet të privohem nga xheneti?”

Xhubbai iu përgjigj – Zoti mund t’i përgjigjet: “Unë e dija që nëse do të rriteshe, do të bëje vepra të këqija, prandaj vdekja jote në moshë të re është vërtet një mirësi për ty, sepse kështu ke shpëtuar nga xhehenemi”.

Esh'ariu iu kundërpërgjigj – Në këtë moment jo besimtari do të ndërhyjë dhe do ta fajësojë Zotin për padrejtësi që nuk i dha edhe atij vdekjen në fëmijëri duke e shpëtuar edhe atë nga veprat e këqija.

Vlen të theksohet se gjatë argumentimit kundër racionalitetit, Esh'ariu përdorte të gjitha armët e racionalistëve. Prandaj, nuk është e drejtë të thuhet se ai ishte plotësisht kundër racionalitetit. Pasuesit e kësaj shkolle të mendimit, si Imam Ghazali dhe Imam Raziu, u mbështetën shumë në argumente racionale për të zgjidhur problemet e tyre dhe për të vendosur besimet e tyre. Ndoshta reagimi i tepruar kundër racionalizmit ishte për

shkak të frikës se filozofitë e reja, me të cilat po njiheshin muslimanët, mund të rrezikonin pikëpamjen islame. Dyshohej se përdorimi i arsyes mund të çonte në krijimin e lëvizjeve që përfundimisht do të devijonin nga Islami i vërtetë. Prandaj, të gjitha lëvizjet me prirje racionaliste u quajtën *ilhadi* ose risi të gabuara, që është një term poshtërues sepse nënkupton devijimin nga rruga e drejtë. Shqetësimi i dijetarëve ekstremistë u pasqyrua në termat që ithtarët e tyre përdorën për të përshkruar themeluesit e lëvizjeve racionaliste. Ata iu referuan atyre si *Mu'tezilitë* ose ata që ishin larguar nga rruga e vërtetë dhe ishin bërë *ilhadi*.

Një grup tjetër i njohur si *Maturiditë* besonin se së pari zbulesa duhet të pranohet si e tillë dhe më pas duhen kërkuar shpjegime të logjikshme për ta mbështetur atë. Ata besuan se shpallja forconte besimin, ndërsa shpjegimet logjike mundësojnë qetësinë e mëtejshme për atë besim. Shkolla esh'arite nuk i refuzoi plotësisht shpjegimet logjike, por i konsideroi ato të panevojshme; nëse ato do të ishin të disponueshme, shumë mirë, përndryshe gjithçka që erdhi përmes shpalljes ishte krejt e mjaftueshme, madje edhe pa mbështetje të logjikës dhe të racionalitetit.

Si krahu i djathtë i lëvizjes esh'arite, u krijua një sekt tjetër i njohur si *Selef* (pasuesit e verbër të dijetarëve të hershëm dhe të famshëm). Sipas tyre, zbulesa ose

shpallja duhet të pranohet pa diskutim dhe se asnjë shpjegim filozofik ose logjik nuk lejohej të pranohej, pasi ata kishin frikë se kjo do të çonte në devijim nga rruga e drejtë.

Shkolla Mu'tezilite

Mu'tezilitët nga ana e tyre nuk e hodhën poshtë shpalljen si instrumentin më të besueshëm për të shkuar drejt së vërtetës. Sidoqoftë, ata theksuan se mesazhi i vërtetë i shpalljes nuk mund të kuptohet siç duhet pa përdorimin e arsyes. Kështu, ata i dhanë përparësi arsyes ndaj shpalljes vetëm atëherë kur këto përplasen me njëra-tjetrën dhe mirëkuptimi racionalist duhet të mbizotërojë jo si një alternativë e shpalljes, por si sqarim i mirëfilltë i mesazhit që ka ardhur përmes shpalljes. Ata kishin pikëpamjen se është shumë e vështirë të arrish tek e vërteta e Kuranit të Shenjtë dhe e Sunetit, pa deshifruar në mënyrë racionale figurat, metaforat dhe simbolet e ndryshme që janë përdorur gjerësisht në ta. Për shembull, ata vunë në dukje se shprehjet si: dora dhe fytyra e Zotit, duhet të interpretohen për të nënkuptuar fuqinë dhe bukurinë e Tij, etj. Esh'aritët nga ana tjetër theksuan se referenca të tilla në Kuran përfaqësojnë cilësi reale të Zotit, natyra e saktë e të cilave nuk dihet, megjithëse ata pranuan që me terma të tillë nuk nënkuptohet ndonjë tipar fizik.

Ndonëse lëvizja mu'tezilite nga shekulli IX deri në shekullin XVII të e.s., duket se ngjan në karakter me shkollat evropiane të mendimit, ajo nuk mori kthesën *ilhadi* (risi e gabuar), siç kishte marrë racionalizmi evropian gjatë rënies së tij progresive. Mu'tezilitët gjithnjë iu përmbajtën burimeve origjinale të Islamit, pra Kuranit të Shenjtë dhe Sunetit, për të mbështetur argumentet e tyre, duke qëndruar fare pranë tyre dhe duke mos lejuar veten të largoheshin prej tyre.

Por sot ka shumë pak dallime të dukshme midis këndvështrimeve të mu'tezilitëve dhe të esh'aritëve. Megjithëse pasqyra historike e portretizuar më sipër ka lënë gjurmë në kërkimet e studiuesve muslimanë të brezit bashkëkohor, ndarjet e mprehta të së kaluarës nuk përcaktohen aq qartë. Studiuesit e sotëm duket se mbrojnë pikëpamjet e tyre personale më shumë sesa pikëpamjet e ndonjë shkolle pararendëse të mendimit. Sidoqoftë, gjurmët e përfundimeve të së kaluarës janë ende të dukshme. Ato janë produkt i një kompromisi të përshkallëzuar që u zhvillua midis shkollave të ndryshme gjatë shekujsh. Midis tyre janë ata që janë të vendosur me ideologjinë e tyre mesjetare, por nuk i referohen ekskluzivisht ndonjë shkolle të mëparshme për të mbështetur këndvështrimin e tyre. Ata kërcejnë nga njëri te tjetri në kërkim të ndonjë studiuesi, çfarëdo shkolle që mund t'i

përkasë, që të mund ta citojnë atë në favor të tyre. Për ta kufijtë midis sekteve të ndryshme mesjetare janë zhdukur, por vetë mesjeta vazhdon të ekzistojë, duke udhëhequr rrugën e tyre. E njëjta gjë vlen deri diku për të ashtuquajturit modernistë. Kurdoherë që i përshtatet qëllimit të tyre, ata nuk hezitojnë të citojnë ndonjë prej studiuesve të mëparshëm në favor të tyre, por veten e ndiejnë të lirë të krijojnë risi në fusha të tjera të pikëpamjeve të tyre personale.

Sufizmi

Sufizmi ishte mjaft i popullarizuar në Turqi, Iran dhe në vendet në lindje të Amu Derjasë (Amu Darya), një zonë që historikisht quhet si Transoxiana (Përtej Lumit). Shumë muslimanë nga ish-BRSS ishin pasues të sufizmit, i cili ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mbajtjen gjallë të Islamit në vendet e tyre gjatë periudhës së Çezarit dhe në kohën e Komunizmit.

Parimi më i theksuar nga sufizmi ishte se nën formën e fesë, vepron një frymë e shpalljes, së cilës duhet t'i jepet përparësi mbi formën. Ajo që sufistë kuptuan si fryma e nëntëshme ishte thjesht qëllimi përfundimtar për të cilin të gjitha fetë përpiqen. Qëllimi përfundimtar u identifikua si dashuria e Zotit dhe komunikimi me Të. Prandaj, për ta, nëse e arrini këtë qëllim disi, me ose pa iu bashkuar formës, keni korrur

sukses dhe kjo është gjithçka që ju duhet. Sidoqoftë, jo të gjithë sufistë e braktisën formën krejtësisht, madje vazhduan t'i nënshtrohen në përputhje me ligjet e Sheriatit islam siç i kuptuan ata. Megjithatë, shumicën e përpjekjeve të tyre që jo për t'u angazhuar në adhurimin formal, por për të përsëritur ditë e natë disa attribute të Zotit, me qëllim që ta përqendronin vëmendjen e tyre tërësisht në përkujtimin e Tij. Praktika të tilla herë-herë kalonin afër ushtrimeve të jogës, që kemi diskutuar në kapitullin kushtuar hinduizmit. Ndonjëherë mënyra dhe metoda të reja të përkujtimit u shpikën nga shenjtorë të ndryshëm sufistë, të cilat, më në fund, u ndanë pothuajse tërësisht nga Suneti i mirënjohur i Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}. Ithtarët e sekteve të tilla sufiste iu përmbajtën atyre metodave më me pasion dhe më me zell sesa mësimit Kuranor. Kështu, shkolla të reja të sufizmit dolën në dritë në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme të botës muslimane.

Qëllimi i kësaj trajtese nuk është të përshkruajë hollësisht gjithë gamën e zhvillimit të mendimit sufist – ose të skizmave që u shfaqën midis sufive ndër shekuj – por një gjë që e dallon shumë qartë sufizmin në Islam nga të gjitha praktikat e tjera të ngjashme është besimi i patundur i sufive në vazhdimësinë e shpalljes ose në komunikimin e tyre me Zotin. Në fakt,

të gjithë sufite e shquar në Islam kanë pretenduar të ishin në komunikim të vazhdueshëm me Zotin. Kështu, shumë nga shpalljet e tyre janë të shkruara në libra autentikë. Megjithatë, disa prej tyre i kanë prishur të gjitha lidhjet me bazat e islamit. Për ta qëllimi i fesë është vetëm ta udhëzojë njeriun drejt Zotit dhe për ata që tashmë e kanë arritur këtë qëllim, format e adhurimit janë thjesht të tepërta. Ata paraqitën disa ushtrime mendore e shpirtërore duke pretenduar se janë të mjaftueshme për të vendosur një lloj komunikimi mes njeriut dhe Zotit. Ky komunikim i tyre nganjëherë përshkruhet si një përhumbje në njësinë e Zotit. Nuk u desh shumë kohë që muzika dhe varësia ndaj drogës të gjenin rrugën e tyre në këtë shkollë të sufizmit, për t'i shkëputur ata nga realiteti dhe për t'i zhvendosur në një mirazh dhe në një botë të vetëmashtrimit. Shkurt, jo të gjitha lëvizjet sufiste e filluan udhëtimin e tyre me risi, megjithëse, shumë shpesh, me kalimin e kohës, gjatë dekadencës së tyre, ata shkuan drejt risive.

Katër sekte kryesore sufiste

Ekzistojnë katër sekte kryesore të sufizmit të vendosura mirë dhe shumë të respektuara, të cilat gjithashtu devijuan me kalimin e kohës nga rruga e Sheriatit. Megjithatë, për sa u përket themeluesve të tyre, besnikëria e tyre ndaj Kuranit të Shenjtë dhe Sunetit të Profetit ^{s.a.v.s.}, qëndron e padiskutueshme dhe e pa

kontestueshme. Këto sekte kryesore janë: *Çishtî, Subreverdi, Kaderi* dhe *Nakshibendi*, dhe këto ndahen më tej në shumë nën-sekte të tjera. Që të gjitha theksojnë rëndësinë e përkores dhe të asketizmit për të lehtësuar arritjen e së vërtetës. Fillimisht, këto praktika nuk zëvendësonin praktikat tradicionale islame, por u shtoheshin atyre.

Gradualisht, kuptimi sufist i marrëdhënies krijesa-krijuesi filloi të ndikohej nga filozofi të tilla që ishin të huaja për Islamin. Për shembull, ndikimi i filozofisë klasike greke mund të gjurmohet në disa sekte sufiste. Nocioni grek i panteizmit [vehdetul-vuxhud] u përvetësua në një formë të modifikuar nga disa sekte sufiste, megjithëse kundërshtohet fuqimisht nga të tjerat. Kundërshtarët e tendencave panteiste theksojnë se ekziston një vijë ndarëse e qartë dhe e dalluar midis Zotit dhe krijimit të Tij. Sipas tyre, pavarësisht se krijimi mban një vulë të Krijuesit dhe e pasqyron Atë, ai nuk shkrihet në identitetin e Tij. Përkundër kësaj, disa fraksione të tjera besojnë se ngaqë i gjithë universi është një manifestim i Zotit, nuk mund të ketë dallim të qartë mes Krijuesit dhe krijimit. Për ta, krijimi nuk mund të ndahet nga Zoti, sepse cilësitë e Tij janë të pandashme nga natyra e gjithçkaje që Ai ka krijuar. Nuk mund të vendoset asnjë vijë ndarëse. Prandaj, sipas tyre, Zoti është universi dhe universi është Zoti, megjithatë,

Ai ka Vullnetin e Tij të pavarur, që funksionon sikur funksionojnë tiparet e natyrës në materie.

Në pamje të parë kjo skicë e universit mund të duket tërësisht panteiste, në të cilën Zoti është gjithçka dhe gjithçka është Zoti. Por duhet theksuar një ndryshim i rëndësishëm. Nocioni panteist rreth Zotit nuk njeh një Krijues të jashtëm të Vetëdijshëm, një Qenie që komunikon me njeriun përmes zbulesës, që interesohet për sprovat, problemet dhe gëzimet e tyre dhe që u jep udhëzime. Kurse sufijtë muslimanë, në kundërshtim me pikëpamjen klasike panteiste, vazhduan të besonin në identitetin e pavarur të Zotit si Krijues më vete, pavarësisht se reflektohet në krijimin e Tij.

Për sa i përket temperamentit të sufive, ata rrallë u prirën për debate dhe polemika të ashpra. Ata shpesh tregoheshin të moderuar në besimin e tyre dhe respektonin dhe toleronin pikëpamjet që u kundërviheshin pikëpamjeve të tyre. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për mendimin ekstremist që ushqeui zilinë në mënyrë progresive. Prandaj, shumica e sekteve sufiste u detyruan të përballeshin me armiqësi të tejskajshme nga klerikët ekstremistë. Kundërveprime nga ekstremistët bëheshin shpesh. Çdo sekt i sufist iu desh të ndeshej herë pas here me përvoja të ngjashme të armiqësisë ekstreme. Sufijtë

që i përmbaheshin konceptit panteist të Zotit, në mënyrë të veçantë u vunë në shënjestër të zemërimit nga kleri i rrymës së përgjithshme. Madje, disa herë ata u dënuan me vdekje dhe u vranë brutalisht. Protestat e tyre se filozofia e tyre panteiste në asnjë mënyrë nuk kompromentonte unitetin e Krijuesit të Vetëm dhe Suprem nuk sollën asnjë dobi, përkundrazi ata u dënuan ashpër me pretendimin se hyjnizuan veten e tyre me Zotin. Shkurt, të ashtuquajtur dijetarë ekstremistë shpesh ndërmorën fushatën e persekutimeve kundër tyre.

Rasti i sufiut të shquar, Mensur El-Hallaxh, mund të jetë një shembull i përshtatshëm se si sufijtë e tillë u trajtuan me pretendimin se ata shpallnin veten si Zot. Mensur El-Hallaxhin e dënuan me varje për shkak të të bërtiturit të tij në ekstatë *“Enel-Hakk! Enel-Hakk!”* (Unë jam e Vërteta! Unë jam e Vërteta!). Këtë dijetarë ekstremistë e kuptuan që ai po pretendonte të ishte Zoti vetë, ndërkohë që ai në ekstatën e lartë deklaronte mos ekzistencën e tij të plotë. Pra, kuptimi i kësaj thënieje ishte se ai ishte asgjë dhe gjithçka që ekziston është vetëm Ai (Zot). Mensur El-Hallaxhi u ngjiti në trekëmbësh me kokën e ngritur, aspak i frikësuar nga vdekja që e priste. As thirrjet e tij nuk u mbytën dot nga lukunia e abuzimeve që iu vërsul; thirrjet e tij vetëm se u shtuan me zë akoma më të lartë dhe akoma më të qartë:

"Enel-Hakk! Enel-Hakk!", derisa shpirti i tij fluturoi drejt burimit të jetës së tij qiellor.

Një tjetër sekt sufist lindi duke ngritur çështjen nëse universi i jashtëm ishte një fakt apo thjesht një përshtypje e mendjes. Kjo, në fakt, ishte një pyetje shekullore që u ngrit madje edhe nga Platoni dhe Aristoteli. Ajo nuk mund të zgjidhej as atëherë, dhe as sufitë nuk e zgjidhnin dot. Debatu vijon me të njëjtin intensitet edhe midis filozofëve bashkëkohorë dhe asnjëri prej tyre nuk mund ta injorojë atë. Në të vërtetë as koha dhe as hapësira nuk mund të imagjinohen pa hyrë në lojë mendja njerëzore. Një njeriu të çmendur imagjinata e tij i duket po aq e vërtetë sa i duket një shkencëtari vëzhgimi i ligjeve të natyrës. Nga këndvështrimi të tilla, këto probleme duken se janë të pazgjidhshme.

Sërish, përshtypja e çdo personi për universin e jashtëm është e ndryshme nga ajo e të tjerëve. Megjithatë, shumica e vëzhguesve prej nesh perceptojnë njëlloj disa imazhe të botës elementare që na rrethon. Për shembull, pjesa dërrmuese e njerëzve pajtohen në lidhje me përkufizimin e një artikulli aq të thjeshtë sa një karrige ose një tryezë. Por ka shumë gjëra të tjera të zakonshme për të cilat njerëzit jo domosdoshmërisht bien dakord me njëri-tjetrin. Për shembull, ngjyrat e sendeve mund të

duken të ndryshme për njerëz me shikim të ndryshëm. Në të njëjtën mënyrë, aftësitë tona nuk janë njëlloj të barabarta të të gjithë. Ndjesia e nuhatjes, po kështu edhe aftësia për të ndierë të nxehtin ose të ftohtin gjithashtu ndryshojnë nga njeriu në njeri. Përveç kësaj, një vëzhgues i vetëm krijon perceptime të ndryshme kur vëzhgon të njëjtën gjë nga pika të ndryshme. Kësaj shtojni edhe gjendje të ndryshme shpirtërore dhe gjendje të ndryshme shëndetësore. Problemi sa vjen e shumëfishohet. Asnjë e vërtetë objektive nuk duket se pajtohet plotësisht me të vërtetën subjektive që njerëzit e kuptojnë brenda trurit të tyre. Shkurt, përshtypjet subjektive nuk mund të lidhen me botën e jashtme saktësisht në të njëjtën mënyrë gjithmonë. Për këtë arsye, sipas mendimit të disa filozofëve, shikuesi asnjëherë nuk mund të pohojë me siguri të plotë se çfarë është ajo që sheh.

Aspekti i pasigurisë dhe i mosbesueshmërisë së përshtypjeve që u përmendën më lart, lindi një sekt tjetër sufist, i cili mohoi plotësisht ekzistencën e jashtme të gjërave dhe pohoi se e vërteta e përvetshme është thjesht një nocion subjektiv. Në mesin e tyre, ata që ishin më ekstremë mohuan plotësisht ekzistencën e çdo forme të jashtme fizike, duke përfshirë edhe vetveten e tyre. Kështu, një lëvizje intelektuale që kishte filluar me një përpjekje për të

dalluar në mënyrë tepër të hollësishme detajet e perceptimit të realitetit të jashtëm, përfundoi në një çmenduri të plotë. Megjithatë, kishte një magji të çuditshme në këtë çmenduri, që nnganjëherë i linte gojëhapur edhe logjicienët dhe akademikët më të mirë të kohës.

Përmendet një ngjarje interesante e një sufiu të shquar të këtij sekti, i cili u thirr në oborrin e mbretit për të zhvilluar një debat me disa nga studiuesit e njohur të kohës së tij. Por për habinë dhe hidhërimin e të gjithëve, rezultati i debatit doli tërësisht kundër asaj që priste paria mbretërore. Brenda pak shkëmbimeve argumentesh dhe kundër argumentesh, akademikëve të mëdhenj u shteroi dija, iu mpi gjuha dhe mbetën të turpëruar. Askush nuk pati sukses përpara ndërlikimeve të logjikës eterike të sufiut në fjalë. Në këtë moment, mbretit i shkrepri një ide brilante. Ai urdhëroi rojën e kafazit të elefantëve që të nxirrte elefantin më të egër në oborrin e pallatit. Çmenduria e këtij elefanti nuk ishte më pak i ngjashëm me çmendurinë e sufiut. I vetmi ndryshim mbase ishte se në mendjen e sufiut realiteti i jashtëm nuk ekzistonte, kurse elefanti donte ta shkatërronte vetë gjithë realitetin e jashtëm. Nga njëra anë e hodhën sufiun në fushën e hapur dhe nga tjetër e lëshuan të lirë edhe elefantin. Sufiu, pa humbur kohë, filloi të vraponte për të

shpëtuar jetën e vet.

Duke parë këtë, mbreti thirri nga ballkoni i pallatit: “Mos ik, o Sufi, nga ky elefant fantazmë, se është vetëm një iluzion i mendjes sate!”

“Kush po ikën?”, bërtiti përsëri Sufiu, “është vetëm një iluzion i mendjes suaj!”

Kështu sufiu doli nga situata e tij e vështirë, por jo debati. Ai është i ndezur edhe sot.

Shkolla spanjolle e mendimit islam

Kemi diskutuar më sipër debatin në lidhje me epërsinë e së vërtetës që vjen nga shpallja, përkundrejt së vërtetës së vëzhguar. Disa mendimtarë i japin përparësi shpalljes [zbulesës] mbi logjikën, dhe disa të tjerë anasjelltas. Ibni Ryshdi (i njohur në Perëndim si Averoesi), një nga mendimtarët më të mëdhenj muslimanë të të gjitha kohërave, propozoi idenë se pikëpamjet e mësipërme shprehin realitete paralele dhe duhen trajtuar veç e veç. E vërteta e shpallur duhet të pranohet si e tillë dhe dija e fituar nga vëzhgimi dhe eksperimenti duhet të pranohen ashtu siç janë. Për Ibni Ryshdin, nuk ishte e nevojshme të kërkohej një korrelacion midis të dyjave, dhe as nuk kishte nevojë për të kërkuar kontradikta dhe për të gjetur zgjidhjet e tyre.

Kjo ishte epoka kur shkencëtarët muslimanë po përparonin shpejt në Spanjë në kërkimet e tyre të njohurive shkencore. Ata e bënë këtë pa u shqetësuar nga fakti që disa studiues fetarë të shkollave të vjetra po lëshonin verdikte të *ilhadi*t (risi) kundër tyre. Ibni Ryshdi mund të ketë menduar se ishte më mirë të mos përfshihej në polemika të tilla, që të mos pengohej përparimi i shkencës.

Ajo që ai shmangu me vetëdije ishte rreziku i shfaqjes së kontradiktave mes fesë dhe shkencës. Qëndrimi i një besimtari të vërtetë musliman, njëherësh edhe i një shkencëtarit të përkushtuar ndaj së vërtetës pa paragjykime siç ishte ai, i shërbeu kauzës së fesë dhe shkencës në Spanjë në mënyrë të admirueshme për një kohë të gjatë. Rreziku i kontradiktës midis së vërtetës së shpallur dhe të vërtetës së vëzhguar kurrë nuk u ballafaqua tërësisht. Prandaj çështja e preferencave nuk u ngrit kurrë seriozisht. Kjo 'politikë pa konflikte' qëndroi mbizotëruese në Spanjë për shumë shekuj, kryesisht falë maturisë së Ibni Ryshdit.

Kur rishikojmë problemet e mundshme të kësaj çështjeje në dritën e ngjarjeve që pasuan, mund të themi me siguri se bota ende nuk ishte e pjekur për të adresuar çështje të tilla. Nuk mund të largohej mundësia jo vetëm e perceptimit të

mangët ose të cunguar, por edhe e keqkuptimit të plotë të fakteve të vëzhguara.

Për shembull, në kohën mesjetare idetë që kishin shkencëtarët muslimanë rreth universit nuk ishin vërtet të bazuara në Kuranin e Shenjtë ose në Hadithin, por duket se ishin të ndikuara nga injoranca mbizotëruese e asaj epoke. Dijetarët e fesë, siç ndodh gjithmonë, i konsideruan pikëpamjet e tyre tërësisht islamike dhe si të tilla edhe përfundimtare, ndërkohë që për shkak të njohurive mbizotëruese mesjetare, ata e kishin të pamundur të kuptonin konceptet e vërteta Kuranore.

Për një çështje të tillë në Spanjë, nuk vërehet se ka pasur ndonjë dialog midis shkencëtarëve dhe studiuesve fetarë. Nuk kishte asnjë forum për transferimin e dijes midis këtyre dy grupeve, as nuk ngrihej ndonjë debat në lidhje me meritat krahasuese të bindjeve të tyre përkatëse. Rrjedhimisht, nuk kishte ndonjë galileo në Spanjë që duhej të zgjidhte alternativën midis jetës dhe të vërtetës. Shkencëtarët dhe studiuesit bashkëkohorë as nuk tentuan t'u shpjegonin dijetarëve fetarë detyrimin e tyre për të quajtur të vërtetën si të vërtetë kur panë diçka të tillë, dhe as nuk e panë të nevojshme të provonin para tyre se interpretimi i tyre i Kuranit Famëlartë ishte i gabuar sepse kundërshtonte faktet e njohura shkencore të kohës.

Si rezultat, atje u zhvilluan dy lëvizje paralele, mes të cilave gradualisht hendeu u thellua më tej. Më në fund ndodhi që dituria islame mori një rrjedhë krejtësisht të ndryshme nga ajo e kanaleve të mendimit filozofik dhe shkencor, për të mos kaluar kurrë në rrugën e tyre. Ato ishin si dy përrenj që ecnin paralelisht, pa pasur lidhje me njëri-tjetrin.

Për këtë arsye, Kombi musliman i Andaluzisë (titulli i Perandorisë Muslimane në Spanjë), parakaloi vendet e tjera islamike në shumicën e fushave të kërkimit shkencor. Një tjetër avantazh përveç kësaj ishte që Spanja gëzoi një periudhë relativisht të gjatë paqeje, të sigurt nga sulmet e pushtuesve si Xhingis Hani dhe Hulagu Hani. Kjo periudhë e historisë islame në Andaluzi mund të konsiderohet me të drejtë si epoka e artë e racionalizmit. Me dëbimin e muslimanëve nga Andaluzia, edhe epoka madhështore e dominimit musliman mori fund. Të gjitha lidhjet e Islamit me popullin spanjoll u ndërpre. Nëse ndonjëherë ka ndodhur një prapavajtje tragjike e përparimit intelektual dhe shkencor kudo në botë, ajo ka ndodhur në tokën e Andaluzisë. Ç'kthim tragjik që qe! Sapo u hapën portat në skajin jugor të Andaluzisë për eksodin e Islamit, bashkë me të dhanë lamtumirë urtësia, dija, loja e ndershme, e vërteta dhe drita në të gjitha spektrat

e saj, për të mos u kthyer për shekuj. Drita nuk vërshoi më as në drejtim të muslimanëve të mërguar. Spanja u zhyt përsëri në errësirën e plotë të epokës paraislame. Bota islame në atë kohë nuk gjallërohej askund tjetër. Atje, errësira gufonte nga brenda. Ishte errësira e paragjykimeve fetare, e fanatizmit, e mendjengushtësisë, e arrogancës, e egoizmit dhe e xhelozive të ndërsjella, që filloi të përhapej si zjarri i ferrit. Ajo filloi të ngrihej si një kolonë tymi që përhapej anekënd duke pushtuar gjithë dritën e qiellit. Kështu toka poshtë u mbulua nga hijet e errësirës që u rritën dhe u trashën me kalimin e viteve.

Për sa u përket banorëve të Evropës veriore, historia qe krejt tjetër. Ajo që humbi nga populli i Spanjës, doli të ishte fitimi i tyre. Dhe çfarë fitimi që qe ai! E njëjta Mbretëreshë Isabella dhe Mbreti Ferdinand që i dëbuan muslimanët nga vendi, nuk vonuan shumë për ta kthyer zemërimin e tyre ndaj hebrenjve, nën ndikimin gjithnjë e në rritje të një priftërie kristiane fanatike dhe despotike. Ndërsa portat jugore të Andaluzisë u hapën për dëbimin e muslimanëve, u hapën edhe portat veriore për një eksod në shkallë të gjerë të hebrenjve. Midis tyre kishte njerëz me njohuri të gjerë, studiues të mëdhenj, shkencëtarë dhe intelektualë, të cilët shkëlqyen në shumë profesione. Ata kishin zotëruar aftësi të shumta gjatë shtatë shekujve

të sundimit bujar të muslimanëve. Ata kishin arritur përsosmëri në të gjitha profesionet si industria, tregtia, kërkimi shkencor, arkitektura, skulptura, kirurgjia dhe shumë fusha të tjera të tilla. Një skemë ngulmuese e mirëorganizuar e përndjekjes i dëboi hebrenjtë jashtë vendit, duke i përjashtuar nga të gjitha pronat e tyre. Ishin ata që mbajtën pishtarët e dijes gjatë gjithë rrugës nga Andaluzia muslimane deri në jug të Francës dhe më gjerë. Filozofitë e Aristotelit dhe të Platonit filluan të përhapeshin në Evropë përmes filozofëve muslimanë të Spanjës. Gjeniu shërues i Ibni Sinaut (Avicenna), mjeku më i madh i njohur ndonjëherë në botë deri në kohën e tij, si dhe mençuria e Ibni Ryshdit (Averroes) që qe një ndërthurje e filozofive dhe shkencave si laike ashtu edhe fetare, zunë të zbardhen në horizontin evropian. Falë kryesisht eksodit të hebrenjve, veprat e tyre madhështore u transferuan anekënd dhe u përkthyen në gjuhë të ndryshme evropiane nga studiuesit. Në fakt, ishin ata që hodhën themelet e një epoke të re të iluminizmit në Evropë, e njohur si Rilindja.

Gjendja e mjerueshme e botës muslimane

Kur e kthejmë vështrimin drejt epokës post-spanjolle, shohim të njëjtën pamje të zymtë dhe tragjike që ulej këmbkryq në të gjithë botën islame. Qysh atëherë

e tutje, edhe vendet e tjera muslimane humbën interesin për shkencat laike si dhe zellin për kërkime dhe hulumtime, gjë që ata vetë e kishin promovuar dikur duke e çuar në nivele kaq të larta të përsosmërisë.

Kjo prirje fatkeqe do të rezultonte joproduktive jo vetëm në fushën e shkencës, por edhe në vetë fushën e fesë. Umeti musliman (muslimanët si popull) u nda më tej dhe u përça në fraksione të shumta. Doktrina fisnike e unitetit të Zotit u bë viktimë e kësaj prirjeje vetëvrasëse. Çarjet filluan të shfaqeshin në imazhin e vetë Zotit. Filluan ta interpretonin Zotin kaq ndryshe, sikur të flisnin për zota të ndryshëm sesa për Zotin e Vetëm. Me një fjalë, zelli i tyre për dijen nuk u shua, vetëm se atyre iu ndryshuan preferencat.

Ata vijuan të debatonin për çështjet e së drejtës dhe të gabuarës me të njëjtën forcë si më parë, por tema e diskutimit kishte ndryshuar. Ata ngecën në disa pyetje që do t'i trazonin për shekuj me radhë. Në vend të çështjeve serioze të praktikave themelore, jurisprudenca e tyre mbeti e angazhuar në vogëlsira të tilla si: a lejohet ngrënia e mishit të sorrës apo jo. Raportohen trazira që shpërthyen për këtë çështje midis mbështetësve që kishin pikëpamje të kundërta. Polemikët që vijuan, u bënë gjithnjë e më të komplikuar dhe gjithëpërfshirëse në masë. Lavdi intelektit të tyre që ata me

të vërtetë mund të ndërtonin male nga kokrat e sinapit – lavdi kjo që reflektonte mungesë të plotë të arsyes së shëndoshë. Intelktualizëm i pakuptimtë duhet të ishte emri i duhur për atë që ata bënë!

Le të shohim disa nga pyetjet e tjera të ashtuquajtura “shumë të rëndësishme”, për shkak të të cilave, atyre iu trazua mendja pa pushim dhe u flakëroi edhe gjaku deri në maksimum. Ndër të tjerave, u ngrit një pyetje banale se ç’duhej bërë në rast se një qen do të binte në një pus. Sa kovë uji do t’u duhej të hiqnin, që uji i pusit të quhej i pastër, i denjë për të marrë abdes. Që një çështje shumë e rëndësishme që tërhoqi vëmendjen e dijetarëve të mëdhenj të asaj kohe. Pyetja nuk ngrihej vetëm për një qen. Nëse një *mullah* i akuzuar për herezi nga klerikët e një shkolle tjetër, të binte në pus, pyetja do të merrte përmasa akoma më të rënda. Sa kova uji do t’u duhej të hiqnin, kjo zgjidhej me një ushtrim kompleks matematikor. Shumë mund të kishin preferuar që ai pus të mbushej me dhe, për ta kthyer atë në gropën e varrit të të njëjtit *mullah*. E tillë ishte koha dhe të tilla ishin tregimet, të ndërtuara mbi realitetet e intolerancës së tyre të çmendur.

Sado të çuditshme mund t’ju duken, nuk mund t’i quajmë krejt të pavërteta. Kjo gjendje tregon se çfarë marrëzie kishte pësuar jurisprudenca e asaj periudhe! Ata u përfshinë në debate të tilla të

pakuptimta, saqë edhe praktikën më të shenjtë fetare muslimane që është “salat” (namazi), e kthyen në diçka që do t’ju dukej qesharake.

Gjatë kryerjes së namazit, në *rekatin* e dytë kur qëndrojnë ulur, muslimanët gjithmonë pohojnë *shehadetin*, që është shtylla themelore e besimit. Gjatë pohimit të kësaj deklarate, disa ngrënë gishtin tregues, kurse disa jo. Por juristët e asaj periudhe ishin rreptësisht të ndarë për këtë çështje. Ata ishin të vendosur të ndëshkonin gishtin që cenonte ndjeshmërinë e tyre. Ai që bënte shkelje, si në rastin e ngritjes së tij, ashtu edhe në rastin e mosngritjes, vendimi i tyre unanim ishte që atij t’i pritej gishti. Ata mund të kishin mospajtim mbi gjithçka tjetër, por jo për këtë. Të shkoje në xhami të gabuar ishte me të vërtetë një rrezik i madh. Nuk qe problem hyrja në xhami, por ishte dalja ajo që paraqiste rrezikshmëri të lartë. Shkelësit e rregullit që mbahej në atë xhami, mund të dilnin me një gisht më pak nga pesë gishtat që u kishte dhuruar Allahu!

Një çështje tjetër e vogël kishte të bënte me thënien “Amin!”, e cila thuhet pas leximit të sures El-Fatihah nga imami. Pika “jetësore” në diskutim ishte nëse duhej thënë me zë të lartë apo në heshtje. Ndodhte që ata që e thoshin me zë të lartë, të rriheshin nëse kishin hyrë në një xhami ku kjo konsiderohej një krim i rëndë. Po kështu, edhe ai që thoshte

“Amin” në heshtje mes atyre që e thoshin me zë të lartë, nuk konsiderohej më pak provokues.

Një prej dallimeve më të spikatura midis këtyre doktrinave, të cilat morën përmasa vdekjeprurëse, kishte të bënte me pyetjen nëse Kurani i Shenjtë është krijim apo nuk është krijim. Për mbështetësit e secilës pikëpamje, kjo mosmarrëveshje pa asnjë dyshim ishte kaq jetësore, saqë duhej të dënoheshin me vdekje ata që kishin pikëpamjen e kundërt. Por e gjithë kjo varej nga shansi, që për ta ishte shpërndarësi i madh i drejtësisë. Kur mbreti ishte në anën e atyre që besonin se Kurani nuk është krijim, ndjekësit e doktrinë së kundërt jo vetëm që u vranë, por edhe u dogjën për së gjalli në shtëpitë e tyre. Kur shansi kaloi në anën tjetër, persekutuesit u bënë të persekutuar. Shumë herë ndodhi deri në atë pikë se nuk shpëtuan dot nga dënimi as ata që kishin kohë që kishin vdekur dhe qenë varrosur. U nxorën nga varret e tyre dhe u varën publikisht, që të gjallët të merrnin mësim prej tyre. Por çfarë mësimi mund të nxirrte dikush nga kjo pamje?! Pyetja, cila anë e lëkundëses ishte më e sigurt, mbeti pa përgjigje. Por për të gjithë ata që ziheshin me kaq seriozitet në këto çështje të parëndësishme, jeta në tokë u shndërrua në xhehenem. Pra, xhehenemi që vjen pas vdekjes dhe që kundërshtarët e tyre u thoshin se ishte i sigurt për ta, atyre

nuk iu desh ta prisnin deri në vdekje.

Shekujt e errësirës së epokave mesjetare filluan të lëshonin gjithkund hijet e tyre vdekjeprurëse. Bota e Islamit që ishte shfaqur nga errësira në dritë në kohën kur dielli i Islamit u ngrit nga shkretëtirat e Arabisë, u zhyt përsëri në humnerën e injorancës. Me ndryshimin e pikëpamjes dhe të këndit të vizionit, vizioni i Islamit filloi të dridhej dhe të ndryshonte ngjyrat, sikur yjet e largëta kur shikohen në netë të errëta dhe të zymta. Imazhi i Islamit humbi shkëlqimin dhe qëndrueshmërinë e vet.

Dy kanalet kryesore të ndriçimit që mund ta shndërronin errësirën e injorancës në dije, dukej se ishin shuar përgjithmonë. Nuk mbeti as kthjelltësi ose integritet i vizionit, dhe as nuk u mbajt ndonjë shpresë nga ata për ndonjë zbulesë nga lart. Për ta, të dyja dritaret ishin të mbyllura. Sa fund tragjik që ishte ky!

Megjithatë, disa shekuj më vonë, dielli i dijes laike filloi të lindë sërish, por këtë herë nga Perëndimi. Transmetuesit e dritës nga Lindja shihnin drejt Perëndimit me shpresën për të parë ndonjë pamje të asaj që ata vetë i kishin dhuruar Perëndimit disa shekuj më parë.

NJË THIRRJE
E FUQISHME DHE HISTORIKE
NË OKB, PËR TË DREJTAT E PALESTINEZËVE

Sir Muhammad Zafrulla Khan



Konflikti shkatërrues midis Palestinës dhe Izraelit ka ekzistuar për dekada të tëra. Sulmi i forcave izraelite ndaj besimtarëve muslimanë në tokën e pushtuar të Jerusalemit Lindor pranë xhamisë së shenjtë el-Aksa është vetëm një shembull tjetër i një liste të gjatë mizorish të kryera në rajon.

Bota muslimane e cila është përfshirë vetë në konfliktet e saj të brendshme fetare apo politike, bën sehir për situatën e krijuar. Nga pamundësia për të ndaluar dorën e agresorit, politika e vendeve muslimane mjaftohet duke nxjerrë “deklarata të forta” për shtyp, ndërsa populli shpreh indinjatën e saj për brutalitetin ndaj popullit palestinez duke organizuar protesta në qytetet kryesore botërore dhe në këtë mënyrë solidarizohet me viktimat. Pastaj, jeta kthehet sërish në orbitën e vet si “Business as usual”.




*Sir Mubamed Zafrulla Khan
Burim: UN Photos*

Sir Muhammad Zafrulla Khani r.a. (1893-1985) ishte një ndër figurat themeluese të Pakistanit. Ai ishte një politikan, diplomat dhe jurist me famë botërore, dhe njihet veçanërisht si Ministri i parë i Punëve të Jashtme i Pakistanit (1947-1954). Ai ishte Presidenti i parë musliman dhe pakistanez i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së si dhe i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë nga 1954 në 1961. Ai ishte gjithashtu një studiues i shquar dhe një shkrimtar i dalluar i Xhematit Musliman Ahmedia i cili kishte nderin të ishte prej dishepujve (sahabëve) të Hazret Mirza Ghulam Ahmedit (a.s.), Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi. Ai shkroi disa libra dhe përktheu Kuranin Famëlartë në gjuhën angleze.

Ky fjalim, i cili u mbajt në Asamblenë e OKB-së, është botuar për herë të parë në dhjetor 2002 në revistën “*Review of Religions*” dhe po ribotohet në dobi të lexuesve.

Xhemati Musliman Ahmedia gjithmonë ka mbështetur të vërtetën dhe ka dënuar ashpër padrejtësitë kudo dhe kurdo që janë kryer. Në nëntor 1947, kur krijimi i Izraelit po diskutohej në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara, Sir Çaudri Zafrulla Khan-i i Pakistanit mbajti një fjalim historik, duke u tërhequr vëmendje të drejtave të palestinezëve, të cilat po shkeleshin nëpërkëmbëshin.



Sbkëlqesia e Tij, Muhammad Zafrulla Khan (djathtas), Presidenti i Sesionit të 17-të të Asamblesë së Përgjithshme po u drejtohej korrespondentëve në Selinë e OKB-së. Burim: UN Photos

TAKIMI PLENAR i 126-të

U mbajt në Sallën e Asamblesë së Përgjithshme në Flushing Meadow, New York, të premten e 28 nëntorit 1947, në orën 11 të mëngjesit

Kryetar: Z. O. Aranha (Brazil).

Vazhdimi i diskutimit për Çështjen Palestineze

Kryetari: Përfaqësuesve duhet t'u ofrohen kushtet më të mira të mundshme, në mënyrë që të trajtojnë me vëmendjen më të lartë çështjen

serioze që gjendet përpara Asamblesë së Përgjithshme. Prandaj, Kryetar më duhet t'i kujtoj audiencës që të përmbahet nga duartrokitjet ose çfarëdolloj ndërhyrjeje në debatin e Asamblesë së Përgjithshme.

Ka dhjetë folës në listën e Kryetarit. Fjalën e ka Përfaqësuesi i Pakistanit.

Fjalimi historik i Sir Muhammad Zafrullah Khanit në OKB për Çështjen e Palestinës

Sir Muhammad Zafrulla Khan (Pakistan):

Shpëreh kënaqësinë duke vënë re që, ju Z. Kryetar, jeni i shqetësuar për të siguruar, të paktën për sa i përket kësaj çështjeje, një diskutim të qetë, pa ndërhyrje dhe pa ndikime. A do të jetë votimi po aq i lirë dhe i pandikuar, nuk është më çështje kënaqësie. Megjithatë, unë nuk do të merrem me këtë.

Ata që nuk kanë mundësi për ta ditur atë çka po ndodh në prapaskenë, kanë mësuar mjaftëushëm nga shtypi, dhe kjo u ka kallur frikë në zemër. Kjo frikë nuk buron nga një pyetje e vetme, pasi kjo është vetëm një nga temat, por nga fakti se çështjet vendimtare që gjenden përpara këtij organi të nderuar dhe në të cilat janë përqendruar shpresat e botës për të ardhmen, nuk do të lihen pa shqyrtim e diskutim.

Ky është një moment i rëndësishëm dhe kritik në historinë e botës, në historinë e kësaj Organizate të madhe, apo me shpresën të jetë e madhe. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) sot është e paditur në gjyq. Bota po shikon dhe do të shohë se si kjo Organizatë e shfaqëson veten – sërish, ndoshta jo aq për miratimin apo jo të ndarjes

së Palestinës sesa për hapësirën e ushtrimit të drejtësisë dhe për vendimet e ndërgjegjshme mbi çështjet e rëndësishme.

Ne shpesh jemi të prirë për të lexuar historinë së prapthi, dhe unë e pranoj që kjo është një metodë shumë e gabuar



Vendi i gazetarëve në OKB, në seksionin për shtyp të sallës së kongreseve në takimin e fundit të Komitetit Ad Hoc për çështjen palestineze gjatë seancës së dytë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, duke miratuar rezolutën për ndarjen e Palestinës në dy Shtete. Burim: UN Photos



*Një foto e zyrës së Shtypit të Bashkuar në Sallën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Flushing Meadows, pasi Asambleja votoi për të miratuar ndarjen e Palestinës.
Burim: UN Photos*

e leximit të historisë. Historia, që të vlerësohet siç duhet, duhet lexuar për së mbari. Për të dhënë ndonjë mendim a vlerësim për ndonjë dukuri apo ngjarje dhe për ta gjykuar atë, njeriu duhet të vendosë veten në ato rrethana.

Me lejen tuaj, Z. Kryetar, më lejoni të ftoj përfaqësuesit të lexojnë historinë në këtë mënyrë për disa çaste, të paktën atë pjesë të historisë që ka të bëjë me Asamblenë e Përgjithshme.

Tridhjetë e dy vjet më parë – për të mos shkuar shumë larg – Aleatët Perëndimorë ishin në mes të një lufte të përgjakshme me Fuqitë e Evropës Qendrore. Turqia sapo kishte hyrë në luftë në anën e Gjermanisë. Fati i kauzës së Aleatëve po lëkundej fort. Arabët, të cilët vetëm mund të ndihmonin për rivendosjen e ekuilibrit

në rajonin jetësor të Lindjes së Mesme, ishin ftuar për të shpallur kryengritjen ndaj Turqisë dhe për të hedhur peshën e tyre në anën e Aleatëve. Por në këmbim të çfarë çmimi? Në këmbim të një premtimi nga Mbretëria e Bashkuar, të konfirmuar më pas edhe nga Franca, se në fund të luftës, Arabët do të gëzonin liri vetë në tokat e tyre. Ata ranë dakord dhe dhanë kontributin e tyre.

A janë përmbushur këto premtime? Shpesh na kanë kujtuar se këto zotime janë përmbushur në masën e nëntë të dhjetave, dhe se një përmbushje e tillë duhet të jetë e mjaftueshme. A është ky standard që dëshirojmë të shohim të vendosur dhe të cilit duhet t'i përmbahemi në çështjet ndërkombëtare, kombëtare e madje edhe personale? Ne i



*Seanca e rregullt e 17-të e Asamblesë së Përgjithshme u hap në Selinë e OKB-së dhe zgjodhi si President të saj Ambasadorin Muhamed Zafrulla Khan, nga Pakistani. Në tribunën presidenciale z. Khan (djathtas) duke dëgjuar një nga folësit. Ulur pranë tij është Ushtuesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së U. Thant.
Burim: UN Photos*

kemi përmbushur këto zotime në masën e nëntë të dhjetave dhe, prandaj, duhet të jetë e mjaftueshme. Nëse është kështu, ndaloni për një çast dhe paramendoni: A do të ketë më besim në premtime të tilla, e sidomos në premtimet e Fuqive Perëndimore?!

Mos harroni, ju shtete Perëndimore! Nesër do të keni nevojë për miq, do të keni nevojë për aleatë në Lindjen e Mesme. Ju lutem, mos e prishni dhe mos e shkëlpi besueshmërinë tuaj në ato vende.

Është thënë se ka disa dyshime nëse Palestina ishte përfshirë në premtimet që u ishin dhënë arabëve. Gjatë këtyre bisedimeve të gjata në komitet si dhe në nën-komision, pastaj prapë në komitet dhe më pas në Asamblenë e Përgjithshme, askush nuk ka kërkuar të argumentojë nëse Palestina nuk ishte e përfshirë në ato premtime ose ishte përjashtuar nga ato premtime. Sidoqoftë, u sugjerua që nëse kishte ndonjë dyshim në lidhje me këtë çështje, ajo duhet t'i referohej Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, opinionin e kështilluesit të cilit duhet të kërkohet në mënyrë që çështja të zgjidhet një herë e përgjithmonë, në një mënyrë ose në një tjetër, meqenëse deri më tani asnjë gjykatë e pavarur dhe e paanshme nuk ishte ftuar të shprehte një mendim mbi këtë pyetje. Kjo kështillë nuk u pranua.

Cili është përfundimi? Ata që kanë

ndonjë dyshim në lidhje me këtë çështje janë të bindur se cila do të jetë përgjigja e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Është deklaruar, në mënyrë të veçantë nga përfaqësuesi i Çekosllovakisë, se këto ishin vetëm premtime, që nuk mund të trajtohen si marrëveshje ndërkombëtare, që do të thotë se një premtim nuk ka nevojë të përmbushet ndërsa një marrëveshje ndërkombëtare është e detyrueshme. Sidoqoftë, përpara se të arrihet një marrëveshje ndërkombëtare, veçanërisht në mes të një situatë


Foreign Office,
November 2nd, 1917.

Dear Lord Rothschild,

I have much pleasure in conveying to you, on behalf of His Majesty's Government, the following declaration of sympathy with Jewish Zionist aspirations which has been submitted to, and approved by, the Cabinet

His Majesty's Government view with favour the establishment in Palestine of a national home for the Jewish people, and will use their best endeavours to facilitate the achievement of this object, it being clearly understood that nothing shall be done which may prejudice the civil and religious rights of existing non-Jewish communities in Palestine, or the rights and political status enjoyed by Jews in any other country"

I should be grateful if you would bring this declaration to the knowledge of the Zionist Federation.



Deklarata e Balfour-it ishte një deklaratë publike e bërë nga Qeveria Britanike e cila ishte në favor të vendosjes së Palestinës si një 'shtet kombëtar për popullin hebre' © Wikimedia Commons

emergjente si një luftë botërore, ne duhet të vendosim besueshmëri në premtimet tona. Nëse premtimet tona nuk janë të besueshme, kurrë nuk do të jemi në gjendje t'ua kërkojmë edhe të tjerëve përmbushjen e premtimeve.

Ishte thënë atëherë: “por deklarata e Balfour-it është gjithashtu një premtim”. E vërtetë, ajo është gjithashtu një premtim, por ekziston kjo pikë: ose ky premtim mund të mbetet në fuqi në përputhje me premtimet e mëparshme ose nuk është në përputhje me premtimet e mëparshme. Nëse kjo deklarata nuk është në përputhje me zotimet e mëparshme, meqenëse zotimet e mëparshme kanë zënë fushën, prandaj rrjedhimisht nuk ka më fushë për t'u zënë nga një premtim i pa mbajtur; ose ajo është në përputhje me premtimet e mëparshme. Me fjalë të tjera, deklarata e Balfour-it nënkuptonte krijimin e një strehe kombëtare hebreje në një Palestinë të lirë dhe të pavarur. Të dyja këto zotime mund të qëndrojnë së bashku, prandaj le të qëndrojnë së bashku dhe le të plotësohen të dyja.

Sa i përket Mandatit të Palestinës, një premtim është përmbushur: është krijuar një shtet për hebrenjtë. Tani duhet të vendoset pavarësia e Palestinës si një e tërë. Përsëri, është argumentuar: “jo, deklarata e Balfour-it nënkuptonte diçka më shumë se kaq”. Shumë mirë! Nëse ekziston çështja e



*Salla qëndrore e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara
Nga Basil D Soufi, CC BY-SA 3.0, përmes
Wikimedia Commons*

ligjshmërisë së jurisprudencës të kësaj deklarate, dërgojeni atë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Edhe Nën-Komiteti 2 e bëri këtë propozim, por u refuzua.

Shumë vëmendje i është kushtuar edhe aspektit humanitar të kësaj çështjeje, aspekt i cili nuk mund të mohohet. Por, nga pikëpamja humanitare, nuk bëhet fjalë vetëm për refugjatët hebrej dhe njerëz të shpërngulur. Çdo njeri që është persekutuar a diskriminuar ose që është shfrytëzuar padrejtësisht, ka të drejtën e dëmshpërblimit të duhur. Kjo nuk mohohet.

Çfarë ka bërë Palestina? Cili është kontributi i saj për zgjidhjen e çështjes humanitare pasi kjo ndikon te refugjatët hebrej dhe personat e shpërngulur? Që nga fundi i Luftës së Parë Botërore, Palestina ka pritur mbi katërqind mijë emigrantë hebrej. Që nga

fillimi i persekutimit të hebrenjve në Gjermaninë naziste, Palestina ka pritur gati treqind mijë refugjatë hebrenj. Pa llogaritur imigrantë të paligjshëm të cilët nuk mund të numërohen.

Vihet re se ata që ligjërojnë për parime humanitare dhe kanë mundësi të bëjnë më shumë, kanë bërë minimumin për ta lehtësuar këtë problem. Megjithatë, ata janë gati – madje janë të zellshëm – për të qenë më bujarë në kurriz të arabëve.

Ka pasur vetëm pak periudha në histori kur hebrenjtë nuk janë persekutuar në pjesë të ndryshme të Europës. Në një kohë, kur mbretërit dhe baronët anglezë dëfreheshin e argëtoheshin duke shkukur dhëmbët e tregtarëve dhe bankierëve hebrenj si një masë e butë për t'i bindur ata të bashkëpunonin në forcimin e ekonomisë së tyre feudale – një lloj huadhënie njëkahëshe mesjetare – Spanja Arabe u siguroi hebrenjve mbrojtje dhe strehë të sigurt që qe një parajsë për ta.

Sot thuhet: vetëm hebreu i shkretë dhe i përndjekur i Europës është i pastrehë. Është e vërtetë. Por, më tej thuhet: le t'ia sigurojë Palestina Arabe, njësoj siç kishte bërë Spanja Arabe, jo vetëm strehë dhe vendbanim, por edhe një shtet në mënyrë që ai t'i sundojë arabët. Eh çfarë bujarie e çfarë humanizmi qenka ky!

Komiteti i Posaçëm i OKB-së për



Pamje e përgjithshme e takimit të 26-të të Komisionit Ad-Hoc me 57 anëtarë për Çështjen Palestineze në sesionin e dytë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në Lake Success, New York.

Burim: UN Photos

Palestinën, siç e dimë, në rekomandimin numër 7, i cili ishte një nga rekomandimet unanime, kërkoi që Asambleja e Përgjithshme përveç problemit të Palestinës t'i përgjigjet menjëherë çështjes së refugjatëve dhe të njerëzve të shprëngulur, në mënyrë që të zvogëlojë vuajtjen e popullit të persekutuar hebre dhe ta lehtësojë këtë problem humanitar si dhe çështjen palestineze.

Por, çfarë ka arritur ky trup i shkëlqyeshëm dhe i nderuar në këtë aspekt? Nën-Komiteti 2 bëri një rekomandim dhe, bazuar në të, përpiloi një projekt-rezolutë (rezoluta II, dokumenti A / AC. 14 / 32). Së pari, le të riatdhesohen ata refugjatë hebrenj dhe personat e shprëngulur që mund të rikthehen në vendet e tyre. Së dyti, ata


që nuk mund të riatdhesohen duhet t'u shpërndahen Shteteve Anëtare në përputhje me kapacitetin e tyre për të pritur refugjatë të tillë. Së treti, duhet të ngrihet një komision për të përcaktuar kuotat për këtë qëllim.

Rezoluta është nën shqyrtim nëse do të riatdhesohen hebrenjtë në vendet e tyre. Australia thotë jo; Kanadaja thotë jo; Shtetet e Bashkuara thonë jo. Nga një këndvështrim, ky qëndrim ishte mjaft inkurajues. Edhe nëse do të jenë të gatshëm për t'u kthyer në vendet e tyre, pas gjithë përvojave të tyre të hidhura e të tmerrshme, le t'u mos kërkohet të kthehen në vendet e tyre. Në këtë mënyrë, shpresonim se do të miratohej propozimi i dytë dhe ne të gjithë t'u jepnim strehë këtyre njerëzve. A do të shpërndahen këta refugjatë midis Shteteve Anëtare në përputhje me kapacitetin e tyre për t'i strehuar ata? Australia, një vend i vogël i mbipopulluar me zona të mbingarkuara, thotë jo, jo, jo. Kanadaja është gjithashtu po aq e mbingarkuar dhe e mbipopulluar, thotë jo. Shtetet e Bashkuara, një vend i madh humanitar, por me një sipërfaqe të vogël dhe me burime të kufizuara, thotë gjithashtu jo. Ky është kontributi i tyre ndaj parimit humanitar. Por ata gjithashtu deklarojnë: le të shkojnë këta njerëz në Palestinë, që ka sipërfaqe shumë të mëdha, një ekonomi të madhe dhe që nuk ka asnjë telash. Ata mund të

pranohen lehtësisht atje.

Ky është kontributi i dhënë nga ky komision i nderuar për zgjidhjen e kësaj çështjeje në bazë të parimit humanitar.

Cili është pozicioni sot, përveç këtyre konsideratave të tjera? Sapo të mbyllet mandati, kjo është situata që do të paraqitet. Unë ju tërheq vëmendjen në paragrafin 4 të Nenit 22 të Konventës së



Duke biseduar (nga e majta në të djathtë): Z. Nathan Barnes (Liberi); dr. Tesfaye Gebre-Egzy (Etiopi); Z. Leo Malania i Zyrës Ekzekutive të Sekretarit të Përgjithshëm; dhe Z. Muhammad Zafrulla Khan (Pakistan), President i Asamblesë së Përgjithshme. Burim: UN Photos

Lidhjes së Kombeve, sipas së cilës është dhënë mandati. Citoj:

“Disa komunitete të cilat në të kaluarën bënë pjesë në Perandorinë Turke kanë arritur një fazë zhvillimi, ku ekzistenca e tyre si shtete të pavarura mund të njihet provizorisht, duke iu nënshtruar zbatimit të këshillave dhe ndihmës administrative sipas një mandati, i cili mbetet në fuqi, derisa ato të arrijnë fazën e mëvetësisë”.

Ky është paragrafi që i referohet Palestinës.

Fuqia e mandatuar shprehet se ajo vetë do të përcaktojë kohën e Mandatit. Komiteti Special i OKB-së për Palestinën thotë se Mandati duhet të përcaktohet. Të gjithë pajtohen se në një mënyrë ose tjetrën Palestina duhet të jetë e pavarur.

Faza e dhënies së këshillës dhe të ndihmës administrative ka përfunduar dhe sipas statusit ligjor, Palestina, pavarësia provizore e së cilës është njohur juridikisht, do të jetë e pavarur nga ajo datë. Ky është problemi me të cilin duhet të merret OKB-ja.

Si do të arrijë Palestina pavarësinë e saj? Çfarë lloj pavarësie do jetë kjo? Cila është zgjidhja, për të cilën jemi ftuar ta mbështesim dhe të përipiqemi ta zbatojmë? Në fakt, propozimi përpara Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

thotë që ne, e jo populli i Palestinës, do të vendosim se çfarë lloj pavarësie do të ketë Palestina, pa asnjë dispozitë për vetëvendosje dhe pa asnjë dispozitë për pëlqimin e atyre që do të qeverisen. Ne do ta quajmë Palestinën të pavarur dhe sovranë, por Palestina do të na përkasë neve dhe nuk duhet të jetë molla për sytë e shumtë që e shohin me lakmi nga kahje të ndryshme, me drejtime të ndryshme, e aq më tepër të bëhet molla e sherrit midis Lindjes dhe Perëndimit, me qëllim që “bashkimi”, të cilin e përfaqëson emri ynë me aq lakmi, të ketë një mundësi për t’u rrënjësuar.

Ne së pari do ta copëtojmë trupin e Palestinës në tri pjesë për një Shtet Hebre dhe tri pjesë për një Shtet Arab. Atëherë do të kemi enklavën Xhafa (Jaffa); dhe zemrën e Palestinës, Jeruzalemin, i cili do të mbetet përgjithmonë një qytet ndërkombëtar. Ky është fillimi i asaj forme që do të ketë Palestina.

Pasi ta kemi copëtuar Palestinën në këtë mënyrë, do ta vendosim trupin e saj të përgjakur mbi një kryq. Kjo nuk do të jetë e përkohshme; por do të jetë përgjithmonë. Palestina kurrë nuk do t’i përkasë popullit të saj; por do të mbërthehet në kryq për gjithmonë.

Çfarë të drejte ka Organizata e Kombeve të Bashkuara për ta bërë këtë? Cilin autoritet ligjor dhe cilën të drejtë juridike ka ajo për ta bërë këtë,

për t'ia nënshtuar një shtet të pavarur përgjithmonë administratës së OKB-së.

Përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara është shprehur që problemi është i paprecedent, që do të thotë se nuk ishte hasur më parë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar në statusin tonë. Megjithatë, ai mendon se nëse 38 shtete pranojnë planin e ndarjes, kjo do të mjaftojë si ligj. Cila është rëndësia e kësaj vërejtjeje të bërë nga përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara në Komitet dhe më pas në shtyp? A nuk është ky një pohim që këtij plani i mungon autoriteti ligjor, juridik dhe kushtetues dhe se ju jeni thirrur jo vetëm ta pranoni këtë skemë si të tillë, por me votën tuaj gjithashtu t'i jepni asaj autoritetin juridik që i mungon? Me fjalë të tjera, ju në fakt jeni ftuar të ndryshoni statusin me votën tuaj dhe të shkruani në të kapitullin më të ri dhe më të diskutueshëm. A do ta merrni përsipër këtë përgjegjësi? Në cilën pjesë së statusit, është parashikuar ky autoritet për të bërë atë që jeni ftuar të bëni? A ka Asambleja e Përgjithshme autoritet për ta bërë këtë? A ka Këshilli i Sigurimit autoritetin për ta bërë këtë? Apo të dyja këto institucione të bashkuara për të vepruar e kanë autoritetin për ta bërë këtë?

Për çfarë jeni ftuar? Ju jeni ftuar së pari për të krijuar një komision që të ushtrojë autoritetin sovran mbi dy shtete të

pavarura. Ju jeni ftuar të krijoni këto shtete dhe të ushtroni autoritet mbi to gjatë periudhës tranzitore – duke drejtuar të gjitha funksionet e qeverisë: legjislativ, ekzekutiv dhe administrativ. Kujt i përket sovraniteti i përhershëm i këtyre dy shteteve? A u përket qytetarëve të këtyre dy shteteve? Në asnjë mënyrë. Sovraniteti i përhershëm do të jetë në duart e një bordi të përbashkët ekonomik. A duhet të jetë ai bord një lidhje midis dy shteteve në kuptimin që nuk do të merret parasysh interesi i askujt tjetër? Përgjigja është përsëri, jo. Ky bord do të jetë një këshill që do të përbëhet nga nëntë anëtarë, që do të drejtojnë administrimin e Palestinës: 3 anëtarë nga Shteti Arab, 3 nga Shteti Hebre dhe 3 nga OKB-ja. Në çfarëdo situate, ata do të drejtojnë doganat, financën, hekurudhat, fluturimet ndërkombëtare, zhvillimin e burimeve ujore dhe energjisë ujore, zhvillimin e bujqësisë etj. Dihet që pa arritur këto, asnjë shtet nuk do të jetë funksional; domethënë, asnjë shtet nuk do të jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e tij administrative e shoqërore ose të sigurojë integritetin tokësor. Madje një shtet i tillë nuk do të bëjë asnjë lloj përparimi. Kush e gëzon në të vërtetë sovranitetin? Këtë e gëzon Bordi i Përbashkët Ekonomik, i cili përbëhet nga 3 anëtarë arabë, 3 anëtarë hebrej dhe 3 përfaqësues të OKB-së. OKB-ja do të gëzojë përgjithmonë sovranitetin

e plotë në Palestinë. Po nga e ka marrë (OKB-ja) autoritetin për ta bërë këtë?

Madje, për sa i përket Jeruzalemit, do të jetë një qytet ndërkombëtar, i cili do të administrohet ndërkombëtarisht edhe kjo përgjithmonë. Raporti i nën-Komitetit 1 përmbante një dispozitë, sipas së cilës, pas dhjetë vjetësh ky sistem mund të rishqyrtohet. Pra, nëse 2/3 e banorëve të Jeruzalemit do të shprehnin një pikëpamje, qoftë pro apo kundër, kjo pikëpamje gjithashtu do të merret në konsideratë. Por kjo dispozitë është zhdukur gjatë ndryshimeve. Është thënë se ne duhet ta bëjmë Jeruzalemin një qytet ndërkombëtar përgjithmonë, për t'u administruar nga një guvernator



Përfaqësuesit e Pakistanit dhe Jemenit nënshkruajnë "Instrumentin e Zbatimit" në statusin e OKB-së, gjatë ceremonisë së pranimit në anëtarësim. Ulur në tryezë në zyrën e Z. Lie janë, nga e majta: Trygve Lie, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së; Sir Mohammad Zafarullah Khan i Pakistanit; dr. Hanna Saba, Drejtor i Divizionit të Traktateve, Departamenti Ligjor i OKB-së dhe Princi Sejfi el-Islam Abdullah i Jemenit. Burim: UN Photos

i cili do të emërohet nga OKB-ja.

A ka ndonjë pretendim që Jeruzalemi në të vërtetë do të jetë një qytet i pavarur? Jo. Ku qëndron autoriteti për të? Për sa i përket Asamblesë së Përgjithshme, ajo është përmendur në Nenet 11 dhe 14 të Traktatit. Neni 11 pohon që Asambleja e Përgjithshme mund të diskutojë dhe të bëjë rekomandime. Neni 14 thotë që Asambleja e Përgjithshme mund të ndërmarrë hapa për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve midis Shteteve Anëtare.

Ku është parashikuar autoriteti i Asamblesë së Përgjithshme për ta bërë atë, për të cilën ajo është ftuar sot? Për sa i përket Këshillit të Sigurimit, janë referuar Nenet 34, 39 dhe 41 të Traktatit. Për më tepër, si rezultat i asaj që është cilësuar si Amandamenti Danez (dokumenti A/AC.14/43 / Rev. 1) Nenet 39 dhe 41 tani janë përfshirë në rezolutën përfundimtare. Por a do të aplikohen ato? Në parathënien e rezolutës që gjendet në dokumentin A/516, thuhet se nëse situata e kërkon, Këshilli i Sigurimit, duke marrë masa sipas Neneve 39 dhe 41 të Traktatit, do të autorizojë Komisionin e OKB-së të bëjë atë që Komisionit i është kërkuar në këtë skemë. Unë nuk arrij të kuptoj plotësisht përmbajtjen e deklaratës, se marrja e masave sipas Neneve 39 dhe 41, do të autorizojë Komisionin e OKB-së për ta bërë atë që Komisioni është

autorizuar të bëjë. Si mund të vendosen Nenet 39 dhe 41 në këtë çështje, pasi ato mund zbatohen vetëm ndërmjet Shteteve Anëtare?

Por problemi është ky. Së pari, ku është parashikuar autoriteti i OKB-së që të sundojë shtetet sovrane? Së dyti, Anëtarët e Asamblesë janë të vetëdijshëm se arabët e Palestinës nuk do të bashkëpunojnë në ngritjen e një shteti arab. Unë nuk po flas për gjakderdhje apo për dhunë. Ata thjesht nuk do të bashkëpunojnë. Atëherë, si do të krijojë Asambleja e Përgjithshme një shtet arab? Si do të realizohen shërbimet administrative në këtë shtet arab? Si do të sigurojë ajo integritetin tokësor dhe mbrojtjen e kufijve të këtij shteti arab? Si do të ekzekutojë të gjitha funksionet e shumta që duhet të kryejë një qeveri në pushtet? Ku e ka parashikuar Asambleja e Përgjithshme autoritetin për ta bërë këtë? Këto pyetje janë ngritur në mënyrë të përsëritur, por ato nuk kanë gjetur përgjigje. E vetmja gjë që ka tërhequr vëmendje, është se si do të veprohet nëse shtetet fqinje arabe do të krijojnë ndonjë shqetësim.

Ky nuk është problemi për të cilin jam i shqetësuar. Unë shpresoj- madje, jam i bindur – që shtetet arabe, të cilat bëjnë pjesë në këtë Organizatë, nuk do të bëjnë asnjë përpjekje të tillë që u kundërvihet obligimeve të Traktatit që ne kemi marrë përsipër si anëtarë

të kësaj Organizate. Por si do të krijojë Asambleja e Përgjithshme një shtet arab nëse populli thotë: jo, ne nuk do të bashkëpunojmë? Si do të marrin shërbimet? Kush do të mbajë rendin publik? Këto shqetësime ishin vënë në dukje, por a janë përgjigjur?

Nëse përdorimi i forcës bëhet i domosdoshëm për qëllimin e ngritjes së Shtetit Arab, nga do të burojnë ajo? Kush do të kontribuojë në të? Kush do ta sigurojë atë? Nga do të ngrihet struktura administrative? Nga do të burojnë financat? Kjo situatë do të vazhdojë si një plagë e pezmatuar e cila do të katranosë punën e trupit ndërkombëtar. Forcat dhe financat mund të kërkohen në përmasa gjithnjë



Sir M. Zafrullah Khan (në të djathtë, nga Pakistani) flet me Amir Fejse al Saud, (në qendër) dhe Sheik Asad al Faqih, nga Arabia Saudite, në sallën e konferencave përpara takimit të 30-të të Komitetit Ad Hoc për Çështjen Palestineze të Sesionit të Dytë të asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Burimi: UN Photos

në rritje, siç e vërteton edhe përvoja e deritanishme e sistemit të mandateve. Ja përse Mbretëria e Bashkuar nuk i përmbahet çështjes së Mandatit mbi Palestinën.

Në lidhje me pyetjen mbi autoritetin ligjor a juridik të OKB-së për të gjitha çështjet ishte shprehur që kjo pyetje duhet t'i referohej Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. A e autorizon Traktati OKB-në për të përmbushur këto qëllime që janë propozuar? Kjo çështje ishte hedhur në votim në Komitetin Ad Hoc dhe referimi në Gjykatën Ndërkombëtare u refuzua me 20 vota pro dhe 21 kundër. Vetëm 21 anëtarë u shprehën formalisht se ishin “të kënaqur” ose pretenduan të ishin të kënaqur që disi, diku, duhet të ketë autoritet për të përmbushur detyrat që i janë propozuar. Vetëm 21, madje një shumicë e madhe e këtyre anëtarëve votuan, jo sepse ishin vërtet të kënaqur me çështjen ligjore, por sepse ishin të prirë për të mbështetur çfarëdo plani për Palestinën para se të ndërpritet Asambleja e Përgjithshme, duke u mjaftuar me një trajtim të përciptë.

Le të kalojmë te problemet praktike. Cila do të jetë situata në lidhje me mundësinë e ekzistencës së dy shteteve? Merrni rastin e shtetit arab. Vetë Komiteti i Posaçëm i OKB-së për Palestinën ka pranuar se nuk mund të realizohet një shtet arab, dhe

rrjedhimisht ka parashikuar ngritjen e një bordi të përbashkët ekonomik. Unë i kam tërhequr vëmendjen Komitetit Ad Hoc drejt deklaratës së një hebreu të shquar, një intelektual të madh dhe shumë të respektuar, dr. Judah Magnes, i cili është President i Universitetit Hebraik, për të cilin unë personalisht kam admirimin dhe respektin më të madh, dhe i cili ka thënë: “Bashkimi juaj ekonomik pa pasur bashkimin politik është një dështim që në hapin e parë dhe që nuk do të funksionojë kurrë”. Ai shton “Çfarë shprese mund të sjellë një bashkim ekonomik kur nuk është arritur bashkimi politik!” Nëse arabët nuk do të bashkëpunojnë, siç



Në foto, duke shkëmbyer pikëpamje (nga majta në të djathtë) Presidenti i Asamblesë së Përgjithshme Muhamed Zafrulla Khan (Pakistan); Z. Talaat Ghoussein, Ministër i Kuvajtit në Uashington dhe Kryetar i Delegacionit në OKB; Lartmadhëria e tij Shejh Saba el Ahmed Al-Sabah, Ministri i Jashtëm i Kuvajtit; dhe Z. Saeed Yacoob Shammas, Vëzhguesi i Përbërshëm i Kuvajtit në OKB.

Burim: UN Photos

kanë shprehur ata, as shteti hebre nuk do të jetë funksional. Ai do të qëndrojë gjithmonë në një gjendje të tendosur financiare si dhe ekonomike, e cila do të shtrihet edhe në fushën e personelit. Si do ta bëni këtë plan të zbatueshëm? Sërish, kush do të sigurojë dhe do të vazhdojë të sigurojë financat?

Le të analizojmë këtë zgjidhje nga këndvështrimi i drejtësisë, pasi të gjithë kanë shprehur besimin se kjo është një zgjidhje e drejtë që do të funksionojë nëse shtetet arabe bashkëpunojnë dhe nëse populli palestinez, si hebrenjtë edhe arabët, gjithashtu do të punojnë me një frymë bashkëpunimi.

Le të shqyrtojmë tri konsiderata në bazë të të cilave është shprehur se kjo është një zgjidhje e drejtë.

Mosmarrëveshja e parë është kjo: Ka 1,300,000 arabë në Palestinë dhe 650,000 hebrenj – me gjasa të jenë më shumë – dhe problemi është bërë i pazgjidhshëm. U tha: Prandaj, le të ndajmë (territorin) sepse do të ishte e padrejtë dhe jo etike që 33% e popullsisë – e cila është popullsia hebraike e Palestinës sot – të marrë statusin e minoritetit në një shtet unitar. Le të gjejmë një zgjidhje të drejtë: Arabët dhe hebrenjtë të kenë shtetin e tyre.

Kufijtë u vizatuan sipas rrethanave. Shteti arabe do përbëhet nga një milion arabë dhe vetëm dhjetë mijë hebrenj.

Në shtetin hebre do të ketë 498,000 hebrenj dhe 435,000 arabë. A e keni zgjidhur problemin? Hebrenjtë nuk duhet të jetojnë si pakicë nën arabët, por arabët duhet të jetojnë si pakicë nën sundimin e hebrenjve. Nëse njëra nga këto nuk është e drejtë, atëherë edhe tjetra del e padrejtë; dhe nëse njëra nuk përbën zgjidhje, as tjetra nuk mund të quhet e tillë.

Le të shqyrtojmë kufijtë për një çast. Si janë ndarë këto zona? Hebrenjtë përbëjnë 33% të popullsisë dhe arabët 67%, mirëpo 60% e sipërfaqes palestineze do t'i bashkohet shtetit hebre. Më tej, cilat janë karakteristikat



Palestina në hartën britanike të vitit 1924

© Wikimedia Commons

gjeografike të zonës, duke përjashtuar token shterpë të shkretëtirës, së cilës do t'i referohem më vonë? Nga toka pjellore e Palestinës që mund të shfrytëzohet për mbjellje, fushat në përgjithësi i shkojnë shtetit hebre, ndërsa kodrat arabëve. Përfaqësuesi i Mbretërisë së Bashkuar u kishte shpërndarë një dokument anëtarëve të komiteteve, i cili tregonte se 84% e sipërfaqes së tokës pjellore e cila është e lidhur me sistemin e kanalizimit të ujërave, do të jetë në shtetin hebre dhe vetëm 16% në shtetin arab. Me të vërtetë është një ndarje



Plani i ndarjes së Palestinës nga OKB në 1947

© Wikimedia Commons

shumë e drejtë që 1/3 e popullsisë të marrë 84% të sipërfaqes, ndërsa 2/3-at të kënaqen me 16%!

Vetë Komiteti i Posaçëm i OKB-së ka vërejtur se eksporti më i madh nga Palestina përbëhet nga agrumet, dhe mbjellja e tyre ndahet pothuajse gjysmë për gjysmë midis arabëve dhe hebrenjve, si dhe (pas ndarjes së kufijve) zona e agrumeve do të kalojë pothuajse tërësisht në shtetin hebre. Sa e drejtë është kjo? Palestina prodhon vetëm 50% të drithërave nga sasia që i duhet, dhe pjesa tjetër duhet të importohet. 80% e zonës që prodhon drithëra gjendet në shtetin hebre, dhe vetëm 20% në Shtetin Arab.

Përveç kësaj, mbetet edhe çështja e mundësisë për zhvillim. Shikoni në hartë. Ku ka hapësirë për zhvillim në Shtetin Arab? Një përfaqësues na tha – Oh, mund të krijoni ullishte edhe në kodra. Pa dyshim, ju mund të rrisni prodhimin e ullinjve në kodra; por mesatarisht ullinjve u duhen 25 vjet derisa të japin prodhimin e plotë.

Po si do të jetë bujqësia e zakonshme? Ashtu siç është theksuar në Komitet, në Negeb (Negev), beduinët arabë kanë kultivuar dy milionë dunam (dylm)¹ tokë, në varësi të reshjeve të pakta të shiut dhe tani 99% e kësaj sipërfaqeje po i jepet shtetit hebre. Në këtë zonë, 15% e tokës është në pronësi të pronarëve

privatë. Nga 15% e kësaj sipërfaqe, 14% është në pronësi të arabëve dhe 1% në pronësi të hebrenjve, ndërsa tani e gjithë kjo sipërfaqe, do të përfundojë në territorin e shtetit hebre. Popullsia arabe është mbi njëqind mijë, ndërkohë popullsia hebre është vetëm dy mijë, megjithatë e gjithë kjo sipërfaqe do t'i shkojë shtetit hebre.

Tani le të shqyrtojmë zonën që ndodhet në jug. Të gjithë kanë pranuar se ai trekëndësh këndngushtë është një tokë shterpë e papunuar, një shkretëtirë e përvëlur. Ndonëse informacioni që zotëroj mund të mos jetë i saktë, megjithatë jam në dijeni që përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara në Nën-Komitetin 1 ka ngritur të njëjtën pyetje se përse kjo zonë i është caktuar Shtetit Hebre. Por, atij nuk i është dhënë asnjë arsye. Sidoqoftë, nëse dikush e analizon hartën, ai mund të gjejë një arsye: Ky hap e çon kufirin e shtetit hebre deri në gjirin Akaba dhe kështu i jep atij një dalje në Detin e Kuq.

Para pak kohe, në lidhje me planin që ishte propozuar së fundmi dhe që nuk ishte miratuar, Pushteti i Mandatit ishte i etur për ta siguruar atë zonë. Sidoqoftë, Pushteti i Mandatit ishte më i sinqertë dhe kishte treguar qartë se arsyeja përse donin ta zgjeroheshin deri në këtë zonë ishte të siguronin rrugë në gjirin Akaba, zonë me rëndësi

strategjike për interesat e tij. A përbën kjo zonë rëndësi strategjike për shtetin hebre? Kjo nuk duket e vërtetë, pasi nëse flasim për dalje në det, shteti hebre laget vetë nga ujërat e Mesdheut. Pse duhet të kalojnë nëpër këtë shkretëtirë që të dalin në gjirin Akaba? Kujt i interesohet rëndësia strategjike e këtij vendi? Në fakt, kjo zonë do të qëndrojë në shtetin hebre për qëllime të tjera, dhe deri tani nuk është dhënë asnjë arsye për përfshirjen e saj.

Analizoni situatën në lidhje me industrinë. Praktikisht e gjithë industria hebraike ndodhet brenda kufijve të shtetit hebre. Pasi e vura në dukje këtë çështje në Komitet, një përfaqësues ndërhyri dhe tha: "Atëherë,



Presidenti i Asamblesë së Përgjithshme Mubamed Zafrulla Khan (majtas), nga Pakistani dhe Nënsekretari i OKB-së për Çështjet e Asamblesë së Përgjithshme, C.V. Narasimhan, i cili është gjithashtu Shefi i Kabinetit, duke shkëmbyer mendime në sallën e konferencës

Burim: UN Photos

po tërhiqni vërejtjen se përse industria hebraike gjendet brenda shtetit hebre!? Por ajo këtu duhet të jetë”. Sigurisht, ajo aty duhet të jetë dhe nuk kam thënë ndryshe. Unë kam thënë që kjo është plotësisht e drejtë dhe e duhur. Megjithatë, çfarë është bërë në lidhje me industrinë arabe? 40% e industrisë arabe është përfshirë brenda kufijve të shtetit hebre. Po kjo, a është e drejtë?

Si përgjigje do të thuhet, siç është thënë deri tani, se arabëve u është bërë një lëshim i madh në lidhje me Xhafa. Por çfarë është ky koncesion? Qyteti Xhafa i cili banohet kryesisht nga arabët është prerë si një enklavë (territor i rrethuar) që do të përfshihet në shtetin arab. Pse është trajtuar si një enklavë? Harta e përfshirë në raportin e pakicës së Komitetit të Posaçëm 1 tregon se përmes zonave arabe, ajo mund të lidhej me pjesën jugore të shtetit arab. Harta e përfshirë në raportin e shumicës 2 tregon se, përmes zonave kryesisht arabe, qyteti mund të jetë pjesë e shtetit arab. Atëherë, pse duhet të mbetet si një enklavë? Tokat midis qytetit Xhafa dhe shtetit arab në lindje dhe në jug janë kryesisht arabe. Pse duhet të trajtohet Xhafa si një enklavë?

Në lidhje me kufijtë është propozuar një amendament dhe është sugjeruar që, nëse ndarja është e pashmangshme, të paktën duhet të përcaktohen kufijtë në mënyrë të ndershme. Amendamenti

propozon që kufijtë të rekomandohen nga një komision i përbërë nga tre ekspertë kufijsh, të cilët do të emërohen nga Këshilli i Sigurimit. Ky komision duhet të siguronte që brenda shtetit arab të mos kishte më pronësi private të hebrenjve më shumë se 10% të territorit dhe po ashtu të arabëve në shtetin hebre. Ky propozim duhet të ishte mjaft i drejtë, megjithatë ai nuk gjeti pothuajse asnjë mbështetje jashtë shteteve arabe.

Tani arrijmë te pyetja nëse ky plan është me të vërtetë i zbatueshëm. Siç e kam thënë, përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara ka shprehur shpresën se ky plan mund të funksionojë nëse përkrahet nga shtetet fqinje arabe si dhe nga populli i Palestinës. Sigurisht shtetet fqinje arabe nuk do ta mbështesin një eksperiment të tillë; por gjithçka që mund të pritët prej tyre është që, si shtete sovranë, ato nuk do të ndërmarrin asnjë hap që u kundërvihet detyrimeve të tyre sipas traktatit.

Por, arabët e Palestinës kanë deklaruar se ata nuk do të bashkëpunojnë. Anëtarët e Asamblesë gjithashtu duhet të dinë se ky plan nuk është një eksperiment. Ky nuk është si eksperimenti i bërë në lidhje me Komitetin e Përkohshëm, të krijuar para një viti në të cilin qe parashikuar miratimi i një plani tjetër nga Asambleja e Përgjithshme në rast dështimi.



Presidenti i Asamblesë së Përgjithshme Oswaldo Aranha (i dyti nga e majta) bisedon me (nga e majta në të djathtë) Mohamed Zafrullah Khan, Kryetari i delegacionit të Pakistanit; Camille Chamoun, Ministri i Brendshëm i Libanit dhe Kryetar i delegacionit; dhe Larry Lesueur, komentator në radio CBS, pas takimit të 127-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së shtyu për 24 orë votimin përfundimtar mbi ndarjen e Palestinës në Flushing Meadows, New York.

Burim: UN Photos

Përkundrazi, ky plan është propozuar si një zgjidhje e përhershme. Nëse plani dështon, dështon dhe OKB-ja. Kjo organizatë është një strukturë e përhershme, prandaj ky plan përfaqëson meritat, nderin madje vetë ekzistencën e OKB-së. Prandaj, më mirë të përqendrojmë gjithë vëmendjen tonë në këtë fazë për të kuptuar se drejt cilës situatë po drejtohem. A është e gatshme Asambleja e Përgjithshme për ta vënë këtë bast?

Le të ndalemi pak dhe të shqyrtojmë përpara se të nisim OKB-në në një rrugë, që e detyron atë për të zbatuar një plan, të cilit i mungon justifikimi moral dhe që është përtej autoritetit të saj ligjor dhe juridik dhe që është e pamundur të arrihet. Nëse ju e bëni këtë përpjekje të kotë dhe fatale, keni shkelur dëshirat dhe aspiratat e 66% të popullit të Palestinës. Ju do të shkatërroni besimin dhe do të zhgënjëni shpresat e të gjitha shteteve fqinje në ndershmërinë dhe paanësinë e OKB-së, veçanërisht duke parë atë që ka ndodhur gjatë tri ose katër ditëve të fundit, të gjitha manovrat, në lidhje me mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, në të cilën po marrin pjesë shtetet e mëdha dhe të nderuara.

Në zemrat e popullatave të të gjitha vendeve, nga Bregu i Atlantikut të Afrikës Veriore deri në stepat e Azisë Qendrore, ju mbillni dyshim dhe mosbesim ndaj planeve dhe motiveve të fuqive perëndimore. Ju po rrezikoni të shkatërroni çdo mundësi të bashkëpunimit të sinqertë midis Lindjes dhe Perëndimit, në një shkallë që është përtej mundësisë së riparimit. Për ta zbatuar këtë plan me dhunë dhe forcë, keni futur pyka Perëndimore në zemrën e Lindjes së Mesme.

Si e ka përmbyshur OKB-ja përgjegjësinë e saj në lidhje me këtë çështje shumë të vështirë, shumë të ndjeshme dhe shumë njerëzore?

Ka pasur dy propozime, dhe ato janë përshkruar si propozime ekstreme. Një propozim parashikonte një shtet unitar dhe tjetri kërkonte ndarje. U ngritën dy nën-komisione. Njëri nën-komision mbështeti planin unitar dhe kishte përgjegjësinë për të hartuar një propozim që i përgjigjej këtij plani. Ndërsa nën-komisioni i dytë përbëhej nga anëtarët që përkrahnin ndarjen e territorit dhe gjegjësisht kishte përgjegjësinë të hartonte një propozim mbi këtë bazë.

A ka bërë ndonjë përpjekje Organizata e Kombeve të Bashkuara për të afruar arabin dhe hebreun së bashku, për të gjetur një rrugë të mesme që mund të sigurojë një zgjidhje mbi të cilën të dy popujt mund të kombinohen për të punuar si e vetmja zgjidhje që mund të ketë ndonjë shans të mundshëm për t'u përpunuar me sukses?

Ishte raporti i pakicës. Gjithashtu, pati edhe disa sugjerime të tjera, dhe, nëse aftësia politike nuk ka falemintuar plotësisht, ekziston mundësia për sugjerime të tjera, të cilat mund të shqyrtoheshin nga një organ i tretë. Një numër i madh i delegacioneve nuk e kanë mbështetur as idenë unitare dhe as idenë e ndarjes. Përse nuk u përdor zotësia e tyre për të gjetur ndonjë zgjidhje apo një rrugë të mesme?

Kur Nën-Komiteti 2 filloi punën, e

gjeti veten të përbërë nga anëtarë që kishin marrë një mendim në mënyrë konsensuale. Përfaqësuesi i Kolumbisë, i cili ndërkohë ishte zgjedhur Kryetar i Nën-Komitetit, kishte shprehur pakënaqësinë mbi këtë situatë. Ai kishte sugjeruar që t'i drejtoheshin Kryetarit të Komitetit Ad Hoc për Çështjen Palestineze dhe t'i kërkonin emërimin në Nën-Komitetin 2 disa shteteve të tjera përveç Kolumbisë që nuk ishin pro idesë së një shteti unitar, shtete të cilat mund të merrnin një qëndrim të mesëm, dhe të përpiqeshin të gjenin një zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët.

Kjo kërkesë iu dorëzua Kryetarit të Komitetit Ad Hoc dhe ai u informua gjithashtu se dy nga shtetet arabe ishin të gatshme për t'u larguar nga Nën-Komiteti, për t'i hapur rrugë riformimit



Dhoma e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga Neptuul, CC BY-SA 3.0, përmes Wikimedia Commons

dhe rindërtimit të tij. Por, ky sugjerim u refuzua; Kryetari nuk denjoi as t'i përgjigjej kërkesës. E vetmja përpjekje që ishte bërë në këtë drejtim, u refuzua tërësisht.

Tani na është thënë: Ju duhet të pranoni ose ndarjen ose asgjë. A është kështu dhe a është kjo zgjidhja e vetme? Sa mbështetje të mirëfilltë ka marrë plani i ndarjes? Në Komitetin Ad Hoc, ai mori mbështetjen e 25 delegacioneve. Disa nga këto 25 delegacione janë shprehur se e kanë mbështetur planin e ndarjes me gjysmë zemre, ndërsa të tjerët thanë se e kanë votuar planin me ngurrim, për të vetmen arsye se nuk u ishte ofruar asnjë zgjidhje tjetër. Kjo tregon se Asambleja e Përgjithshme në tërësi, nuk është e kënaqur të angazhohet në këtë të ashtuquajtur zgjidhje.

U përmend se nëse nuk pranohet plani i ndarjes, nuk do të arrijmë asnjë zgjidhje. Përkundrazi, nëse pranohet ndarja, kemi ndërmarrë hapin fatal. Arabët dhe hebrenjtë do të ndahen me anë të dhunës dhe ata kurrë nuk do të kenë shans për t'u bashkuar sërish. Një numër i madh hakmarrjesh të papërfunduara do të bllokojë rrugën përpara. Nëse e shtyni zbatimin e këtij plani dhe nuk ndërmerrni hapin fatal, ju sërish u keni lënë hapur arabëve dhe hebrenjve mundësinë e një zgjidhjeje pajtimi përmes së cilës ata mund të ndërtojnë një të ardhme të bashkuar. Nuk është e

vërtetë se nëse nuk merrni një vendim përfundimtar sot, juridiksioni juaj do të tkurret apo të shfuqizohet.

Kjo do të thotë se asnjëra nga këto dy zgjidhje nuk është e pranueshme, dhe që duhet gjetur ndonjë rrugë tjetër. Përgjegjësia bie mbi ju, prandaj mos iu shmangni këtij shansi. Mos e mbyllni derën që mund të mos hapet përsëri. Organizata e Kombeve të Bashkuara duhet të gjejë një zgjidhje që nuk është vetëm e drejtë dhe e ndershme, por që ka mundësinë më të madhe për sukses në lidhje me popullsinë hebreje dhe arabe në Palestinë.

Vota jonë sot, nëse nuk mbështet ndarjen, nuk përjashton mundësinë e zgjidhjeve të tjera. Vota jonë, nëse



(Nga e majta në të djathtë): Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së U Thant; Presidenti i Asamblesë së Përgjithshme Muhamed Zafrulla Khan (Pakistan); dhe Këshilltari Ligjor i OKB-së Konstantin Stavropoulos.

Burim: UN Photos

miraton ndarjen, mbyll mundësinë e të gjitha zgjidhjeve paqësore. Le ta marrë përsipër secili këtë përgjegjësi. Thirrja ime për ju është: mos e mbyllni këtë mundësi. Kombet e Bashkuara duhet të synojnë të afrohen, të bashkohen dhe të gjejnë konvergjencë e jo të ndahen dhe të shfaqin divergjencja.

Përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara iu referua lutjes dhe dëshirës sime të shprehur në fund të fjalimit tim në Komitetin Ad Hoc. Unë e përsëris këtë lutje me përlulesi, me sinjeritet dhe me dëshirë të zellshme:

Qoftë Ai që sundon mbi të gjitha zemrat dhe i di mendimet dhe qëllimet më të fshehura, i cili vetëm mund të çmojë vlerën e vërtetë dhe mund të parashikojë pasojat e të gjitha veprimeve njerëzore, me madhështinë dhe mëshirën e Tij, të drejtojë gjykimin tonë! Ajo që ne vendosim këtu sot, ndihmoftë dhe nxittë paqen, mbarësinë dhe mirëqenien e të gjitha krijesave të Tij: hebrenj, arabë e johebrej, dhe riktheftë lavdinë e Tij përgjithmonë!

(Sir Muhammad Zafrulla Khan përfundoi fjalën e tij në arabisht.)

وَأَخِرُ دَعْوَانَا أَنِ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

(Përkthyer nga arabishtja): “Thirrja jonë e fundit është: Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve!”

SHËNIME:

[1] dunam, dynym ose dylym ishte një masë e sipërfaqes së tokës që përdorej në vendet që janë pushtuar nga Perandoria Osmane. Një dunam është i barabartë me 1000 metra katrorë. (shënim përkth.)

[2] Mandati britanik i Palestinës ose Mandati i Palestinës ishte një entitet gjeopolitik i krijuar midis viteve 1920 dhe 1948 në rajonin e Palestinës nën kushtet e Mandatit të Lidhjes së Kombeve për Palestinën.

Gjatë Luftës së Parë Botërore (1914–18), një kryengritje arabe kundër sundimit osman dhe Forcës Ekspeditive Egjiptiane të Perandorisë Britanike i dëboi osmanët nga Levanti gjatë fushatës së Sinait dhe Palestinës. Mbretëria e Bashkuar kishte rënë dakord në Letërkëmbimin McMahon–Hussein se do të nderonte pavarësinë arabe nëse ata revolttoheshin kundër Perandorisë Osmane, por të dy palët kishin interpretime të ndryshme të kësaj marrëveshje, dhe në fund, MB dhe Franca ndanë zonën nën marrëveshjen Sykes–Picot — një akt tradhtie në sytë e arabëve.

Burim: United Nations:

<https://unispal.un.org/UNISPAL>.



Epërsia e lartë e Kuranit të Shenjtë

Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}
Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu ^{a.s.}

Kam dëgjuar se disa prej jush nuk i besojnë fare hadithet. Gabojnë rëndë ata që bëjnë një gjë të tillë. Ky nuk është mësimi im. Besimi im është që Zoti ju ka dhënë tri gjëra për udhëzimin tuaj:

Më së pari është Kurani, i cili flet për njëshmërinë, madhështinë e rëndësinë e Zotit, dhe vendos për mosmarrëveshjet mes hebrenjve e të krishterëve. Njëra syresh është edhe mosmarrëveshja dhe gabimi i tyre se gjoja Isai biri i Merjemes u vra përmes kryqëzimit, u cilësua i mallkuar dhe se nuk u ngrit sikur Profetët e tjerë.

Në të njëjtën mënyrë, në Kuran është bërë e ndaluar të adhurosh diçka tjetër përveç Zotit, qoftë njeri, qoftë kafshë, qoftë dielli, qoftë hëna, apo ndonjë

yll, qofshin mjetet apo qoftë vetvetja. Andaj, jini vigjilentë dhe mos hidhni asnjë hap kundër mësimit të Zotit dhe udhëzimit të Kuranit. Singërisht ju them të vërtetën, ai që shpërfill qoftë edhe një urdhër të vogël prej shtatëqind urdhërimeve të Kuranit, me dorën e tij mbyll derën e shpëtimit të vet. Rugët e shpëtimit të vërtetë e të përsosur i ka çelur Kurani, gjithçka tjetër është hija e tij. Prandaj, studioni Kuranin duke u thelluar në të dhe duajeni kaq shumë atë, siç nuk keni dashur askënd tjetër, sepse Zoti m'u drejtua mua dhe më tha:

الْخَيْرُ كُلُّهُ فِي الْقُرْآنِ

E gjithë mirësia është në Kuran. Kjo pikërisht është e vërteta. Keqardhje për ata që i japin përparësi diçkaje tjetër mbi Kuranin. Burimi i gjithë shpëtimit dhe i suksesit tuaj është në Kuran. Nuk keni asnjë nevojë fetare që nuk e gjeni në Kuran. Vërtetuesi ose përgënjeshtuesi i besimit tuaj ditën e gjykimit do të jetë

Kurani. Përveç Kuranit nuk ka asnjë libër nën kupën e qiellit, që pa u lidhur me Kurandin, të mund t’ju udhëzojë. Zoti ju ka bërë mirësi të madhe që ju dhuroi një Libër si Kurani.

Sinqerisht ju them të vërtetën, Libri që ju është lexuar juve, nëse do t’u lexohej të krishterëve, nuk do të shkatërroheshin, dhe ky bekim e udhëzim që ju është dhënë juve, po t’u jepej hebrenjve në vend të Tevratit, disa sekte të tyre nuk do të bëheshin mohues të ahiretit. Prandaj, çmojeni bekimin që ju është siguruar juve. Kurani është një bekim shumë i bukur, një pasuri shumë e vyer. Po të mos vinte Kurani, e gjithë bota do të ishte si një copëz e pistë mishi. Kurani është Libri para të cilit të gjitha udhëzimet e tjera janë asgjë. ...

Kurani mund të pastrojë njeriun brenda një jave, nëse ai e ndjek edhe me fjalë, edhe me kuptim. Kurani mund t’ju bëjë porsì Profetët, nëse ju vetë nuk i largoheni atij. Cili Libër përveç Kuranit u ka mësuar lexuesve të vet që në fillim të tij, një lutje të tillë si kjo, njëherësh duke u dhënë një shpresë si kjo:

اهدنا الصراط المستقيم ﴿١﴾ صراط الذين أنعمت عليهم

Ihdinas-sirātal-mustekim. Sirātal-ledhine en’amte ‘alejhim.

“Na udhëzo në rrugën e drejtë; në rrugën e atyre që i bekoje.”¹

Na trego rrugën e atyre bekimeve që ua dhe edhe të parëve. Dhe këta të parët ishin profetë, të dërguar, të vërtetë, dëshmorë dhe të dëlirë. Prandaj, merrni guximin dhe mos e refuzoni ftesën e Kuranit, se ai dëshiron t’ju japë bekimet që u janë dhënë të parëve. ...

Zoti dëshiron t’ju bekojë edhe më shumë se ata. Zoti ju ka bërë trashëgimtarë të pasurisë së tyre shpirtërore e fizike, por dikush tjetër nuk do të jetë trashëgimtari juaj, deri së të vijë kiameti. Zoti kurrësi nuk do t’ju privojë ju nga bekimi i shpalljes (vahji), i diktimit (ilham), i diskursit dhe i komunikimit me Të. Ai do t’ju plotësojë të gjitha bekimet që ua kishte dhënë edhe të parëve.

Por ai që shkel dhe trillon mbi Zotin dhe thotë “më erdhi shpallja e Zotit”, ndërkohë që nuk i ka ardhur, ose thotë “unë gëzova bekimin e komunikimit dhe të diskursit me Zotin”, ndërkohë që nuk e ka gëzuar, atëherë unë po ju them duke sjellë dëshmitar Zotin dhe engjëjt e Tij, ai do të shkatërrohet, sepse mashtrroi dhe trilloi mbi Krijuesin e tij.²

SHËNIME

1. *El-Fatiba* 1:6-7

2. “*Mësimi ynë*”, f. 27-29, Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2020

Ç'është media sociale?

*A mendoni se dini njatueshëm për
rrjetet sociale?*

Farhat Mahmood, SHBA
Sarmad Naveed, Kanada



Dilema e rrjeteve sociale

Hapni telefonin tuaj; shkoni në cilësimet dhe kontrolloni kohën e ekranit. Sa orë keni kaluar në telefonin tuaj, duke lëvizur dhe duke u angazhuar me çdo njoftim që sapo ju është shfaqur, është dridhur apo është shfaqur në ekran?

A është shokues numri i munitave apo i orëve? A jeni befasuar?

Sot është e vështirë të gjeni dikë pa një telefon inteligjent (smartfon). Shumica e njerëzve e dinë se po futen në “vrëmën e lepurit” të kohës nëpër ekrane në platforma të ndryshme të medias sociale, por duket se nuk mund të tërhiqen dot. Joshja e kënaqësisë së menjëhershme dhe e vetëqetësimit të vazhdueshëm që ata marrin nga postimet, nga videot dhe nga përmbajtja e medias sociale ka bërë që një pjesë e mirë e popullsisë së botës të qëndrojë galiç nëpër ekrane.

Por, në përgjithësi, përdoruesit e medias sociale a e dinë me të vërtetë se çfarë është ajo? Çfarë mund t’u shkaktojë? Cili mund të jetë potenciali i saj? Jo, sipas dokumentarit të ri [janar, 2020] të Netflix, “The Social Dilemma”.¹

Dokumentari na njeh me zhvilluesit, tregtarët dhe drejtuesit kryesorë të Silicon Valley, që ndihmuan në prezantimin dhe integrimin e medias sociale nëpër botë. Po këta njerëz tani janë hapur për të reflektuar dëmin kolosal që krijimet e tyre po i shkaktojnë shoqërisë. Dokumentari paraqet median sociale si një entitet i

cili pothuajse ka marrë formën e një jete në vetvete, që mbledh të dhëna, rritet ndërsa përdoruesit vazhdojnë të ushqejnë platformat me pëlqimet, ndjekjet, pikëpamjet dhe preferencat e tyre. Bazuar në të gjithë këtë informacion, algoritmet u tregojnë shikuesve saktësisht përmbajtjen që ata duan të shohin, duke i mbajtur kështu të lidhur edhe më shumë, edhe më gjatë.

“Qëllimi i medias sociale është fitimi monetar”

Ekspertët në këtë dokumentar zbulojnë gjithçka. Ata shpjegojnë arsyen përse ‘përdorues’ (ang. user) të medias sociale quhen të tillë dhe jo ‘konsumatorë’. Ata gjithashtu tregojnë për metodën “Vëzhgimi Kapitalist” të medias sociale, hakimin psikologjik, shqetësimet mendore, sociale dhe të sigurisë dhe për shumë gjëra të tjera.

Ky dokumentar ekspozon një anë të medias sociale, që shumë njerëz mund të mos e kenë parë kurrë më parë.

Është vërtet e çuditshme t’i shohësh këta themelues duke u penduar e duke u përpjekuar të ndryshojnë rrjedhën e diçkaje që dikur e kishin si forcë lëvizëse të saj, dhe duke sugjeruar mënyra se si platformat të jenë më etike dhe më njerëzore. Për më tepër, ndjesia e tyre kërkon një ndryshim urgjent me reforma të menjëhershme, në mënyrë që të shmangen pasojat e mëtejshme kataklizmike.

Pasi kemi parë dhe analizuar me kujdes dokumentarin “The Social

Dilemma”, këtu janë disa nga aspektet e dokumentarit që na ranë në sy më së shumti:

Ju nuk jeni konsumatori, jeni produkti

“Nëse nuk po paguani për produktin, jeni ju produkti.” – “The Social Dilemma”

Dokumentari shpjegon se ka një arsye për termin ‘përdorues’ të medias sociale që është më i arsyeshëm sesa ‘konsumator’ të medias sociale. Kjo është për shkak se modeli i fitimit të medias sociale bazohet në reklama, dhe njerëzit që përdorin median sociale nuk paguajnë për të përdorur këto shërbime. Kjo do të thotë që përdoruesit janë produkti, dhe konsumatorët e vërtetë janë kompanitë reklamuese.

Në thelb, platformat e medias sociale mbledhin, analizojnë dhe madje kontrollojnë produktin (përdoruesit e rrjeteve sociale) në mënyrë që të paraqesin një produkt të personalizuar për konsumatorët (kompanitë e reklamave).

Kjo është bërë nga gjurmimi i të dhënave nga secila lëvizje e secilit përdorues. Çdo pëlqim, mospëlqim, preferencë, deri në cilat fotografi shikojmë më gjatë e cilat jo, të gjitha të dhënat rreth nesh ruhen. Duke vepruar kështu, krijohet një model i përdoruesve, i cili nga ana e tij lejon që platformat e medias sociale të ndryshojnë në mënyrë të padukshme

sjelljet dhe madje interesat e njerëzve e që të kujdesen drejtpërdrejt për reklamuesit. Këto sisteme janë aq të ndërlikuara sa që ato dinë kur jemi të lumtur, kur jemi të trishtuar, të dëshpëruar, etj.. Jo vetëm që ato mbledhin informacion, por janë në gjendje të parashikojnë se çfarë do të bëjmë më pas ose të na manipulojnë në veprimin tonë të ardhshëm në median sociale. Është një lojë ku ‘fiton parashikimi më i mirë’.

Në thelb, dokumentari shpjegon se mediat sociale drejtohen bazuar në “kapitalizmin eurvejimit”² në një treg që shkëmben brokerime njerëzore, si të jenë brokerimet e naftës.

Luajnë me mendjet tona

Media sociale përdor pirateri psikologjike



**/the
social
dilemma**

për të na mbajtur të lidhur. Një krijues i medias sociale në dokumentar thekson tri qëllimet kryesore të medias sociale:

Angazhimi: Na mban të angazhuar në median sociale

Rritja: Na rikthen vazhdimisht në media sociale, së bashku me përdoruesit e rinj. Përdorimi i përdoruesve dhe i informacionit të tyre për t'u kujdesur për reklamuesit dhe për të përfiturat prej tyre.

Media sociale nuk mund të konsiderohet një 'mjet'

Shpesh dëgjojmë njerëz që thonë se media sociale janë një mjet i shkëlqyeshëm. Dokumentari e shpjegon në mënyrë të thjeshtë. Mjeti është diçka që është aty dhe pret që të përdoret. Por nëse diçka ju kërkon që ju të përshtateni sipas asaj dhe të plotësoni kriteret e saj, sikundër edhe media sociale, atëherë nuk mund të konsiderohet një mjet.

Dokumentari nxjerr në pah implikimet psikologjike të medias sociale që rrënjosen thellë. Ajo është krahasuar me një makinë pokeri – ne i ulim telefonat tanë, vetëm për t'i marrë përsëri disa sekonda më vonë duke shpresuar të shohim diçka të re.

"Ekzistojnë vetëm dy industri që i quajmë klientët e tyre përdorues: industria e drogës dhe industria e softwarëve", thotë Edward Tuffe, "The Social Dilemma".

Është më pak një mjet, dhe më shumë një lloj droge. Si njerëz, kemi një nevojë të lindur për t'u lidhur me të tjerët. Mediat sociale e kanë rritur në mënyrë eksponenciale këtë nevojë të lindur në një shkallë të tillë, sa që është kthyer në varësi.

Njerëzit a janë të aftë mendërisht për t'u marrë me mediat sociale?

Dokumentari ofron një këndvështrim vërtet unik dhe të bën të mendohesh për këtë temë. Si qenie njerëzore, jemi krijuar dhe jemi prirë të dimë e të kujdesemi për përshtypjen për ne që mund të ketë 'grupi', të cilit i përkasim. Sidoqoftë, ne nuk jemi të përgatitur për t'u njohur me mendime që 10,000 njerëz të tjerë mund të kenë rreth nesh.

Kështu, duke u përpjekur të merren me këtë fenomen të panatyrshëm, njerëzit e gjejnë veten duke ndjekur diçka që nuk ekziston.

"Ne kurojmë jetën tonë për hir të disa sinjaleve afatshkurtra." – The Social Dilemma

Njerëzit ndjekin miratimin në formën e pëlqimeve, zemrave etj., por vlera e këtyre gjërave zgjat vetëm për një moment, dhe ato janë boshe dhe pa ndonjë vlerë a vërtetësi reale. Por ky aprovim i çastit është aq tërheqës, sa i lë njerëzit të dëshirojnë më shumë,

gjë që dokumentari e përshkruan si, “popullaritet të rremë dhe të brishtë”.

Rezultatet e kësaj, megjithatë, mund të jenë vërtet katastrofike. Korrelacioni i gjetur midis fillimit të platformave të medias sociale dhe midis një rritjeje të madhe të vetëshkatërrimeve dhe vetëvrasjeve mes vajzave adoleshente është vërtet befasues. Sipas dëshmimeve të paraqitura në dokumentar, gjatë kësaj periudhe kohore, numri i vajzave paraadoleshente që kanë dëmtuar vetveten, është rritur me 189%.

Kjo tregon qartë faktin se media sociale nuk mund të konsiderohet asgjë më shumë se një ‘biberon’ dixhital që nuk bën asgjë sociale për të ndihmuar njerëzit që janë me depresionin dhe ankthe, përkundrazi, ua shkakton dhe ua shton problemin edhe më shumë.

Cila është “vrirja juaj e lepurit”?

Shumë i drejtohen medias sociale për informacion dhe lajme. Por, parafytyroni nëse njerëzit do të kërkonin një përkufizim të caktuar në Wikipedia, dhe secilit prej tyre Wikipedia do t'i

jepte përkufizime të ndryshme për të njëjtin kërkim, bazuar në interesat e kërkuësve. Dokumentari shpjegon se kjo është pikërisht ajo që bën Facebook-u.

‘Të gjithë jemi duke operuar në një grup tjetër “faktesh”. – The Dilema Sociale

Njerëzit mund të mendojnë se po marrin lajme dhe fakte të paanshme, ndërsa mediat sociale u japin saktësisht atë që ata duan të shohin, bazuar në informacionin që ato kanë mbledhur rreth modeleve dhe interesave të përdoruesve të tyre. Kjo u jep atyre disa “vrirja lepurit” apo disa zgjidhje të pazakonta e paradoksale, që u përshtaten më mirë personalitetit të përdoruesve.

Për shembull, bazuar në zakonet e caktuara të një përdoruesi të caktuar, nëse platformat e mediave sociale e kanë dalluar atë që ai ka më shumë të ngjarë të besojë në teoritë konspirative, atëherë atij i servirin më shumë pikërisht këtë temë, në krahasim me informacionin e paanshëm dhe të pa filtruar. Përdoruesve të tillë do t’u shfaqen më shumë postime rreth gjërave të tilla si, ‘toka është e sheshtë.’ Sa më shumë ta shohin atë, aq më shumë do ta konsiderojnë atë si një fakt.

Nganjëherë ju shikoni njerëz që protestojnë për diçka krejt të padrejtë, ose që ndjekin një teori të caktuar krejt të pakuptimë,



dhe ju mendoni se si ka mundësi që këta njerëz veprojnë në këtë mënyrë dhe shtroni pyetjen: Vallë, këta a nuk janë të lidhur me teknologjinë e kohës? A nuk shikojnë botën në rrjetet sociale? Përgjigjja, sipas dokumentarit, është që ata patjetër e shikojnë botën përmes teknologjisë, njësoj si ju, por në media sociale, bota nuk u shfaqet atyre ashtu siç ju shfaqet juve.

Në mënyrë të ngjashme, dokumentari shpjegon se si funksionojnë reklammat në Facebook. Mund të jenë njëqind njerëz që bashkohen në një grup të caktuar, aderuesve të të cilit u shfaqet një reklamë. Facebook mbledh të dhënat se si secili prej tyre reagon ndaj kësaj reklame, dhe kështu krijon të dhënat për përdoruesin mesatar. Pastaj, Facebook u dërgon të njëjtën reklamë një mijë njerëzve të tjerë, të cilët u ngjajnë njëqind fillestarëve, që u ishte shfaqur reklama.

“Informacioni i rremë përhapet 6 herë më shpejt se e vërteta.” – The Social Dilemma

.....

Kontrolli i qeverive duke përdorur mediat sociale

“Facebook është një mjet që tenton të të bindë. Mund të jetë mjeti më i fortë i krijuar ndonjëherë.” – The Social Dilemma

.....

Sistemi i mediave sociale bazohet në lajme të rreme, ose lajme që përfaqësojnë të gabuarën, për arsyen e thjeshtë se kjo metodë bën më shumë para. Njerëzit shohin më shumë përmbajtje selektive që u përshtatet atyre, kështu që ata kthehen më shpesh, duke mos ditur vërtetësinë e asaj që ata marrin.

Dokumentari sqaron se nëse një qeveri apo organizatë dëshiron të manipulojë njerëzit, mjeti më i mirë është Facebook-u. Parafytyroni: diçka si Facebook të jetë nën kontrollin e një diktatori që dëshiron të fusë një axhendë të caktuar; nëse dikush dëshiron të manipulojë zgjedhjet, nëse dikush dëshiron të propagandojë një teori konspirative – e gjithë kjo mund të bëhet, pa u kuptuar nga përdoruesit e mediave sociale se diçka e tillë po ndodh vërtet.

Media sociale a është një kërcënim ekzistencial?

“Është një utopi dhe distopi njëkohësisht.” – The Social Dilemma

.....

Në fund të dokumentarit, kokat që qëndrojnë pas medias sociale pranojnë se është një fushë konfuze, e cila ka si përfitimet ashtu edhe rreziqet e saj. Por ata pohojnë në mënyrë kategorike dhe unanime, se duhet një vijë e qartë, një ekuilibër, madje edhe rregullator, në mënyrë që pasojat negative të mediave

sociale të kontrollohen.

Në fakt, kur një ekspert u pyet për frikën e tij më të madhe në lidhje me implikimet e mediave sociale, përgjigjja e tij ishte thjesht, “një luftë civile”.

“Teknologjia nuk është kërcënim, por aftësia e teknologjisë për të nxjerrë më të keqen në shoqëri është kërcënim ekzistencial.” – The Social Dilemma

.....

Duhet reformë apo çaktivizim ... apo të dyja?

Në dritën e të gjitha këtyre realiteteve që na sjellin mediat sociale, zgjidhja e paraqitur në dokumentar është reforma e plotë në mënyrën e qasjes dhe të përdorimit të mediave sociale. Madje, zgjidhja që paraqesin disa nga ekspertët është thjesht të çaktivizoni rrjetet sociale.

Sidoqoftë, nuk ka dyshim se bota e pikturuar nga peneli i mediave sociale është me të vërtetë një vend tejet i dyshimtë. Njëri prej ekspertëve që kontribuuan në krijimin e rrjeteve sociale, pohon: jetojmë në një botë ku pemët kanë më shumë vlerë të vdekura sesa të gjalla. Jetojmë në një botë ku do të preferojmë të jemi të ngjitur në ekranet tona duke përjetuar jetën sipas algoritmeve të vendosura nga disa të tjerë, të cilët mund të mos kenë më as aftësinë për të kontrolluar këto algoritme.

Ndoshta reflektimi më i goditur vjen në fund të dokumentarit, kur këta krijues të rrjeteve sociale pranojnë se nuk i lejojnë fëmijët e tyre të përdorin platformat e mediave sociale që vetë ata kanë krijuar.

Reflektime

Ndoshta na duhet me të vërtetë të rishikojmë mënyrën sesi i qasemi medias sociale, si e përdorim dhe si e zbatojmë atë. Duke gjykuar nga dokumentari, pothuajse duket sikur këta krijues ndërtuan një makinë e cila ka marrë në kontroll jetën e saj dhe ata nuk kanë më kapacitetin për ta përmbajtur atë. Në fakt kjo pikërisht ka ndodhur.

Sidoqoftë nuk mund të mohohet që media sociale gjithashtu na ofron dobi të shumanshme. Pra, njeriu ka nevojë të përpiqet të kuptojë se me të gjitha dëmet dhe të metat që janë theksuar nga ky dokumentar, si mund të veprojë me median sociale?

Fjalët kyçe që ju vijnë në mendje janë: kujdes dhe moderim.

Islami mëson se rruga e mesme duhet të aplikohet në çështjet e tilla të jetës. Një qasje e çekuilibruar ndaj gjithçkaje sigurisht që sjell pasoja negative. E njëjta gjë do të jetë edhe me median sociale, pra të marrësh të mirën, dhe të lësh të keqen, dhe duke mos u bërë i varur ose i zhytur plotësisht në të. Në thelb, media

sociale duhet të përdoret sipas rregullit: përdor aq sa të duhet.

Një folës në dokumentar, diku afër fundit, aludoi duke thënë se ajo që i mungon botës së medias sociale është udhëzimi. Është nder i madh i muslimanëve ahmedianë në të gjithë botën, të jenë të bashkuar nën një udhëheqës i cili jo vetëm udhëzon në çështjet shpirtërore, por edhe në jetën e përditshme – përfshirë përdorimin e medias sociale. Hazret Mirza Masrur Ahmedi, Kalifi i Pestë dhe udhëheqësi botëror i miliona muslimanëve të Xhematit Ahmedia në botë, vazhdimisht i udhëzoi anëtarët e Xhematit në lidhje me përdorimin e rrjeteve sociale, shumë përpara se sa të shfaqej dokumentari “The Social Dilemma”. Në një takim të zhvilluar në vitin 2011, ai tha:

“Unë kam thënë që Facebook-u ka më shumë dëme dhe më pak dobi. Prandaj rinia jonë, veçanërisht vajzat dhe ato që nuk e njohin plotësisht atë, nuk duhet të ekspozohen në Facebook në një masë të tillë që ato vetë të bien në grackë ... Ata që përdorin Facebook-un duhet të dinë tërësisht efektet e tij dhe ta përdorin atë deri në një masë të caktuar. ... Vetë krijuesi i Facebook-ut ka thënë se në Facebook nuk ka kufi dhe dikush mund të ekspozojë veten tërësisht ndaj të gjithëve. Një njeri i denjë, fetar dhe i arsimuar nuk mund të tolerojë gjëra të tilla”.³

Më pas, në një rast tjetër në vitin 2015, duke folur për pasojat negative të Facebook-ut, Shenjtëria e tij pohoi:

“ ... ajo shkatërron të gjithë kufijtë dhe privatësinë midis njerëzve, ekspozon çështjet personale të njerëzve dhe nxit pahijshmërinë. Personi që krijoi këtë faqe në internet ka thënë vetë, se ai e krijoi atë në internet sepse mendon se realiteti i njerëzve duhet të hapet dhe të ekspozohet ndaj gjithë njerëzve të tjerëve. Sipas tij, të qenët i hapur do të thotë që nëse një person dëshiron të postojë një fotografi të vet nudo, ai jo vetëm të jetë i lirë ta bëjë këtë, por edhe të tjerët ta inkurajonë atë dhe të komentojnë mbi të. Innalil-lah!. Po kështu, kushdo mund të postojë çfarëdo që sheh. Nëse ky nuk është degradim ekstrem moral, atëherë çfarë tjetër mund t'i thoni kësaj? Në këtë gjendje degradimi moral, një ahmedian duhet të përvetësojë standardin e lartë të moralit dhe të virtutit...”⁴

Muslimanët ahmedianë janë të ekspozuar ndaj medias sociale njësoj si kushdo tjetër. Ndryshimi i vetëm është se anëtarët e Xhematit Musliman Ahmedia udhëzohen nga Shenjtëria e tij në çështje të tilla, në mënyrë që të mbrohen nga pasojat.

Media sociale për qëllimet duhura

Sigurisht, mediat sociale kur përdoren në mënyrë të moderuar për qëllimet e duhura dhe për të mirën e shoqërisë,

mund të rezultojnë jashtëzakonisht të dobishme. Nëse dikush do të bëjë një thirrje, për shembull, për të ndihmuar dikë që ka nevojë për një dhurues organesh për të shpëtuar jetën e tij, ose ka nevojë për ndihmë për të paguar trajtimin mjekësor, ndihmë e cila mund t'ia shpëtojë jetën dikujt, atëherë vendosja e reklamave për një audiencë që ka më shumë të ngjarë t'u përgjigjet mesazheve të tilla do të ishte jashtëzakonisht e dobishme dhe do të ndihmonte për të shpëtuar jetë njerëzish.

Po kështu, Xhemati Musliman Ahmedia përdor mediat sociale për përhapjen e mesazhit të Islamit të vërtetë, për largimin e keqkuptimeve dhe edukimin e masave mbi realitetin dhe bukurinë e mësimave Islame që promovojnë dhe nxisin paqen, dashurinë dhe harmoninë.

Pra, kur përdoren për qëllime të dobishme në një mënyrë të kontrolluar dhe të kujdesshme, mediat sociale mund të rezultojnë si mjet i shkëlqyeshëm për përhapjen e të mirave.

Duke treguar anën pozitive të medias sociale, Shenjtëria e tij deklaroi:

“Këto ditë, siç kam shpjeguar pak më lart me shembuj konkretë, shumë gjëra që ndodhin, shkaktojnë pakënaqësinë e Zotit. Përdorimi i saktë i këtyre gjërave natyrisht që nuk është i keq, përkundrazi, do të shërbente në përhapjen e mirësisë;

por keqpërdorimi i tyre po përhap ndyrësinë, ligësinë dhe mëkatën”.⁵

Mesazhi është i qartë. Përdorimi i shfrenuar, mungesa e një rregullatoreje, shthurja dhe udhëzimi i cekët në çështjet e mediave sociale e kanë vendosur njerëzimin në një trajektore, e cila mund ta çojë vetëm drejt shkatërrit. E vetmja mënyrë që mund të provojë të jetë e dobishme është reforma nga krijuesit, përdoruesit dhe konsumatorët. Kjo është e mundur vetëm duke miratuar rrugën e mesme.

SHËNIME

[1]. Dokumentari i Netflix-it “The Social Dilemma”.

[2]. Kapitalizimi iurvejimit është një sistem ekonomik që përqendrohet në komodifikimin e të dhënave personale me qëllimin e kryesor të fitimit. Sipas znj. Shoshana Zuboff, koncepti i kapitalizmit tëurvejimit u shfaq kur kompanitë e reklamave, të udhëhequra nga AdWords të Google-it, zbuluan mundësinë e përdorimit të të dhënave personale si një mjet për të synuar konsumatorin në mënyrë më preçize.

[3]. Takimi “Gulshan-e-Wakfe Nau”, 18 dhjetor 2011.

[4]. Fjalimi përmbyllës, Xhelsa Salana e Gjermanisë, Karlsruhe, 26 qershor 2011.

[5]. Fjalimi i së xhumasë, i datës 18 tetor 2013.

Mbajtja e premtimit

Në ngjarjen që vijon shihet se sa shumë kujdesej Profeti ^{s.a.v.s.} për mbajtjen e premtimit. Një herë, i kishte ardhur atasheu i një shteti për të dhënë një mesazh. Pasi qëndroi disa ditë në shoqërinë e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, ai u bind për vërtetësinë e Islamit dhe i kërkoi: “O i Dërguari i Allahut, tashmë jam bërë musliman nga zemra dhe dua të shfaq islamin tim”. Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} nuk e lejoi dhe tha që për sa kohë ai ishte përfaqësues i shtetit të tij, duhet të kthehej në të njëjtën gjendje. E, nëse prapë do të ndiente dashuri ndaj Islamit, të vinte sërish për ta përqaftuar Islamin.^[1]

Tema e jetës së Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} nuk është e tillë sa mund të përfundojë në kaq pak faqe, ose që mund të trajtohet vetëm në disa aspekte. Nuk mund ta shtjelloj më shumë këtë, ngaqë ky libër nuk është mirëfilli biografi e Profetit ^{s.a.v.s.}, por është një hyrje për komentimin e Kuranit Famëlartë. Prandaj, më lejoni të mjaftohem me kaq.

Fragment nga libri “Jeta e Muhammedit ^{s.a.v.s.}”

[1]. *Ebu Daudi*, Kitabul-xhihad, bab fil-imami lijetexhin bihi fil-uhud.



Emrat e Allahut

الْجَبَّارُ

11. EL-XHEB-BĀR (NDREQËSI)

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ السَّلَامُ الْمُؤْمِنُ الْمُهَيَّمِنُ الْعَزِيزُ الْجَبَّارُ
الْمُتَكَبِّرُ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١﴾

Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim). Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!¹

El-Xheb-bār الجَبَّارُ është një ndër atributet e Zotit të Plotfuqishëm, i cili rrjedh nga fjala rrënjësore *Xhe-Be-Ra* جَبَر e arabishtes. Ky emër i atribuohet atij, i cili sjell reformim dhe e ndreq atë që është e prishur. Ne hasim gjithashtu një thënie të të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, e cila e zgjeron këtë kuptim. Ai ka thënë:

عَنْ ابْنِ مَرْزُوقٍ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَرَأَ هَذِهِ آيَةَ ذَاتِ يَوْمٍ عَلَى الْمَنِيرِ
وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالسَّمَوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ
بِئَمِّهِ سُبْحَانَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ وَرَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ هَكَذَا
يَبْدُوهُ وَيُحْزَنُهَا يَقُولُ يَا وَيْلَتَى يَمُوجُ الرَّبِّ نَفْسُهُ أَنَا الْجَبَّارُ أَنَا الْمُتَكَبِّرُ أَنَا الْمَلِكُ أَنَا
الْعَزِيزُ أَنَا الْكَرِيمُ فَرَجَعَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ الْمَنِيرَ حَتَّى قُلْنَا لَيَحْزَنَ بِهِ

Hazret Ibn Omeri ^{r.a.} përcjell se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} lexoi këtë ajet nga foltorja: “Ata nuk e kanë vlerësuar Allahun siç duhej. Në

Ditën e Kiametit, e tërë Toka do të jetë nën sundimin e Tij, ndërsa qiejt do të mbështillen nën dorën e Tij të djathtë. I Shenjtë është Ai dhe është shumë i lartë nga ajo që ata shoqërojnë me Të në adhurim!”² Profeti s.a.v.s. e kapi fort foltoren dhe duke lëvizur dorën e tij para e mbrapa, tha: “Zoti i Plotfuqishëm shpall atributet e Tij dhe deklaroi: ‘Unë jam Ndreqësi, Unë jam Krenari, Unë jam Sunduesi, Unë jam Triumfuesi dhe Unë jam Bujari’.”

Përcjellësi rrëfen se foltorja po dridhej aq fort nga lëvizjet e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} saqë kishin frikë se do të rrëzohej foltorja, bashkë me Profetin ^{s.a.v.s.}.³

Imam Ragibi në veprën e tij “*el-Mufredat fi Gharibil Kuran*” shkruan që Allahu quhet *el-Xheb-bār* sepse Ai i shpërblen njerëzit në mënyrë të përsëritur dhe u dhuron mirësi. Fjala جَبَر *Xhe-be-re* do të thotë të ndreqësh diçka me anë të fuqisë dhe ta kthesh atë në gjendjen e mëparshme. Hazret Aliu ^{r.a.} shpesh lutej me këto fjalë: يَا جَابِرُ كُلِّ كَبِيرٍ وَ يَا مُسَوِّدَ كُلِّ غَسِيرٍ “O ndreqës për çdo të prishur dhe o lehtësues për çdo të mjeruar!”⁴

جَبَرُ اللَّهِ فُلَانًا (*Xhebere Allahu fulanen*) do të thotë Allahu ia plotësoi nevojat filanit.

Sipas leksikut Lisanul Arab, el-Xheb-bār është atributi i Allahut, përmes të cilit, Ai u dikton njerëzve vullnetin e Tij për t’iu përgjigjur dëshirës së Tij në çështje të lejuara e të ndaluara.

Nëse përdoret për njeriun, ky atribut mbart kuptimin negativ dhe shërben për të shprehur vërejtjen e për të ndrequr gabimet në qëndrim e sjellje. P.sh. fjala el-Xheb-bār i referohet atij njeriu i cili lëvdohet dhe mburret pa të drejtë a meritë, që nuk pranon të drejtën e të tjerëve dhe në arrogancë përbuz adhurimin e Zotit. Një njeri i tillë

fsheh gabimet e veta dhe për shkak të arrogancës, nuk pranon të vërtetën. Ja disa shembuj nga Kurani:

وَمَا أَنْتَ عَلَيْهِمْ بِجَارٍ

... ti nuk do t'i detyrosh ata me dhunë.⁵

ذَٰلِكَ يُلْقِي اللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ قَلْبٍ مُّشْكِرٍ جَحِيرًا

Kështu, Allahu ia vulos zemrën çdo mendjemadhi dhe mizori.⁶

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ - قَالَ خَتَّابٌ - قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: قَالَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ الْكِبْرَاءُ رِدَائِي وَالْعِظَمَةُ إِزَارِي فَمَنْ تَارَعَنِي وَاحِدًا مَبْنِيًا قَدْفَنُهُ فِي النَّارِ

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Krenaria është manteli im dhe madhështia është rroba ime. Unë do të ndëshkoj ashpër këdo që synon të barazohet me mua qoftë në njërën prej tyre”.⁷

الْحَجَّارُ do të thotë se Allahu është i Gjithëpushtetshëm dhe gjithçka i nënshtrohet e i përgjërohet Atij. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka veçuar këtë pikë në një hadith.

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ الْعَاصِي، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: "قَلْبُ ابْنِ آدَمَ بَيْنَ إصْبَعَيْنِ مِنْ أَصَابِعِ الْحَجَّارِ عَزَّ وَجَلَّ، إِذَا شَاءَ أَنْ يَقْلِبَهُ قَلْبُهُ"، فَكَانَ "يَكْفُرُ أَنْ يَقُولَ: " يَا مُصْرَفَ الْقُلُوبِ

Hazret Abdullah ibn Amr ibn el-Asi ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Zemra e çdo njeriu gjendet midis dy gishtërinjve të Zotit el-Xheb-bâr (Ndreqës) Azze ve Xhel, i cili mund ta ndryshojë kur të dojë”. Ai ^{s.a.v.s.} shpesh bënte këtë lutje: “O Ktyhes i Zembrave!”⁸

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} shkruan:

“Njeriu shpëton nga mëkati vetëm atëherë, kur njoftohet bindshëm për Zotin, për madhështinë e Tij dhe për shpërblim-ndëshkimin prej Tij. Rrënja e çdo shkeljeje është padija. Ai që merr një pjesë nga njohja bindëse e Zotit, nuk mund të mbetet dot shkelës. Nëse i zoti i shtëpisë di që një përmbytje e madhe po vjen drejt strehës së tij, ose që ka rënë zjarr rreth e përqark dhe që rrezikohet shtëpia e tij, ai nuk mund të qëndrojë në të. Atëherë, duke pretenduar bindje në shpërblim-ndëshkim prej Zotit, pse po qëndroni në gjendjet tuaja të rrezikshme?

Prandaj, hapni sytë dhe shikoni ligjin e Zotit që gjendet kudo në botë. Mos u bëni minj që futen në gropë, por zogj që fluturojnë në lartësinë e qiellit.”⁹

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 59:24.
2. *Kurani Famëlartë* 39:68.
3. Ahmad ibn Hanbel, *Musnedul Imam Ahmad*, vëllimi II, Botues: Dar Ih'jaut-turath el-Arabije, Bejrut, 1414 h./1993, f. 72, hadithi nr. 5391.
4. Muhammed el-Zurkani, *Sherh el-Mevahib el-Ledunnijah bil-Minehil Muhammedijeh*, vëll. 1, f. 195, Darul-Kutub el-Ilmijeh, Bejrut.
5. *Kurani Famëlartë* 50:46.
6. *Kurani Famëlartë* 40:36.
7. *Sunen Ebu Davud*, Kitab: El-Libas, Bab: Ma xha-a fil-Kibr, hadith numër: 4090.
8. Imam Ahmed ibn Hanbel (164-241 hixhri), *Musned el-Imam Ahmed ibn Hanbel*, vëllimi XI, Botues: Muesseretur-Risale, Bejrut, 1421 h./2001, f. 182, hadithi nr. 6610.
9. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Mësimi ynë*, botues: Fondacioni Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë, Tiranë, 2020, f. 39-40, ISBN: 978-9928-4491-4-6.



12. EL-MUTEKEB-BIR (KRENARI)

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ السَّلَامُ الْمُؤْمِنُ الْمُهَيْمِنُ الْعَزِيزُ
الْجَبَّارُ الْمُتَكَبِّرُ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ

Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim). Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!¹

Sipas leksikut të famshëm arab el-Mu'xhemul Vesit, emri el-Mutekeb-bir الْمُتَكَبِّر do të thotë “madhështi” dhe “krenari”. Ky emër gjithashtu tregon që atributet e Allahut janë më madhështore dhe më të plota se sa shfaqja e tyre te njerëzit.

Nëse përdoret në kontekstin e njeriut, Kibri (mendjemadhësia) i referohet asaj gjendje, kur njeriu ka vetëpëlqim dhe e shikon veten më lartë se të tjerët. Shkalla më e lartë e mendjemadhësisë është ajo,

në të cilën ai mohon të vërtetën nuk pranon të adhurojë Zotin. Dy rrugë e çojnë njeriun në mendjemadhësi:

1. Kur ai synon të arrijë një pozitë të lartë dhe bën gjithçka për ta arritur atë. Nëse synimi është i drejtë dhe pozita e tij është e denjë për t'u krenuar, krenaria e tij bëhet e lavdishme për të.

2. Por, nëse njeriu krenohet pa të drejtë dhe lëvdohet për vetitë që nuk i zotëron, sjellja e tij bëhet e pahijshme dhe e turpshme. Kurani e qorton këtë sjellje dhe thotë:

أَفْبَىٰ وَاسْتَكْبَرَ وَكَانَ مِنَ الْكَافِرِينَ

Ai e refuzoi, u mburr dhe ishte ndër mohuesit.²

Populli i Musait ^{a.s.} u tregua shpërfillës ndaj thirrjes së tij dhe krimet e tyre i shtynjë ata drejt arrogancës, vetëpëlqimit dhe kokëfortësisë:

فَاسْتَكْبَرُوا وَكَانُوا قَوْمًا مُّجْرِمِينَ

Prapë ata u treguan mendjemëdhenj dhe qenë fajtorë.³

Imam Ragibi ka shkruar që krenaria shfaqet në dy mënyra. Ajo tregohet në mënyrë të drejtë, kur dikush me të vërtetë e meriton atë përmes vetive dhe veprave të tij, që e dallojnë atë nga të tjerët. Në këtë aspekt, krenaria dhe madhështia i përshtaten vetëm Allahut

të Madhërishëm, siç e përshkruan Kurani: *الْعَزِيزُ الْجَبَّارُ الْمُتَكَبِّرُ* i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori.⁴

Por, nëse dikush mbahet më të madhe dhe krekoset e shet mend gjithmonë, krenaria e tij nuk është veçse shtirje e mashtrim. Krenaria dhe mendjemadhësia e njeriut vlerësohen pikërisht në këtë aspekt:

فَيْبُسْ مَثْوَى الْمُتَكَبِّرِينَ

Sa vendbanim i shëmtuar është ai për mendjemëdhënjtë!⁵ Pra, krenaria i përshtatet Zotit të Madhërishëm, siç thotë Allahu në Kuran:

وَالَهُ الْكِبْرِيَاءُ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

Vetëm Atij i përket e gjithë madhështia në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.⁶

Një thënie e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} gjithashtu e shtjellon këtë kuptim. Në Sunen ibn Maxha e gjejmë këtë hadith:

عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " يَقُولُ اللَّهُ سُبْحَانَهُ الْكِبْرِيَاءُ وَدَائِي وَالْعَظْمَةُ إِزَارِي فَمَنْ تَأَزَعَنِي وَاحِدًا مِنْهُمَا أَلْقَيْتُهُ فِي النَّارِ "

Hazret Ibn Abasi përcjell se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha: "Allahu i Madhërishëm ka thënë: "Krenaria është manteli im dhe madhështia është pelerina ime. Kushdo që dëshiron të krahasohet me mua në njërën prej tyre, Unë do ta hedh në skëterrë."⁷

Hazret Ebu Se'id El-Hudriu^{r.a.} gjithashtu ka transmetuar një hadith të ngjashëm:

أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ مَنْ تَوَاضَعَ لِلَّهِ دَرَجَةً رَفَعَهُ اللَّهُ دَرَجَةً حَتَّى يَجْعَلَهُ فِي عِلِّيِّينَ وَمَنْ تَكَبَّرَ عَلَى اللَّهِ دَرَجَةً وَضَعَهُ اللَّهُ دَرَجَةً حَتَّى يَجْعَلَهُ فِي أَسْفَلِ السَّافِلِينَ

I Dërguar i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: "Nëse njeriu tregon përulësinë për hir të Allahut, Ai e ngre atë një shkallë më lartë, derisa e bën ndër Il-lijün. Ndërsa, ai që shfaq një shkallë krenarie para Zotit, Ai do ta ulë atë një shkallë më poshtë derisa do të bëjë që ai të bjerë në gjendjen më të ulët".⁸

عَنْ جَابِرٍ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ " إِنَّ مِنْ أَحَبِّكُمْ إِلَيَّ وَأَفْرِكُكُمْ مِنِّي مَجْلِسًا يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَحَابِسُكُمْ أَخْلَاقًا وَإِنْ أَبْغَضُكُمْ إِلَيَّ وَأَبْغَضَكُمْ مِنِّي مَجْلِسًا يَوْمَ الْقِيَامَةِ الرَّاوُونَ وَالْمُتَشَدِّقُونَ وَالْمُتَقَبِّحُونَ ". قَالُوا يَا رَسُولَ اللَّهِ قَدْ عَلِمْنَا الرَّاوُونَ وَالْمُتَشَدِّقُونَ فَمَا الْمُتَقَبِّحُونَ قَالَ " الْمُتَكَبِّرُونَ "

Xhabiri ^{r.a.} përcjell se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: "Në Ditën e Gjykimit, njerëzit më të dashur për mua e që do të ulen më pranë meje, janë ata që kanë moral më të shkëlqyer ndër ju. Ndërsa njerëzit më të urreyer për mua, të cilët do të qëndrojnë më larg meje në ditën e Gjykimit do të jenë ata që lëvdohen e krenohen me të madhe, të cilët flasin me mendjemadhësi e shesin dije për t'u hequr si të ditur, dhe ata që janë الْمُتَقَبِّحُونَ *el-Mutefejhikun*. Sahabët e pyetën: O i Dërguar i Allahut! Çfarë do të thotë el-Mutefejhikun? Ai u përgjigj: "Mendjemëdhënj".⁹

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} ka thënë:

الْكِبْرُ الَّذِي هُوَ رَأْسُ السَّيِّئَاتِ وَالضَّلَالِ الَّذِي يُبْعَدُ عَنْ طُرُقِ السَّعَادَاتِ

Krenaria është koka e së keqes dhe injorancës, e cila largon (njeriun) nga begatia dhe fatbardhësia.¹⁰

Ai gjithashtu shkruan:

“Njeriu nuk mund të fitojë dashurinë dhe kënaqësinë e Zotit, derisa nuk ka arritur të kultivojë dy cilësi në veten e tij. Së pari, të mposhtë mendjemadhësinë. Pra, njësoj sikur mali i lartë, maja e të cilit ngrihet pingul përpjetë, bie përmbys dhe bëhet rrafsh me tokën, edhe njeriu duhet t’i heqë të gjitha mendimet e arrogancës dhe krenarisë dhe në vend të tyre, t’i përmbahet përulësisë dhe modestisë. Së dyti, të prishë të gjitha lidhjet e tij të mëparshme. Pra, sikur pas përmbysjes mali bëhet i rrafshët dhe i shtypen plisat, njeriu duhet të ndërpresë të gjitha lidhjet që më përpara e nxisnin drejt së keqes dhe i shkaktonin Zotit pakënaqësi dhe tashmë takimet e miqësitë, dashuritë dhe armiqësitë e tij të mbeten vetëm për Allahun e Madhërishëm”.¹¹

SHËNIME

1. Kurani Famëlartë 59:24.
2. Kurani Famëlartë 2:35.
3. Kurani Famëlartë 7:134.
4. Kurani Famëlartë 59:24.
5. Kurani Famëlartë 39:73
6. Kurani Famëlartë 45:38.
7. Ahmad ibn Hanbel, *Sunen Ibn Maxha*, Libri: ez-Zuhd, Bab: el-Bera’atu minel-kiberi

vet-tevadu’i, vëll: 37, hadith nr. 4175.

8. Ahmad ibn Hanbel, *Musnedul Imam Ahmad*, vëllimi III, Botues: Dar Ih’jaut-turath el-Arabiye, Bejrut, 1414 h./1993, f. 76, hadithi nr. 27324.

9. *Xhami’ et-Tirmidhiu*, hadith numër 2018

10. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Keramatus-Sadikajn*, Ruhani Khezain, vëll. 7, f. 146

11. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Melfuzat*, vëll. I, f. 510, 511.



13. EL-KHĀLIK (KRIJUES)

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اذْكُرُوا اللَّهَ عَلَيْكُمْ هَلْ مِنْ خَلْقٍ غَيْرَ اللَّهِ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَأَنْتُمْ تُؤْفَكُونَ

O njerëz! Kujtoni dhuntitë e Allahut mbi ju! A ka ndonjë krijues, përveç Allahut, i cili ju furnizon nga qielli dhe Toka? Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij. Atëherë, ku po largoheni ju?¹

Atributi الْخَالِقُ (El-Khālik) përdoret posaçërisht për Zotin e Plotfuqishëm. Ai rrjedh nga rrënja e fjalës خَلَقَ *Kha-La-Ka* dhe gjithashtu nënkupton planifikimin. Fjala Khālik (Krijues) tregon se Zoti ka vënë çdo gjë sipas një rregulli në rendin

e duhur dhe që çdo gjë i nënshtrohet një sistemi. *هَذَا خَلَقَ اللَّهُ فَأَرْوِي مَاذَا خَلَقَ الْإِلَهِينَ مِنْ دُونِهِ ۖ بَلِ الظَّالِمُونَ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ* do të thotë se Zoti ka krijuar gjithçka dhe nënkupton se Ai është gjithashtu Krijuesi i materies dhe i shpirtrave.

Nganjëherë fjala *خَلَقَ* përdoret si sinonim i *إِنْدَاعَ* d.m.th. krijimi i diçkaje nga asgjëja pa pasur ndonjë materie apo model pararendës. Krijimi i qiejve dhe i tokës është bërë pikërisht në këtë mënyrë, siç përshkruan Kurani:

خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ

Ai krijoi qiejt dhe tokën me vërtetësi.²

Të ngjashme me këtë cilësi, Kurani Famëllartë ka përdorur edhe atribut të tjera. P.sh. *الْبَارِي el-Bari* d.m.th. Filluesi që krijon diçka pa pasur asnjë model apo shabllon pararendës dhe është burimi dhe shkaku i jetës. Emri *الْبَدِيع el-Bedi'* Shpikësi tregon se Zoti krijon pa ndonjë shembull apo mjet dhe vepron jashtë kohës dhe hapësirës. Këtë kuptim e mbështet edhe ajeti vijues:

بَدِيعَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

Ai është Nismëtari i krijimit të qiejve e Tokës.³

Allahu e ka përsëritur këtë atribut si një argument ndaj mohuesve:

خَلَقَ السَّمَاوَاتِ بِغَيْرِ عَمَدٍ تَرَوْنَهَا ۚ وَالْأَرْضَ رَوَاسِيَ ۚ أَنْ تَمِيدَ بِكُمْ ۚ وَتَنْزِلُ السَّمَاءَ مَاءً فَأَنْبِتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ كَرِيمٍ

هَذَا خَلَقَ اللَّهُ فَأَرْوِي مَاذَا خَلَقَ الْإِلَهِينَ مِنْ دُونِهِ ۖ بَلِ الظَّالِمُونَ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ

Ai krijoi qiejt pa ndonjë shtyllë që mund ta shikonit dhe vuri male në tokë që (ato) t'ju sigurojnë ushqim dhe në të krijoi çdolloj gjallese. Dhe Ne zbritëm ujë prej qiellit dhe nxorëm në këtë (tokë) çdolloj çifti fisnik. Ky është krijimi i Allahut. Tani, më tregoni atë që krijuan të tjerët përveç Tij! Por të padrejtët janë në devijim të qartë.⁴

Fjala *el-Khalik* mbart gjithashtu kuptimin e krijimit dhe të shpikjes së një gjëje të re nga diçka ekzistuese.

خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ

(Zoti) ju krijoi prej një fryme të vetme.⁵

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ سُلَالَةٍ مِنْ طِينٍ

Dhe sigurisht, Ne krijuam njeriun nga një esencë prej balte.⁶

Kurani përmend atributin e krijimit si një argument për zota të remë: *أَفَمَنْ يَخْلُقُ كَمَنْ لَا يَخْلُقُ ۚ أَفَلَا تُدْعَرُونَ* Ai që krijon a është si ai që nuk krijon?! A nuk mendoni?!^{7,8}

Ebu Mensur el-Ez'heriu në veprën e tij të njohur *Tehdhibul-Lughah* تهذيب اللغة shkruan që *el-Khālik* dhe *el-Khallāk* janë emrat e Allahut. Nëse këtyre emrave u shtohen në fillim shkronjat *ال* (elif-lam) të shquarsisë, ata nuk mund të përdoren për dikë tjetër veç Allahut

dhe shenjojnë qenien që sjell çdo gjë në ekzistencë nga asgjëja.

Pas krijimit, Zoti gjithashtu ka vendosur një rend të caktuar dhe gjithçka i nënsthrohet këtij rendi. Siç thotë:

ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا الْمُضْغَةَ عِظَامًا فَكَسَوْنَا الْعِظَامَ لَحْمًا ثُمَّ أَنْشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ ۚ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ ﴿١٠﴾

Pastaj spermën e bëmë ngjizje gjaku, ngjizjen e gjakut e bëmë copëz mishi, copëzën e mishit e bëmë kocka dhe kockave iu veshëm mish. Më pas atë e bëmë një krijesë tjetër. Pra, vetëm Allahu zotëron bekimin, Krijuesi më i përsosur.⁹

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} gjithashtu ka porositur që bindja ndaj krijesës nuk duhet të rezultojë në mosbindje ndaj Krijuesit.

وَعَنِ النَّوَّاسِ بْنِ سَمْعَانَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: «لَا طَاعَةَ لِمُخْلُوفٍ فِي مَعْصِيَةِ الْخَالِقِ»

En-Nevvas ibn Sim'an përcjell se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: "Njeriu nuk duhet t'i bindet krijesës, nëse kjo (bindje) kërkon kundërshtimin e Krijuesit".¹⁰

عَنْ عَلِيٍّ، أَنَّ النَّبِيَّ - صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ - كَانَ إِذَا سَجَدَ قَالَ " اَللّٰهُمَّ لَكَ سَجْدَةٌ وَبِكَ آمَنْتُ وَلَكَ أَسْلَمْتُ أَنْتَ رَبِّي سَجِدُ وَنَحْمِي لِلَّذِي شَقَّ سَمْعُهُ وَبَصَرُهُ تَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ " .

Hazret Aliu ka transmetuar se kur i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} binte në sexhde,

ai bënte këtë lutje: "O Allah! Për Ty rashë në sexhde. Ty të besova. Ty t'u dorëzova. Ti je Zoti im. Fytyra ime po i bën sexhde Atij që i dhuroi veshët dhe sytë. I Bekuar është Allahu, Krijuesi më i përsosur!"¹¹

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 35:4.
2. *Kurani Famëlartë* 16:4
3. *Kurani Famëlartë* 2:118
4. *Kurani Famëlartë* 31:11,12.
5. *Kurani Famëlartë* 4:2.
6. *Kurani Famëlartë* 23:13.
7. *Kurani Famëlartë* 16:18.
8. Ragib Asfahani, *Mufredat Li-Alfazil Kuran*, sipas zërit خ ل ق Kha-Lam-Kaf.
9. *Kurani Famëlartë* 23:15.
10. *Mishkat el-Mesabih*, Kitab: el-Imaretu vel Kadau, hadith numër 3696.
11. *Sunen Ibn Maxha*, hadith numër 1054.



11 ushqime që rrisin imunitetin

Rritni imunitetin në mënyrë natyrale

Malik Samar Imtiaz

COO Alislam.org

Ka disa ushqime që rrisin sistemin tonë imunitar. Gjatë kësaj pandemie të Covid-19, është e rëndësishme të hani ushqime që rrisin imunitetin. Sistemi ynë imunitar bën një punë të shkëlqyeshme në mbrojtjen ndaj shumë problemeve shëndetësore. Prandaj, është e rëndësishme të përmirësoni dietën dhe mënyrën tuaj të jetesës. Më poshtë është lista e 11 ushqimeve që ju ndihmojnë të forconi sistemin tuaj imunitar.

Ushqimet që rrisin imunitetin: agrumet

Vitamina C ndihmon në ndërtimin e sistemit tuaj imunitar. Kjo është arsyeja pse ne marrim vitaminën C kur ftohemi. Vitamina C mund të rrisë prodhimin e qelizave të bardha të gjakut, të cilat janë të nevojshme për të luftuar infeksionet. Shumë fruta janë të pasura me vitaminën C. Këto fruta të shijshme janë mënyra e thjeshtë për të shtuar sasinë e vitaminës C në vaktin tuaj.

Lista e agrumeve:

- Portokall
- Portokall sheqe ose portokall i kuq
- Limon
- Limonë të vegjël
- Rrush jeshil
- Kivi
- Fruta pylli

Vitamina C nuk prodhohet në trupin tonë dhe trupi ynë nuk e ruan atë. Kjo

është arsyeja pse ne kemi nevojë për vitaminën C në baza ditore.

Sasia e rekomanduar e Vitaminës C për të rriturit:

- Për burrat: 90 mg
- Për gratë: 75 mg

Kjo sasi ditore është e mjaftueshme për trupin tonë. Një portokall me madhësi mesatare në ditë është perfekt për nevojën ditore të vitaminës C për trupin tonë. Nëse vendosni ta merrni nëpërmjet suplementeve, mos merrni më shumë se 2000 mg në ditë, ose konsultohuni me mjekun tuaj. Vitamina C mund t'ju ndihmojë të shëroheni shpejt nga ftohja e gripi.

Brokoli

Jo vetëm agrumet kanë vitaminën C. Ka shumë ushqime të tjera që janë të pasura me vitaminën C, edhe pse ato nuk janë të tharta. Brokoli, për shembull. Brokoli është i pasur me vitamina e minerale. Është një burim i pasur i vitaminave C, E dhe A. Brokoli është i mbushur me antioksidantë dhe fibra.

Brokoli i pagatuar ose në furrë, është një nga perimet më të mira që mund të hani për shëndetin tuaj. Forma e pagatuar e brokolit është më e mira për t'u ngrënë. Por nëse dëshironi ta gatuar, mjafton që ta gatuar me avull. Gatimi me avull është mënyra më e mirë për të ruajtur të gjithë lëndët ushqyese. Brokoli është

gjithashtu i pasur me proteina dhe kalcium. Është një ushqim i domosdoshëm për t'u shtuar në dietën tuaj.



Ushqimet që rrisin imunitetin: Xhenxhefli

Xhenxhefli gjithashtu është një ushqim i fuqishëm për imunitetin tonë. Pije e freskët me xhenxhefil mund të ndihmojë trupin për të larguar mikrobet. Xhenxhefli është i mirë në ndalimin e zhvillimit të shumë viruseve. Xhenxhefli



besohet të ketë veti antibakteriale dhe anti-inflamatore, të cilat mund të ndihmojnë për të mbajtur larg shumë infeksione. Xhenxhefli është një nga

ushqimet më të mira për të luftuar ftohjen dhe gripin. Ai gjithashtu mund të ulë rrezikun e dhimbjeve kronike. Pija me xhenxhefil përmendet edhe në Kuranin e Shenjtë si një pije që i jep energji shpirtit të njeriut.

Hudhra

Hudhra gjendet në çdo pjesë të botës dhe përdoret në shumë gatime. Ajo ka vetinë për të ndryshuar pozitivisht shijen e ushqimit. Hudhra është e pasur me zing dhe është një ndër ushqimet më të



mira për të luftuar një sërë infeksionesh. Hudhra ka veti antiseptike, antifungale dhe antibakteriale. Ajo ndihmon trupin për të shkatërruar viruset. Andaj, është një prej ushqimeve më të mira për rritjen e imunitetit. Hudhra konsiderohet një luftëtar kundër ftohjes dhe gripit. Hudhra e thatë është më e mira për t'u ngrënë sesa ajo e gatuar. Uji dhe nxehtësia mund të zvogëlojnë vetitë e saj antibiotike.

Specat zile

Specat zile janë burim i pasur i vitaminës C. Një spec zile me madhësi normale përmban 152 mg vitaminë C. Kjo sasi e vitaminës C është e mjaftueshme për nevojën tuaj ditore. Ata janë të pasur gjithashtu me vitaminë A, e cila është një vitaminë e rëndësishme për lëkurën dhe rritjen e imunitetit tuaj. Specat janë një burim i mirë i beta-karotenit. Do të habiteni se si një spec i kuq, i verdhë ose jeshil ka më shumë vitaminë C se çdo



agrumë. Ato janë të dobishme edhe për shikimin tonë. Specat mund t'i hani të freskët duke i prerë me feta në sallatën tuaj.

Kos

“Jogurti grek” ka “kulturë të gjallë dhe aktive”. Pra, është kosi më i mirë për t'u ngrënë. Ai mund të stimulojë sistemin tuaj imunitar dhe të ndihmojë në luftimin e sëmundjeve. Kosi është gjithashtu një burim i shkëlqyeshëm i vitaminës D dhe mund të ndihmojë në

forcimin e sistemit imunitar.

Vitamina D është e njohur për të parandaluar infeksionin si ftohja dhe



gripi. Kosi ka probiotik, minerale dhe vitamina, që gjithashtu mund të ndihmojnë në rritjen e imunitetit. Ka shumë lloje kosi që gjenden në treg. Por është mirë të zgjidhni jo atë që është me aromë apo me shije të ndryshme. Mund t'i shtoni ju frutat që doni në kos të thjeshtë dhe ta konsumoni atë si një meze të lehtë. Mund ta shijoni edhe si



një pije të trashë të lëngshme.

Turmerik

Turmeriku në Europë gjatë Mesjetes

është njohur si shafran i Indisë,¹ por ai nuk është shafran. Turmeriku prej shekujsh njihet si përbërës anti-inflamatorë dhe antibiotikë në ushqimet. Në trojet shqiptare pakkush e përdor, por shumica e vendeve të Lindjes, sidomos India, turmerikun e kanë si erzë të pandashme në gjellërat e tyre të përditshme.

Turmeriku është një erzë që ndryshon ngjyrën, erën, por dhe shijen e ushqimit. Turmeriku është i pasur me kurkumin, prandaj ai ka ngjyrë të verdhë ose të artë të errët. Kurkumina besohet të jetë një përforcues imunitar. Kështu, turmeriku ose shafrani i Indisë gjithashtu mund të forcojë sistemin imunitar. Turmerku gjithashtu është i njohur për vetitë e tij kuruese për kockat, për dhimbje artriti, artroza etj.. Për këto arsye, është mjaft e dobishme ta shtoni turmerkun në ushqimet tuaja të përditshme.

Bajame

Për të luftuar bakteret, sistemi ynë imunitar ka nevojë për vitaminën E, e

cila gjendet te bajamet. Kjo është arsyeja pse frutat e thata (arrat, bajamet, lajthitë, etj.) janë të dobishme për të parandaluar infeksionet si ftohja e gripi. Gjithashtu, bajamet janë të pasura me bakrin dhe manganin. Këto minerale e ndihmojnë shumë sistemin tonë imunitar. Pra, mund të shtoni bajame në dietën tuaj.

Ka shumë mënyra për të ngrënë bajamet, për shembull: gjalpë bajameje, qumësht bajameje, ose bajame të copëtuara. Mund t'i hani bajamet edhe siç janë. Ose hidhni 8 deri në 10 bajame në një gotë uji në darkë, dhe në mëngjes, qërojin ato dhe hajini duke i përthypur mirë. Kështu mund t'i hani çdo ditë. Bajamet gjithashtu janë një burim i pasur antioksidant.

Papaja

Papaja është e pasur me vitaminën C. Mund të hani një papaja të madhësisë mesatare për nevojën tuaj ditore të vitaminës C. Papaja ka një shije unike dhe të gjithë e duam atë. Ajo ka sasi të mjaftueshme të kaliumit dhe është e



pasur me antioksidantë, disa vitamina dhe minerale.

Papaja përmirëson rezistencën kundër sëmundjeve kronike. Ajo gjithashtu ndihmon në sistemin e tretjes dhe në lehtësimin e kalimit të ajrit. Karakteristikat e tij anti-inflamatore ndihmojnë në uljen e inflamacionit për shkak të ftohjes dhe të kollës. Papaja zvogëlon natyrshëm nivelin e kolesterolit dhe ndihmon në përmirësimin e shëndetit të zemrës. Gjithashtu, ajo ndihmon në menaxhimin e presionit të gjakut.

Mjaltë

Mjalti është një tjetër ushqim i mirë



për përmirësimin e sistemit imunitar. Fitonutrienti i pranishëm në mjaltë i jep atij veti antioksiduese, antibakteriale dhe antifungale. Gjithmonë blini mjaltë të papërpunuar, pra origjinal, pasi ai ka më shumë efekte për rritjen e imunitetit dhe ka efekte antikancerogjene. Mjaltit të përpunuar i mungojnë këto lëndë

ushqyese të vlefshme. Mjalti është gjithashtu i mirë për shëndetin tuaj të zemrës. Ai ka edhe veti shëruese për plagët. Mjaltin mund të hani çdo ditë nga një lugë çaji. Zëvendësoni sheqerin me mjaltë në ushqimet tuaja.

Çokollata e zezë



Po, çokollata e zezë ka një antioksidant të quajtur “teobrominë” (theobromine) që mund të ndihmojë në rritjen e imunitetit. Çokollata e zezë mund të jetë e mirë edhe për kollën. Ajo është e pasur me lëndë ushqyese dhe është një nga burimet më të mira të antioksidantëve. Ajo gjithashtu përmirëson shëndetin e zemrës.



Komunikimi me Zotin është esenca e Islamit

Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}
Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu

Dihet që derisa njeriut nuk i jepet shembulli, ai mbetet në mëdyshje. Paraqitja e shembullit është diçka që ekziston vetëm në Islam dhe kjo përbën një argument shumë të fortë të vërtetësisë së fesë, të cilin nuk e gëzojnë fetë e tjera. Islami është feja që i pëlqen Zotit të Madhërishëm dhe që është pranuar tek Ai. Për këtë arsye, nga mëshira e Tij,

Zoti i Madhërishëm në këtë fe ka lënë të vijueshëm komunikimin me Të, si bekim të përsosur e të pashtershëm, në mënyrë që t'i shpëtojë muslimanët nga devijimi dhe mëdyshja.

Shpesh njerëzve u lind pyetja – Edhe unë jam njeri dhe edhe ky deklaruesi i shpalljeve është njeri, atëherë, si është e mundur që unë nuk e gëzoj

komunikimin me Zotin dhe ai po? Për të larguar dyshime të tilla, Zoti i Madhërishëm çdo njeriu i ka dhënë një refleks të këtij bekimi si shembull. Ashtu siç njeriu duke parë qoftë një lekë mund të imagjinojë për një a dy milionë lekë, në të njëjtën mënyrë, një ëndërr e vërtetë bëhet argument që mund të vijë edhe shpallja (ilhami).

Ëndrrat e vërteta janë lënë në natyrën e njeriut si shembuj, në mënyrë që duke i parë ato, njeriu të konceptojë edhe kulmin e këtij bekimi. Edhe një njeri i rëndomtë nëse mund të shohë një ëndërr të vërtetë, si nuk është e mundur që ai që është i përsosur dhe i dëlirë, të mos ketë shkallën e përsosur të komunikimit me Zotin, që është shpallja. Realisht, edhe ëndrra e vërtetë është një pjesë shumë e vogël e përsosmërisë profetike.

Mbani mend! Esenca e Islamit është vazhdimësia e komunikimit me Zotin e Madhërishëm. Nëse nuk do ta kishte këtë bekim Islami, edhe ai do të ishte i vdekur si fetë e tjera. Kuptojeni mirë këtë pikë! Nëse Islami do të ishte i zbrazët nga kjo mirësi dhe nga ky bekim hyjnor, ai nuk do të kishte asnjë argument për të provuar epërsinë e tij. Është bekimi i veçantë i Zotit të Madhërishëm, që Ai dërgon shembuj të gjallë në krye të çdo shekulli të Islamit dhe, në këtë mënyrë, ka vijuar ta provojë faktin para botës se Islami

është një fe e gjallë.

Dikur feja Islame lëkundej nga largimi i qoftë një njeriu, por sot qindra mijëra njerëz e braktisin atë. Janë bërë përpjekje edhe nga armiqtë e brendshëm, edhe nga të jashtëmit, që ajo të asgjësohej. Islami u fye, u poshtërua dhe u nëpërkëmbë. Vetë ata që pretendojnë të jenë muslimanë, shndërrohen në armiq të Islamit, duke mos e kuptuar atë. Atëherë, tregomëni! Ç'dëvim tjetër, apo humbje duhet të presim akoma?

Nëse Islami dhe jeta e Islamit do të varet vetëm nga historitë dhe përrallat e së kaluarës, atëherë mbajeni mend, Islami nuk mund të ekzistojë as sot e as nesër.

Mbani mend! Zoti i Madhërishëm ashtu siç e ka mbështetur Islamit në fillim dhe ashtu siç ka vijuar mbështetjen e tij për të edhe në vazhdim, edhe sot mund ta mbështesë atë me shenja të freskëta. Ai mund t'i mundësojë dalluesin (furkanin) çdo besimtari, me kusht që ai të jetë besimtar. Por, mullahët dhe të ashtuquajturit mbështetës të fesë islame, ngjiten nëpër minbere dhe shpallin me të madhe se tashmë Islami nuk ka askënd që mund të tregojë shenja.

Për shembull, në “Mbledhjen e madhe”, ku ithtarët e të gjitha feve

ishin të tubuar, Z. Maulvi Muhammed Husejn ka pranuar duke thënë se Islami fatkeqësisht nuk ka më njerëz që mund të tregojnë shenja. Me fjalë të tjera, ai vetë e ka pranuar se edhe feja e tij është e vdekur sikur fetë e tjera, sepse ajo nuk ka më shenjë të jetës që ka ekzistuar më parë.

Thellohuni! A mund të vlerësohet Islami me deklarata të tilla?! Jo, përkundrazi, nuk ka poshtërim më të madh se sa të thuash e të besosh se Islami është i zbrazët nga njerëzit me të cilët komunikon Zoti i Madhërishëm dhe për vërtetësinë e të cilëve dërgon shenja madhështore nga e padukshmja.

Mbajeni mend! Nëse do t'i vijë Islamit, larg qoftë, një kohë e tillë, kur ai nuk do t'i ketë më këto bekime, dijeni se ai ka vdekur si fetë e tjera. Kur nuk ekziston shenja e jetës, si do të quhet i gjallë ai?

Shikoni, edhe brahmanët besojnë në “la ilahe ilallah” (nuk ka zot tjetër përveç Allahut). E nëse ata do t’ju pyesin – Çfarë force e çfarë veçantie keni fituar ju, duke pranuar Muhammedin, të dërguarin e Allahut?, si do t’u përgjigjeni atyre? Muslimanët duhet të kenë një argument dhe një parim të tillë, me të cilin, ata të mbizotërojnë të tjerët.

Pra, më tregoni se cili është ndryshimi midis jush dhe atyre që besojnë në unitetin e Zotit? Ka edhe të krishterë që

besojnë në një Zot. Edhe arjët thonë se kanë një Zot. Po ashtu, edhe hebrenjtë janë monoteistë. I kisha shkruar një letër një dijetari hebre, duke pyetur se cili është besimi i tij rreth unitetit të Zotit? Ai m’u përgjigj duke shkruar se ata besojnë në njëshmërinë e Zotit dhe se Zoti i tyre është po Ai që është Zoti i Kuranit. Pra, kjo ju bën të mendoni e të reflektoni se nëse edhe këta deklarojnë besimin në një Zot, çfarë veçantie keni ju si muslimanë?

Mrekullitë që bëjnë dallimin midis së vërtetës dhe gënjeshtres

Për sa u përket polemikave për çështje të imëta, ato i merr era. Askush nuk beson me anë të polemikave. Shikoni, Lek Rami u përball me mua. Ai bëri profeci për mua që unë do të vdisja brenda tri vitesh. Unë u njoftova nga Zoti dhe bëra profeci për të që ai do të vritej brenda gjashtë vitesh nga një sulm vrasës. Hapeni dhe shikojeni librin e Lek Ramit, të titulluar “*Hebt-e-Ahmedia*”, si ai u lut dhe u përgjërua me dënosa e me të qara pranë Parmeshverit (Zotit), duke i kërkuar me përlulje të skajshme vendimin e Tij për mbështetjen dhe përkrahjen e të drejtit dhe për shkatërrimin dhe asgjësimin e gënjeshtarit, në mënyrë që të dallohet e vërteta nga e rrema, dhe bota të dëshmojë se midis fesë arje dhe fesë Islame, cila është rruga e pëlqyer tek Zoti dhe cila është e refuzuar.

Vendimin që erdhi përfundimisht, e njeh një botë e tërë. Kë mbështeti Zoti i Madhërishëm dhe cilin e bëri të vdiste i dështuar. Në këtë mënyrë, pra, morëm zgjidhjen e përhershme të çështjes midis të drejtit dhe gënjeshtarit, midis Islamit dhe fesë arje.

Këto quhen shenja të Zotit dhe pikërisht këto e bëjnë dallimin. Çfarë mund të bëhet me polemika të thata? A ka parë ndokush dikë që e bind tjetrin me polemikë? Lexoni librin “Hebt-e-Ahmedia” në njërën anë dhe, në anën tjetër, lexoni edhe librat e mi, ku është përmendur gjerësisht profecia që u tha më lart, pastaj, gjykoni vetë se cila është fjala e Zotit dhe cila ajo e djallit? Nëse gjuha ime nuk do të ishte prej Zotit dhe prej urdhrorit të Zotit, a nuk kishte mundësi që unë të vdisja dhe ai të jetonte, sepse rrethanat ishin në favor të tij. Jam më i madh në moshë sesa ai dhe përveç kësaj, kam qenë edhe i sëmurë, kurse ai ishte i fortë dhe i shëndoshë.

Nuk ishte vetëm ai. Kushdo që bëri duel (*mubahale*) me mua, u poshtërua. Gulam Dastagir Kasuri, Muhiudin Lekukevala etj. u përballën me mua e u shkatërruan dhe me vdekjen e tyre kanë vulosur vërtetësinë time.

Maulvi Çiragdin i Xhamusë bëri duel dhe profeci që unë do të vdisja nga murtaja. Por shikoni, ai vdiq nga murtaja. Ishte një fekir Mirza. Edhe ai

deklaroi për mua duke thënë se paskësh marrë njoftimin prej Arshit, që unë do të vdisja gjatë muajit Ramazan. Më në fund, kur erdhi muaji Ramazan, ai vdiq. Z. Babu Ilahi Bakhsh shkroi në librin e tij profeci rreth meje se unë do të vdisja nga murtaja. Por ju e dini se si vdiq ai.

... (Aleksandër) Dowie që jetonte matanë oqeanëve, kur u përball me mua, mora njoftimin prej Zotit, të cilin e publikova si profeci, që ai do të shkatërrohet dëshpërimisht. Menjëherë pas publikimit të profecisë, atij i filluan shenja rënieje dhe përfundimisht u paralizua dhe vdiq duke pësuar një mori poshtërimesh të tjera.

Nëse do t'i përmbledhim këto shenja, do të bëhet një libër voluminoz gati me pesëdhjetë pjesë. Mendoni edhe për Abdullah Et'hemin. Ku është ai sot? (Edhe ai ka vdekur sipas profecisë)

Ka njerëz që thonë – Trego ndonjë mrekulli të re për ne! A janë vjetruar shenjat që u janë treguar më parë, që atyre t'u jepet një mrekulli e re? Njerëzit kërkojnë shenjat sipas qejfit të tyre, por Zoti i Madhërishëm nuk i nënshtrohet askujt. Ai ndjek vullnetin e Vet. Ai po tregon shenja, dhe po i tregon sipas dëshirës së Vet.

- “*Melfuzat*” (Thënie) vëll. 5, botimi në 5 vëllime, Kadian, Indi, 2003, f. 556-559.

Lajme

nga Shqipëria, Kosova dhe Gjermania

Mish i Kurbanit për 50 familje në nevojë të Këlcyrës nga Humanity First



Bashkisë Z. Klement Ndoni i shprehu falënderime organizatës “Humanity First Deutschland” dhe Fondacionit



Me rastin e Kurban Bajramit, Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë, nëpërmjet organizatës së tij humanitare “Humanity First”, shpërndaui mishin e Kurbanit mes 50 familjeve në nevojë të Këlcyrës.

Xhemati Musliman Ahmedia të Shqipërisë për këtë ndihmesë.

Humanity First ndau mishin e Kurbanit mes familjeve në nevojë të Tiranës

Po me rastin e Kurban Bajramit, Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë, nëpërmjet organizatës

Aktiviteti u realizua më 21 korrik 2021, në bashkëpunim me Bashkinë e Këlcyrës. Është kënaqësi për Xhematin Musliman Ahmedia që mishi i Kurbanit është ndarë me disa familje të nderuara të Këlcyrës. Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë u është mirënjohës për pjesëmarrje familjeve dhe Bashkisë së Këlcyrës për bashkëpunimin. Kryetari i





së tij humanitare “Humanity First”, shpërndau mishin e Kurbanit mes 190 familjeve në nevojë të Tiranës.

Aktiviteti u realizua më 22 korrik 2021, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, ku në Qendrën Multidisiplinare, në Shtëpinë e Ngjyrave dhe në afërsi të Xhamisë Bejtul-Avel, respektivisht 65, 90 dhe 35 familje.

QKMF e Podujevës bëhet me tunel dezinfektues

Për shkak të rasteve të shtuara me virusin Covid-19 në Kosovë gjatë muajave gusht e shtator 2021, u rrit ndjeshëm fluksi i madh i pacientëve dhe vizitorëve në institucionet kryesore të shëndetësisë nëpër vend. Prandaj, organizata “Humanity First” iu përgjigj thirrjes së kryetarit të komunës së Podujevës, për vendosjen e tunelit dezinfektues në ambientin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë. Më 6 shtator 2021 u bë inaugurimi i tunelit dezinfektues në praninë e kryetarit të Podujevës Z. Shpejtim Bulliqi, zyrtarëve komunalë dhe të QKMF-ës, përfaqësuesve dhe vullnetarëve të



organizatës “Humanity First”.

Shpërndarja e mishit në Istog, Pejë dhe Deçan

Gjatë festës së Kurban Bajramit, Humanity First Kosova realizoi shpërndarjen e produkteve të mishit për “Organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” në Istog, Pejë dhe Deçan.

Përfitues ishin veteranët, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e kësaj organizate në këto 3 komuna.




Humanity First dhuron produkte të mishit për rastet sociale në Podujevë

Me rastin e festës së Kurban Bajramit, organizata “Humanity First” shpërndau 100 pako të mishit në 100 familje me asistencë sociale në Komunën e Podujevës.



Ja disa pamje, para dhe pas renovimit.



Rinovimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Karaçevë të Kamenicës

Organizata Humanity First realizoi gjithashtu renovimin e “Qendrës së Mjekësisë Familjare” në Karaçevë. Në ceremoninë e përfundimit mori pjesë kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati.



Turneu i biçiklitave në Gjermani: “Kilometra kundër urrejtjes - muslimanët për paqe”

Për të dënuar sulmin terrorist të 25 qershorit 2021 në qytetin Würzburg në Bavari dhe për t'u solidarizuar me të gjithë ata që ngrihen kundër urrejtjes dhe

mbështesin paqen, Xhemati Musliman Ahmedia i Gjermanisë organizoi turneun me biçikletat nën sloganin “kilometra kundër urrejtjes - muslimanët për paqe”. Gjatë 6 ditëve (11-16 korrik 2021) 30 biçiklistë vizituan 9 xhami që ndodheshin në itinerarin e tyre nga Waldshut-Tiengen-i deri në Kiel dhe mblodhën kilometra kundër urrejtjes.

Në këtë grup, bënte pjesë Abdullah Wagishauser, kryetari (*Emiri*) i Xhematit në Gjermani si dhe disa imamë që janë rritur dhe kanë përfunduar studimet e tyre në Gjermani. Gjatë turneut, çdo ditë në mëngjes u organizua një takim në ambientin e xhamisë me gazetarët vendasë.

Turneu kaloi përmes 5 shteteve të vendit, mbuloi gjithsej 1050 kilometra në 44

orë. Këtë vit, ky turne i ishte kushtuar dëshmorit Abdul Waheed Waraich, i cili është muslimani i parë ahmedian që kishte ngjitur malin më të lartë Everestin, por kishte ndërruar jetë gjatë rrugës së kthimit nga maja.

Dhjetëra gazeta, televizione lokale dhe ueb-portale dhanë lajme rreth turneut dhe kështu u përhap mesazhi i paqes.



Lutje për të kërkuar mirësi dhe për t'u mbrojtur nga të këqijat

Hazret Enes Ibni Maliku^{r.a.} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{s.a.v.s.}:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنَ الْخَيْرِ كُلِّهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ
وَأَعُوذُ مِنَ الشَّرِّ كُلِّهِ مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ

O Allah! Të kërkoj çdo mirësi, edhe atë që e di, edhe atë që nuk e di dhe të kërkoj mbrojtje nga çdo e keqe, edhe nga ajo që e di, edhe nga ajo që nuk e di.

Ebul-Kasim et-Taberani, "Mu'xhemul-kebir", vëll. II, botues "Mektebetu Ibni Tejmijje", Kajro, pa vit botimi, fq. 252, hadithi nr. 2058.

INDEX IN ENGLISH

10 God's ways of Communication

An in-depth explanation of the Holy Qur'an, which explores the ways of communicating with God Almighty.

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

18 The door of revelation is still open

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

20 Why do some dreams come true? Why do to some people dreams never come true?

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

26 Islamic Schools of Thought

A chapter from phenomenal book
"Revelation, Rationality, Knowledge & Truth"
published in 1998.

HADHRAT MIRZA TAHIR AHMAD ^{R.A.}
FOURTH SUCCESSOR TO PROMISED MESSIAH

44 Defending Palestinian Rights: An Appeal to the World by Sir Zafrulla Khan

This epic address was delivered in Nov. 1947 in the UN Assembly, when the creation of Israel was being debated. It highlighted the rights of the Palestinians, which were being overlooked.

SIR MUHAMMAD ZAFRULLA KHAN

66 The superiority of the Holy Quran

HADHRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH AND IMAM MAHDI

68 Think You Know About Social Media? Think Again Says Netflix's 'The Social Dilemma'

A thorough analysis that breaks down the real purpose of social media and gives suggestions for using them for meaningful purposes

FARHAT MAHMOOD, USA
SARMAD NAVEED, CANADA

78 Attributes of Allah

This series delves deeper into each of God's attributes to gain a better understanding of His Being.

86 11 Immunity Boosting Foods

There are certain foods that boost your immune system. During this coronavirus pandemic, it is important to eat immunity boosting foods.

MALIK SAMAR IMTIAZ

92 Communication with God is the essence of Islam

HADHRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH AND IMAM MAHDI

94 News from Albania, Kosovo and Germany

A summary of activities carried out by Ahmadiyya Muslim Jamaat and its humanatiran organisation "Humanity First" .

اَسْعُوْا فِيْ اَيِّتِنَا لِكُرْ

Lutmoni Mua,

do t'ju përgjigjem

Kurani Famëlartë 40:61